

Çfarë ndodh kur lutem

dhe

Të përfituarit prej lutjes

Çfarë ndodh kur lutem

dhe

Të përfituarit prej lutjes

Një përmbledhje dhe rishkrim i “Teologjia e lutjes” nga B.M. Palmer (1818-1902), së bashku me rishkrimin përmbledhës të “Kthimi i lutjeve” nga Thomas Goodwin (1600-1680).

Originali

Titulli: “Çfarë ndodh kur lutem”

Autori: Thomas Goodwin dhe Benjamin Palmer

Përkthyes: Blerina Pasha

Redaktore: Valbona Luzi

Të drejtat e botuesit: AEM – Misioni Ungjillor

Pjesa e parë

Çfarë ndodh kur lutem

Përgatitur nga Dr. N. R. Needham

Përmbajtja

Kapitulli	Faqe
Hyrje	9
Shënim	11
1. Çfarë bën kur lutesh	13
2. Admiring dhe lavdërim	15
3. Kërkesë dhe falenderim	21
4. Rrëfim dhe përgjërim	27
5. Ndërmjetësim	32
6. Përfitimet shpirtërore të të luturit	36
7. Bekimet e Perëndisë dhe lutja-kërkesë	45
8. Lutja dhe Perëndia Atë	49
9. Lutja dhe Krishti si Profeti ynë	56
10. Lutja dhe Krishti si Prifti ynë	59
11. Lutja dhe Krishti si Mbreti ynë	64
12. Lutja dhe Fryma e Shenjtë	67
13. Ç`mund të themi për lutjet e papërgjigjura?	71
14. A mund të më kthejë gjithë ky i lutur në një fetar fanatik?	76
15. A përputhet lutja me ndonjë pikëpamje shkencore për botën?	80
16. A duhet të luten njerëzit që s`janë kthyer në besim?	83

Hyrje

Benjamin Morgan Palmer (1818-1902), ishte një nga predikuesit më të mëdhenj dhe më të famshëm Reformues të shteteve Jugore të Amerikës në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Fatkeqësisht, shumica e të krishterëve sot, jashtë shteteve të Jugut, nuk do të kenë dëgjuar për të. Pra, çfarë lloj njeriu ishte ai?

Palmeri u lind në Karolinën e Jugut. Ky ishte shteti më krenar jugor i shteteve Jugore, i pari që deklaroi pavarësinë e tij nga qeveria federale e USA-s, në krizën politike të 1860-ës, e cila e zhyti Amerikën në luftë civile. Megjithatë, paraardhësit e Palmerit në të vërtetë ishin Veriorë - Puritanët e New England. I kthyer në besim në moshën 18 vjeçare Palmeri u trajnua për shërbesën Presbiteriane, dhe nga viti 1843 deri më 1854, i riu nga Karolina e Jugut, shërbeu si pastor i Kishës së Parë Presbiteriane të Kolumbias në atdheun e tij. Pastaj ai veproi për pak vjet si profesor i Qeverimit dhe Historisë së Kishës në seminarin e Kolumbias. Dhuntitë intelektuale të Palmerit të bënin të mendoje se ai mund të bëhej një teolog i madh akademik, por shërbesa prej pastori ishte gjithmonë dashuria e tij e parë. Kështu që, në vitin 1856 Palmeri iu kthye shërbesës, këtë herë në shtetin e Luizianës, në Kishën e Parë Presbiteriane New Orleans.

Shërbesa e Palmerit në Luizianë u ndërpre më 1861-1865, nga shkatërrimi tragjik dhe gjakderdhja e Luftës Civile Amerikane (ose siç e quajnë Jugorët ‘Lufta ndërmjet Shteteve’).

Veriu dhe Jugu luftuan njëri-tjetrin; forcat veriore e morën New Orleans në Maj 1862 dhe Palmeri u strehua në vendin e tij të lindjes, në Karolinën e Jugut. Për ato pak vite, ai shërbeu si profesor i Teologjisë në Seminarin e Kolumbisë. Kur mbaroi lufta dhe Jugu u shtyp brutalisht nga Veriu, Palmeri u kthye në Kishën e Parë Presbiteriane në New Orleans. Atje, ai ndihmoi besimtarët Jugorë të rindërtonin jetët e tyre, të shkatërruara prej luftës. Palmeri mbeti si pastor në New Orleans deri në fund të jetës së tij.

Palmeri është quajtur ‘një nga shërbëtorët më të mëdhenj të ungjillit që ka patur ndonjëherë Kisha Jugore’.¹ Ai fitoi një reputacion të gjerë në atë kohë si një predikues i fuqishëm, si një këshilltar i dhembshur dhe një udhëheqës kisha i urtë (dhe po ashtu një kampion dhe mik i shquar i popullit hebre). Vlerësimi i lartë për Palmerin u tregua nga fakti se më 1861, ai u zgjodh për t’u bërë Moderator i Asamblesë së Përgjithshme të parë, të Kishës së Parë Presbiteriane të formuar rishtazi. Ai shkroi një numër veprash të vlefshme doktrinale dhe shpirtërore, disa prej të cilave janë ribotuar kohët e fundit.

Ky libër i Grace Publications mbështetet në “*Teologjia e lutjes*” së Palmerit. Ai e shkroi këtë libër nga fundi i jetës së tij, më 1894. Biografisti i Palmerit, T. C. Johnson, tha për këtë libër: ‘Qëndron në një klasë më vete dhe mbush një boshllëk, i cili ka egzistuar deri tani në letërsinë tonë teologjike’.² Libri fillon të na mësojë çfarë është lutja dhe se si duhet të lutemi, po ashtu si të merremi me disa nga problemet që mund të dalin gjatë të luturit.

Perëndia e bekoftë urtësinë shpirtërore të Benjamin Morgan Palmerit ndaj një brezi të ri të krishterësh që luten sot.

N. R. Needham Londër 1997

¹ M. H. Smith, Studime në Teologjinë Presbiteriane, fq.218.

² T. C. Johnson, Jeta dhe letrat e Benjamin Palmer, fq.573.

Shënim mbi versionin e fundit të “Teologjia e lutjes” së Palmerit.

Unë e kam ndryshuar në mënyrë drastike stilin e të shkruarit të Palmerit, për ta bërë atë më të arritshëm për lexuesit modernë. Kjo përfshin zgjerimin e disa gjërave që Palmeri thotë, për t'u sjellë atyre një kuptim më të plotë. Fillimisht, Palmeri shkroi në një stil mjaft poetik e me pak fjalë, dhe çdo përpjekje për t'i vendosur mendimet e tij në një gjuhë moderne të qartë duhet t'i nënshtrohet rrezikut për të parafrazuar lirshëm. Besoj se kam qenë besnik ndaj kuptimit të Palmerit kur e kam bërë këtë. Gjithashtu kam rirregulluar mjaft gjëra prej origjinalit. Kështu, nëse e keni lexuar “*Teologjia e lutjes*”, ju mund të njihni pasazhe në një vend për të cilat kishit menduar se ishin diku tjetër. Kjo është puna ime, dhe përsëri u bë në mënyrë që vepra e Palmerit të ishte më e lehtë për t'u tretur nga lexuesit e sotëm. Unë gjithashtu kam shtuar citime të ndryshme nga Shkrimi për të ilustruar disa nga gjërat më të rëndësishme që Palmeri thekson. Të gjitha citimet e Shkrimit janë nga Revised Authorised Version.

Në fund të të gjithë kapitujve, përveç të parit, kam përfshirë disa ‘pika për reflektim ose diskutim’. Këto nuk janë në veprën origjinale të Palmerit. Qëllimi i tyre është fokusimi në disa nga problemet e ngritura në çdo kapitull për të ndihmuar lexuesin të mendojë thellë për to. Ato mund të përdoren gjithashtu si bazë për diskutim në grup, që po e ndjek këtë libër.

NRN

Kapitulli 1

Çfarë bën kur lutesh?

‘Ju pra lutuni kështu: Ati ynë që je në qiej...’ (Mateu 6:9). ‘Lypni dhe do t’ju jepet; kërkonti dhe do të gjeni; trokitni dhe do t’ju çelet.’ (Mateu 7:7). ‘Pastaj u tha atyre dhe një shëmbëlltyrë, për të treguar se duhet të lutemi vazhdimisht, pa u lodhur’ (Luka 18:1), ‘duke u lutur në çdo kohë dhe me çdo lloj lutjeje dhe përgjërimi në Frymën’ (Efesianët 6:18). ‘Lutuni pa pushim’ (1 Thesalonikasve 5:17).

Është e qartë se Perëndia dëshiron që ti të lutesh. E gjithë Bibla e bën të qartë këtë. Por çfarë bën saktësisht kur lutesh?

Aktiviteti shpirtëror i lutjes është disi si ngjyrat e spektrit. Nëse dërgon një rreze drite të bardhë përmes një prizmi xhami, drita thyhet në shtatë ngjyra – e kuqe, portokalli, e verdhë, jeshile, bojëqielli, blu dhe manushaqe. Në të njëjtën mënyrë, nëse do të shohësh mirë lutjen, do të zbulosh se ajo thyhet në shtatë ‘ngjyra shpirtërore’, ose shtatë aspekte të lutjes. Këto aspekte unë do t’i quaj si më poshtë; admirim, lavdërim, kërkesë, falenderim, rrëfim, përgjërim dhe ndërmjetësim.

Nuk po them se në çdo kohë që lutesh, ti duhet të sigurohesh që lutjet e tua përfshijnë të gjithë këta shtatë përbërës. Unë thjesht po them se lutja është një aktivitet mjaft i gjerë, i cili mund të përfshijë një nga këto shtatë ‘ngjyra shpirtërore’.

Gjithashtu, të duhet të mbash mend se ashtu si të shtatë ngjyrat e spektrit, këto aspekte të lutjes shkrihen lehtësisht me njëri-tjetrin; nuk mund të bësh një ndarje të plotë. Për shembull, admirimi dhe lavdërimi përzihen së bashku si adhurim. Le t'i shohim këto shtatë aspekte të lutjes.

Kapitulli 2

Admirimi dhe lavdërimi

'Adhuroni Zotin në shkëlqimin e shenjtërisë së tij' (Psalmi 29:2).

A e ke pyetur ndonjëherë veten se përse egziston? Sipas Biblës, arsyeja e vetme është të adhurosh Perëndinë. Ja, pse Perëndia të bëri ndryshe nga kafshët duke vendosur fuqi të mrekullueshme mendimi dhe ndjenje në ty. Ne, qeniet njerëzore, jemi projektuar për të qenë priftërinj krijimi; ne i japim natyrës së heshtur një zë me të cilin të adhurojë Krijuesin e saj të madh.

Të gjitha fuqitë e shpirtit tënd të pajisin ty për këtë qëllim të lavdishëm: për të adhuruar Krijuesin tënd. Mendja jote mund të mendojë për të. Zemra jote mund ta dojë atë. Pritja jote për pavdekësinë bën që ti t'i largohesh përjetësisë. Pastaj është ndërgjegjja jote, ai gjykim i padukshëm brenda teje, që të bën të dallosh të drejtën nga e gabuara. Është nderi dhe respekti instiktiv që ti ndien për çdo gjë shpirtërore dhe hyjnore. Në fakt, si qenie njerëzore e krijuar në imazhin e Perëndisë, adhurimi të vjen natyrshëm edhe nëse je vetëm në heshtjen dhe vetminë e mendimeve të tua.

Por si mund ta adhurosh Perëndinë pa u lutur? Të gjuhëzohesh përulësisht në pluhur përpara madhësisë së Perëndisë – **kjo është esenca e lutjes**. Ajo egziston në zemrën tënde përpara se të shprehet në buzët e tua. Kjo do të thotë të njohësh në brendësinë e frymës tënde, kontrastin e mahnitshëm ndërmjet Perëndisë Zot madhështor dhe vetes tënde të vogël. Të lutesh do të thotë të adhurosh.

Kur shohim adhurimin e shprehur në lutjet e Biblës, zbulojmë se ai ka dy aspekte, të cilat i kam quajtur ‘admirim’ dhe ‘lavdërim’. Ndonjëherë, në Bibël, shohim njerëz që adhurojnë Perëndinë për atë që ai është në vetvete – qenien dhe natyrën e tij të lavdishme. Kjo është ajo që unë e quaj ‘admirim’.

Ndonjëherë shohim njerëz që e adhurojnë Perëndinë për çfarë bën – veprat e tij, bëmat e tij në krijimin dhe zotërimin e universit. Kjo është ajo që unë e quaj ‘lavdërim’,

Nuk ka ndonjë ndryshim të madh midis admirimit dhe lavdërimit. Ato përzihen shpejt dhe natyrshëm me njëri-tjetrin. Por ka një ndryshim në theksin që i jepet, i cili varet nga fakti nëse po shohim më shumë se kush është Perëndia apo çfarë bën ai.

Nëse dëshiron ta admirosh Perëndinë në lutjet e tua, ta adhurosh për atë që është në vetvete, si duhet të veprësh? Mund të mësosh nga njerëzit e Perëndisë në Bibël. Ata shpesh e shprehën admirimin e tyre nëpërmjet emrave dhe titujve të ndryshëm të Perëndisë. Ja disa shembuj se si i janë drejtuar ata Perëndisë në lutjet e tyre:

Zoti Perëndi
Zoti Perëndia ynë
Zoti Perëndi i plotfuqishëm
Perëndia i lartë dhe madhështor
Perëndia i madh dhe i fuqishëm
Zot i fortë dhe i fuqishëm
Zot i ushtrive
Zot i zotërve
Mbret i mbretërve
Mbret i lavdisë
Ati i lavdisë
Më i Larti
I Larti dhe i admirueshmi që banon në përjetësi
Krijuesi i qiellit dhe i tokës
Zoti mburoja jonë
Zoti forca jonë
Zoti drejtësia jonë
Perëndia i shpresës

Perëndia i shpëtimit tonë
I vetmi Perëndi i ditur
I vetmi Sundues i bekuar
Mbret i përjetshëm, i pavdekshëm, i padukshëm
Ati ynë në qiej

Mund të shohësh se në çfarë mënyrash të ndryshme e të mrekullueshme shkrimtarët e Biblës i janë drejtuar Perëndisë në lutje. Kopjoji ata! Admiroje Perëndinë duke ia kthyer emrat dhe titujt që ai ia ka dhënë vetes në fjalën e tij. Ato do të zgjojnë ndjenjat e tua shpirtërore dhe do të të ndihmojnë t`i flasësh Perëndisë në mënyrë adhuruese. Ato, gjithashtu, do të të japin besim t`i kërkosh atij që të bëj gjëra për ty, duke të bërë të njohur se sa e madhe dhe e fuqishme është dashuria, urtësia dhe pushteti i tij. Njerëzit e Perëndisë në Bibël e adhuronin atë, gjithashtu, duke e përshkruar në mënyra të tjera në lutjet e tyre. Në shembujt e mëposhtëm shiko se si shprehin ata admirim të thellë shpirtëror në mënyrën si i flasin Perëndisë:

‘Kush barazohet me ty midis perëndive, o ZOT? Kush barazohet me ty, i mrekullueshëm në shenjtëri, i madhërishtëm në lëvdata, o çudibërës?’ (Eksodi 15:11).

‘I bekuar je ti, o ZOT, Perëndi i Izraelit, ati ynë, për gjithë amshimin. Jotja, o ZOT, është madhështia, fuqia, lavdia, shkëlqimi, madhëria, sepse gjithçka që është mbi qiell dhe mbi tokë është jotja. E jotja o ZOT është mbretëria dhe ti ngrihesh sovran mbi gjithçka’ (1 Kronikave 29:10-11).

‘që në kohën e caktuar do ta tregojë i lumi e i vetmi sundimtar, Mbret i mbretërve dhe Zot i zotërve, ai që i vetmi e ka pavdekësinë dhe rri në dritë të paafrueshme, të cilën asnjë njeri nuk e ka parë kurrë dhe as mund ta shohë; atij i qoftë nderi dhe pushteti i përjetshëm. Amen’ (1 Timoteut 6:15-16).

‘të vetmit Perëndi të ditur, Shpëtimtarit tonë, i qoftë lavdi, madhështi, sundim dhe pushtet, tani dhe përjetë. Amen’ (Judë 25).

Shih se sa të lartësuar janë këto lutje admirimi. Ato fokusohen te vetë Perëndia – kush është ai, çfarë është ai, te natyra dhe cilësitë e tij të shkëlqyera, lartësimi, madhështia dhe shenjtëria e tij. Ky adhurim admirimi i mrekullueshëm të jep një mësim të rëndësishëm në jetën tënde shpirtërore: **nuk duhet t'i kufizosh lutjet e tua për t'i kërkuar Perëndisë që t'i bëjë gjërat për ty.** A është një ndjenjë nevoje apo ndjenjë fajësie e vetmja gjë që do të të afrojë ty me Perëndinë? A do të vish te Perëndia sepse je bosh dhe pastaj ta harrosh atë sepse je plot? Mos u përqendro vetëm te vetja kur lutesh. Perëndia është pafundësisht i bukur në vetvete dhe bukuria e tij duhet të të tërheqë si një magnet drejt tij. A mund të mendosh për një përdorim më të mirë të fuqive të tua, sesa t'i vësh ato në funksion të admirimit të Zotit tënd të bukur? Ky aspekt i lutjes nuk varet nga gjendjet dhe rrethanat e tua të ndryshueshme. Në çfarëdo gjendje që mund të jesh, Perëndia është gjithmonë atje, në përsosmërinë e pandryshueshme të bukurisë dhe lavdisë së tij supreme, për ta frymëzuar shpirtin tënd për të adhurar.

Admirimi i Perëndisë do të ketë një efekt të shëndetshëm në përvojën tënde shpirtërore. Kur e admiron atë, ti largohesh nga vetja jote dhe vështron nga ai në gjithë dashurinë dhe madhësinë e tij të pamasë. Kjo do t'ju japë jetë të re ndjenjave të tua shpirtërore. Është kaq e lehtë për të krishterët të mërziten dhe të dëshpërohen në jetën e tyre shpirtërore. Të ulesh pranë këmbëve të Perëndisë, ta shohësh atë në përsosmërinë e tij të pastër dhe të këndshme dhe ta admirosh për këtë, do të të ndihmojë t'i hedhësh tutje mendimet e errëta; kjo do të sjellë rifreskim dhe shëndet në shpirtin tënd. Do të të ndihmojë të shërohesh nga tendenca jote natyrore të shohësh veten dhe të fiksohesh në mëkatet dhe problemet e tua. Në të vërtetë, e gjithë jeta jote shpirtërore do të vuajë, nëse ti nuk e admiron shpesh Mbretin e bukur të qiellit në lutjet e tua.

'Por nuk mund të jem gjithmonë duke admiruar Perëndinë.' Kjo është e vërtetë. Ka diçka të lodhshme dhe dërmuese përse i përket përqendrimit të mendjes vazhdimisht mbi Perëndinë vetë. Do të zbulosh se mendja jote po largohet nga qenia pafundësisht e lavdishme e Perëndisë, te veprat e tij. Admirimi ia lë vendin lavdërimit. (Kujtohu që adhurimi i Perëndisë për veprat e tij është ajo që unë e kam quajtur 'lavdërim'). Veprat e Perëndisë zbulojnë një pjesë të vogël të lavdisë së tij kohë pas kohe dhe ti do ta kesh më të lehtë ta durosh atë, sesa bukurinë e pastër dhe të plotë të qenies së tij.

Ti mund të gjesh strehë në një gjë të veçantë që Perëndia ka bërë, të shohësh se si një pjesë nga aspekti i lavdisë së tij zbulohet në të, dhe ta lavdërosh për këtë.

Në qoftë se dëshiron të shohësh se si njerëzit e Perëndisë e lavdëruan atë në lutjet e tyre për gjithçka ai kishte bërë, të sugjeroj të lexosh librin e Psalmeve. Shumë prej tyre i thurin lavdi Perëndisë për veprat e tij shpirtërore dhe materiale:

‘Këndojini lavde Perëndisë tonë, këndojini lavde! Këndojini lavde mbretit tonë, këndojini lavde! Sepse Perëndia është mbreti i gjithë dheut, këndojini lavde me zotësi. Perëndia mbretëron mbi kombet; Perëndia ulet mbi fronin e tij të shenjtë.’ (Psalmi 47:6-8)

“Aleluja. Kremtoni Zotin, sepse ai është i mirë, sepse mirësia e tij vazhdon përjetë. Kush mund të përshkruajë bëmat e Zotit ose të shpallë tërë lavdinë e tij?...I bekuar qoftë Zoti, Perëndia i Izraelit, nga përjetësia në përjetësi. Dhe tërë populli le të thotë : ‘Amen!’ Aleluja!” (Psalmi 106:1-2,48)

‘ Zoti është i madh dhe i denjë për lëvdimin më të lartë dhe madhështia e tij është e panjohshme. Një brez do t’i shpallë lëvdimet e veprave të tua tjetrit dhe do t’i njoftojë mrekullitë e tua. Do të mendohem thellë mbi shkëlqimin e lavdishëm të madhësisë sate dhe mbi veprat e tua të mrekullueshme. Njerëzit do të flasin për fuqinë e veprave të tua të tmerrshme, dhe unë do të tregoj madhësitë tënde.’ (Psalmi 145:3-6).

Bashkësia jote me Perëndinë asnjëherë nuk do t’i afrohet qiellit, përveçse kur ti ta admirosh dhe ta lavdërosh atë. Banorët e qiellit po e admirojnë dhe lavdërojnë pa pushim Mbretin e tyre. “dhe nuk pushojnë kurrë, as ditë as natë, duke thënë: ‘I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë është Zoti Perëndi, i Plotfuqishmi, që ishte, që është dhe që do të vijë!’” (Zbulesa 4:8)

Ne, njerëzit e Perëndisë mbi tokë, duhet të imitojmë miqtë tanë qiellorë. Sa më shumë ta admirosh Perëndinë për atë që ai është, dhe sa më shumë ta lavdërosh për atë që ka bërë, aq më shumë do t’i gëzohesh shkëlqimit të tij frymëror në shpirtin tënd dhe do të harmonizohesh me ata që këndojnë këngën e re në praninë e Zotit. (Zbulesa 5:9-10) A ka mënyrë më të mirë për ta përgatitur veten për në qiell?

Pika për reflektim ose diskutim

Çfarë vendi do t`i jepje admirimit në lutjet e tua personale dhe publike?

A i përdor shpesh emrat dhe titujt e ndryshëm të Perëndisë kur i flet atij?

Çfarë thotë Bibla për ‘bukurinë’ e Perëndisë?

‘Këndojini lavde me zotësi (njohuri)’ (Psalmi 47:7; krahasoje me 1 Korintasit 14:15). Çfarë lidhje ka midis lavdërimit dhe njohurisë?

Kapitulli 3

Kërkesa dhe falenderimi

'Unë e kërkova ZOTIN, dhe ai më u përgjigj dhe më çliroi nga të gjitha tmerret e mia' (Psalmi 34:4).

Kur lutesh, po ashtu dhe kur adhuron Perëndinë, duhet të pranosh se sa shumë mbështetesh tek ai. Të mbështetesh te Perëndia nuk është diçka që njerëzit duan ta pranojnë, sidomos sot, me gjithë përparimet e vazhdueshme që po bëhen në shkencë. Njerëzit sot janë më të prirur për t'i kënduar lavde njeriut sesa Perëndisë: lavdi njeriut në lartësi dhe lavdi shkencës! Ideja e mbështetjes te Perëndia shuhet lehtësisht.

Përfundimisht, duhet t'i kthehemi një fakti të thjeshtë dhe përrulës: Ne nuk u krijuam vetë, Perëndia na krijoi. Si qenie të krijuara ne jemi të kufizuar; Perëndia ynë Krijues është i pakufizuar, por ka gjithfarë limitesh për jetën tonë nga të cilët nuk mund të ikësh. Mendo për një moment për veten. Nuk mund ta ndalosh veten nga uria apo të lodhurit. Njohuria jote, sado e madhe që mund të të duket, është me të vërtetë shumë e kufizuar. Nëse je i krishterë, dhe vetë jeta jote shpirtërore madje do të ketë kufizimet e saj; ti përpiqesh t'i afrosh Perëndisë, por shpejt e gjen veten tek i kthehesh i raskapitur botës së krijuar. Duhet ta pranosh: 'Sa i dobët që jam, sa i vogël dhe sa i paditur!'

Vetëm kur e kupton se sa nevojtar je, zbulon një tjetër nga 'ngjyrat shpirtërore' të lutjes – atë që unë e quaj 'kërkesë'. Kjo, thjesht, do të thotë t'i kërkosh Perëndisë të të japë bekimet për të cilat ke nevojë. Duke ndjerë se sa i dobët je, ti kthehesh te Perëndia dhe i kërkon të të japë ca nga fuqia e tij e pamasë. Duke kuptuar se sa pak di, ti kthehesh te Perëndia dhe i kërkon të ndajë me ty ca nga dituria e tij e përsosur.

Duke e ndjerë se ti s`mund ta ndihmosh veten, dhe se sa e paaftë është bota të të ndihmojë, ti i thua mirupafshim vetes dhe botës; kthehesh te Krijuesi yt i mëshirshëm, në mënyrë që ai të të japë ndihmën, ngushëllimin dhe paqen që të duhen, të cilat vetëm Perëndia mund të t`i sigurojë.

Si aspekt i lutjes, kërkesa nuk është diçka që të aplikohet vetëm se ti je plot me mëkate. Është e dukshme se ke nevoja që ngrihen mbi mëkatet e tua, siç është nevoja për falje dhe rilindje. Por ti ke gjithfarë nevojash të tjera thjesht si një qenie e krijuar. Kujto Adamin dhe Evën përpara se të mëkatonin. Ata akoma mbështeteshin te Perëndia për të gjitha bekimet që pasuronin jetët e tyre aq mrekullueshëm në parajsë. Ata kishin nevojë për Perëndinë që t`i mbante gjallë dhe të vazhdonte të kujdesej për ta duke u siguruar ushqim, pije dhe bekimin e shoqërisë së tij. Nuk mendoj se do të kishte qenë e gabuar nga ana e tyre të shprehnin njohjen e mbështetjes së tyre te Perëndia, duke i kërkuar atij të vazhdonte të siguronte për nevojat e tyre.

Atëherë, lutja-kërkesë na aplikohet si qenie të krijuara, jo thjesht si mëkatarë. E them këtë sepse ka një dimension të tërë nevoje dhe kërkesë, e cila rrjedh më shumë nga natyra jonë mëkatore sesa nga natyra jonë njerëzore. Dua që këtë dimension tjetër ta shohim në kapitullin vijues nën titullin: 'Rrëfimi dhe përgjërimi'. Këtu po theksoj faktin që lutja-kërkesë, pra t`i kërkojë Perëndisë bekimet e jetës, është në mënyrë absolute kryesore për marrëdhënien ndërmjet nesh dhe Krijuesit tonë. Mbështetja në Perëndinë është kushti yt natyror si një qenie e krijuar. Kurrë nuk do të mund t`i largohesh, madje dhe atëherë kur përfundimisht do t`i largohesh mëkatit për në qiell. Kështu, kërkesa është shumë mirë një pjesë natyrore e marrëdhënies tënde me Perëndinë; është pjesë e të qenit njerëzor. Ti bëhesh akoma më shumë njerëzor ndërsa e dorëzon frymën tënde krenare, të pavarur, dhe i beson përlësisht Perëndisë përmes lutjes që të sigurojë të gjitha nevojat prej pasurisë së burimeve të tij hyjnore.

Bibla ka plot shembuj të lutjes-kërkesë. Më e famshme është sigurisht ajo në Lutjen e Zotit; 'Bukën e përditshme na e jep sot' (Mateu 6:11). Ja dhe disa të tjera:

'Në ankthin tim kërkova ZOTIN dhe i klitha Perëndisë tim; ai e dëgjo zërin tim nga tempulli i tij dhe zëri im arriti para tij, në veshët e tij' (Psalmi 18:6).

'Por unë jam i varfër dhe nevojtar; o Perëndi, nxito të më vish në ndihmë; ti je ndihma ime dhe çlirimtari im; o ZOT, mos vono' (Psalmi 70:5).

'Na ndihmo, o ZOT, Perëndia ynë, sepse ne mbështetemi te ty dhe dalim kundër kësaj shumice në emrin tënd' (2 Kronikave 14:11).

'mos më jep as varfëri as pasuri, më ushqe me bukën e nevojshme, me qëllim që, pasi të jem ngopur, të mos të të mohoj dhe të them: 'Kush është Zoti?', ose pasi të jem bërë i varfër të mos vjedh dhe të përdhos emrin e Perëndisë tim'' (Fjalët e Urta 30:8-9).

'O ZOT i ushtrive, nëse dëshiron t'i japësh shërbëtores sate një fëmijë mashkull, unë do t'ia jap ZOTIT për të gjitha ditët e jetës së tij dhe brisku nuk ka për të kaluar mbi kokën e tij' (1 Samuelit 1:11).

'Jepi, pra, shërbëtorit tënd një zemër të zgjuar në mënyrë që të administrojë drejtësinë për popullin tënd dhe të dallojë të mirën nga e keqja' (1 Mbretërve 3:9).

Këtu shihni njerëz që i kërkojnë Perëndisë t'i bekojë me qetësi dhe ndihmë, çlirim nga varfëria dhe stresi, fuqi në fatkeqësi, sasinë e duhur të ushqimit dhe parave, të dhuruarit e një fëmije dhe njohje shpirtërore dhe morale. Inkurajohu nga shembulli i tyre. Të gjitha nevojat e tua çoja Perëndisë në lutje-kërkesë. Nëse nuk e bën, po pretendon se je i vetëmjaftueshëm dhe i pavarur nga Perëndia – dhe kjo do të ishte të jetuarit e një gënjeshtre.

Nëse kuptimi i mbështetjes te Perëndia të bën të lutesh për bekime, ai gjithashtu duhet të të frymëzojë që ta falenderosh atë për bekimet që ke marrë më parë. Është njësoj sikur kuptimi i mbështetjes i jep jetë dy binjakëve të quajtur 'kërkesë' dhe 'falenderim': kërkesa ngre lart duar të zbrazura lutjeje për Perëndinë që t'i mbushë, falenderimi përulet me një lutje mirënjohjeje për dhuratat e dhëna. Në zemër të kësaj praktike dypalëshe të kërkesës dhe falenderimit shtrihet njohja jote se Perëndia është burimi i të gjitha të mirave të vërteta, burimi i të gjitha dhuratave dhe bekimeve.

‘Çdo gjë e mirë që na jepet dhe çdo dhuratë e përsosur vjen prej së larti dhe zbret nga Ati i dritave, pranë të cilit nuk ka ndërrim dhe as hije ndryshimi’ (Jakobi 1:17). Ja, pse i lutesh Perëndisë që t`i plotësojë nevojat e tua. Ja, përse duhet gjithashtu ta falenderosh atë kur nevojat e tua plotësohen prej pasurive të tij hyjnore.

Ndoshta mund ta kesh kuptuar që falenderimi, ashtu si kërkesa, është patjetër i rëndësishëm për marrëdhënien tënde me Perëndinë si Krijuesi yt. Nëse e pranon këtë marrëdhënie, ti duhet t`i jesh mirënjohës Perëndisë për çdo gjë të mirë që gëzon në jetë. Mungesa e mirënjohjes do të thotë se ti po përpiqesh të tregosh se bekimet e tua nuk ia detyron Perëndisë. Kjo do të ishte një tradhti e plotë e identitetit tënd si dikush që ai e krijoi dhe e mbështet. Do ta mbështesje jetën tënde mbi një gënjeshtër të madhe. Në anën tjetër, sa më mirënjohës të tregohesh ndaj Perëndisë për gjërat e mira të cilave u gëzohesh, aq më shumë ti do të përmbushësh identitetin tënd të vërtetë si një qenie e krijuar; jeta jote do të mbështetet në të vërtetën. Kështu, atë që thashë për kërkesën mund ta them përsëri për binjaken e saj, falenderimin: është pjesë e të qenit njerëzor. Personi më falenderues është personi më njerëzor. Ja disa shembuj të lutjeve falenderuese në Bibël:

‘Është bukur të kremtosh ZOTIN, dhe të këndosh lavdet në emrin tënd, o Shumë i Larti; të shpallësh në mëngjes mirësinë tënde dhe çdo natë besnikërinë tënde’ (Psalmi 92:1-2).

‘Kremtoni ZOTIN, sepse ai është i mirë, sepse mirësia e tij vazhdon përjetë. Kështu thonë të shpenguarit prej Zotit që ai i ka çliruar nga dora e kundërshtarit...Le të kremtojmë ZOTIN për mirësinë e tij dhe për mrekullitë e tij në dobi të bijve të njerëzve. Sepse ai ka ngopur shpirtin e etur dhe e ka mbushur me të mira shpirtin e uritur’ (Psalmi 107:1-2, 8-9).

‘Pastaj mori kupën, falenderoi... pastaj mori bukën, falenderoi, e theu...’ (Lluka 22:17, 19).

‘Ne përherë e falenderojmë Perëndinë për ju të gjithë, duke ju kujtuar në lutjet tona’ (1Thesalonikasve 1:2).

‘Ne të falenderojmë, o Zot, Perëndi i Plotfuqishmi, që je, që ishe dhe që do të vish, sepse more në dorë pushtetin tënd të madh, dhe mbretëron’ (Zbulesa 11:17).

Thashë se këto aspekte të ndryshme të jetës rrjedhin dhe shkrihen me njëra-tjetrën si ngjyrat e spektrit, dhe se nuk mund t'i dallojmë qartë ato. Kështu do të vini re se si ato që i kam quajtur ‘lavdërim’ dhe ‘falenderim’ mund të jenë emra të ndryshëm për shprehjen e të njëjtës ndjenjë. ‘Hyni në portat e tij me falenderim dhe në oborret e tij me lavde’ (Psalmi 100:4). Psalmisti këtu nuk ka pasur në mendje të bëjë ndonjë dallim të qartë midis lavdërimit dhe falenderimit.

Megjithatë, unë i kam përdorur këto dy fjalë të ndryshme duke u përpjekur të tregoj një ndryshim në theksin e tyre. Nëse e adhuron Perëndinë për bukurinë dhe lavdinë e tij dhe ti i shikon këto të shkëlqejnë prej diçkaje të veçantë që Perëndia ka bërë, interesi yt kryesor është se me çfarë ajo vepër hyjnore të tregon për vetë Perëndinë. Është disi ndryshe nëse Perëndia të tregon diçka ty personalisht, apo ndikon te miqtë e tu; interesi yt, atëherë, do të jetë përfitimi i drejtpërdrejtë nga puna e Perëndisë ndaj teje ose ata që ti do. Në të dyja rastet përgjigjja jote do të shprehë dashurinë që ke për Perëndinë, për veprën e tij të mrekullueshme. Por falë theksit të ndryshëm, unë vendosa ta thërras të parin ‘lavdërim’ sepse është kaq afër admirimit, dhe të dytin ‘falenderim’ për shkak të afërsisë së saj me kërkesën. Për aq kohë sa të kuptoni se nuk ka ndonjë dallim të theksuar ndërmjet tyre, nuk do të jeni duke ecur gabim. Nuk ka rëndësi nëse thoni se po ‘falenderoni’ Perëndinë për një vepër që zbulon lavdinë e tij, apo e lavdëroni atë për një vepër nga e cila përfiton ti apo të dashurit e tu. Gjëja më e rëndësishme në të vërtetë është ta falenderosh dhe ta lavdërosh atë në lutjet e tua ‘për mrekullitë e tij në dobi të bijve të njerëzve’ (Psalmi 107:8).

Pika për reflektim ose diskutim

‘Mbështetja te Perëndia është kushti yt natyror si qenie e krijuar.’ Sa e ndjen veten të mbështetur te Perëndia? Trego mënyra se si shoqëria në të cilën jetoni dobëson ose shkatërron varësinë ose mbështetjen tënde te Perëndia.

Nëse do t`ju duhej t`i kërkonit Perëndisë të plotësonte nevojat e tua, si mund të dalloni çfarë keni nevojë dhe çfarë dëshironi?

Gjeni disa shembuj të tjerë të lutjes kërkesë në Bibël. Çfarë ju mësojnë?

Diskutoni mëkatën e mosmirënjohjes. Si mund të bëhemi njerëz më mirënjohës?

Kapitulli 4

Rrëfimi dhe përgjërimi

'Po të themi se jemi pa mëkat, gënjejnë vetveten dhe e vërteta nuk është në ne. Po t'i rrëfejme mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi' (1 Gjon 1:8-9).

'Ngjyrat shpirtërore' të lutjes që kemi parë deri tani – admirimi, lavdërimi, kërkesa, falenderimi – të gjitha i përkasin marrëdhënies kryesore ndërmjet qenieve inteligjente dhe krijuesit të tyre. Është pjesë e identitetit tënd si burrë apo grua i krijuar nga Perëndia për t'u lutur sipas këtyre mënyrave. Adami dhe Eva, para rënies, duhet të jenë lutur po kështu.

Tani vijmë te një 'ngjyrë shpirtërore' e re dhe më e errët në spektrin e lutjes: t'i rrëfesh mëkatet e tua Perëndisë dhe t'i kërkohesh atij mëshirë; këto nuk janë gjëra që i përkasin marrëdhënies thelbësore ndërmjet qenieve njerëzore dhe Krijuesit të tyre. Adami dhe Eva nuk duhet të jenë lutur në këtë mënyrë. Hyrja e mëkatit në botë i ka shtuar të luturit njerëzor një ngjyrë dhe ton të ri. Ti duhet t'i lutesh tani atij, jo vetëm si qenie e krijuar që të bëri dhe të mban, por si një mëkatar ndaj atij që të gjykon dhe mund të të dënojë ose të falë, të të shkatërrojë ose të shpëtojë.

Mëkati, mosbindja ndaj ligjit të shenjtë të Perëndisë, të bën fajtor në sytë e Perëndisë. Ti mund të mos **ndihesh** fajtor, por ti **je**. Është një fakt moral objektiv. Si një mëkatar fajtor, është detyra jote t'i rrëfesh mëkatin Perëndisë. Kryesisht, rrëfim do të thotë të biesh dakort me Perëndinë në pikëpamjen e tij për mëkatin; ti e sheh mëkatin njësoj si ai.

Shpesh është e lehtë të shohësh **pasojat** shqetësuese të mëkatit në jetët e njerëzve, por ty do të të duhet të shkosh më tej. Duhet të kuptosh se sa i shëmtuar dhe i urryer është në vetvete mëkati, në natyrën e vet të errët. Të duhet ta shohësh në kontrast me bukurinë dhe pastërtinë e karakterit të përsosur të Perëndisë. Atëherë do ta shohësh mëkatin njësoj si ai, si diçka të sëmurë, të neveritshme që nuk mund të përshkruhet me fjalë.

Kur e sheh mëkatin në këtë mënyrë, do të kuptosh se do ta urresh. Mos ki frikë të përdorësh gjuhë të ashpër për të shprehur ndjenjat e tua për mëkatin. Rrëfimi i vërtetë sjell një frikë të shenjtë që djeg dhe zemërim ndaj gjithë mëkatit, sepse mëkati është një hajdut i poshtër që i heq Perëndisë nderin e tij, dhe po ashtu i vjedh mëkatarit paqen e tij.

Duke ndjekur këtë përbuzje të shenjtë ndaj mëkatit, rrëfimi gjithashtu përfshin të kaluarit e gjykimit ndaj tij në ndërgjegjen tënde. Perëndia e dënon mëkatin si një krim kundër vetes së tij që meriton dënimin me vdekje të përjetshme. Nëse e sheh si ai, ti do t'i bësh jehonë këtij verdikti në ndërgjegjen tënde. Do të rrëfesh se Perëndia është i drejtë në të gjykuarin dhe të dënuarin e mëkatit kaq ashpër. Përfundimisht, rrëfimi i vërtetë përfshin pendimin për mëkatin dhe braktisjen e tij. E pranoj se nuk mund të jetë e lehtë për ty të thyesh zakonet e mëkatit. Fatkeqësisht, shpesh mund ta gjesh veten të ngatërruar përsëri në rrjetën nga e cila po përpiqesh të shkëputesh. Por në momentin që ti me të vërtetë i rrëfen mëkatin Perëndisë, është dëshira jote e sinqertë për të qenë i lirë përgjithmonë nga lidhja e tij. Nëse kjo nuk është dëshira jote e ndershme, rrëfimi yt është si të luash në dramë. Po gënjejesh, madje po përpiqesh të gënjejesh dhe Perëndinë.

Mund të kesh dëgjuar që të krishterë që thonë se një besimtar i justifikuar nuk duhet t'i rrëfejë Perëndisë fajin e tij, sepse tashmë Perëndia e ka larë atë me anë të gjakut të Jezu Krishtit. Duket si lojë fjalësh. Është e vërtetë se, si një i krishterë, ti nuk je më fajtor në kuptimin e të qenit përgjegjës për ndëshkim. Megjithatë, ti e ndjen se përsëri e meriton ndëshkimin nga i cili je shpëtuar. Ajo ndjenjë e asaj që ti meriton është ajo që lind nevojën për rrëfim. Ti bie dakort me Perëndinë se e meriton t'i largohesh syve të tij, edhe pse ai të mirëpret dhe të pranon për hir të Krishtit.

Nëse nuk e ke ndjerë se ti meritoje dënimin e drejtë të Perëndisë më shumë sesa mëshirën e tij, si mund të kesh ndonjë vlerësim të vërtetë për mëshirën e tij?

Të rrëfyerit e mëkateve, atëherë, është një aspekt i rëndësishëm i jetës tënde lutëse. Ja, disa shembuj të njerëzve të Perëndisë në Bibël që i rrëfejnë Perëndisë mëkatet e tyre:

‘Nuk ka asgjë të shëndoshë në mishin tim për shkak të zemërimit tënd; nuk ka qetësi në kockat e mia për shkak të mëkatit tim. Paudhësitë e mia e kalojnë në fakt kohën time, janë si një barrë e madhe, shumë e rëndë për mua. Plagët e mia janë të fëlliqura dhe të qelbëzuara nga marrëzia ime’ (Psalmi 38:3-5).

‘Sepse i pranoj të ligat që kam bërë, dhe mëkati im më rri gjithnjë përpara. Kam mëkatuar kundër teje, dhe kam bërë atë që është e keqe në sytë e tu’ (Psalmi 51 3-4).

‘qofshin veshët e tu të vëmendshëm dhe sytë e tu të hapur për të dëgjuar lutjen e shërbëtorit tënd që tani ta drejton ty ditën dhe natën për bijtë e Izraelit, shërbëtorët e tu, duke rrëfyer mëkatet e bijve të Izraelit, që ne kemi kryer kundër teje. Po, unë dhe shtëpia e atit tim kemi mëkatuar. Jemi sjellë shumë keq me ty dhe nuk kemi respektuar urdhërimet, statutet dhe dekretet që ti i ke urdhëruar Moisiut, shërbëtorit tënd’ (Nehemia 1:6-7).

‘Ndërsa unë po flisja akoma, duke u lutur dhe duke rrëfyer mëkatin tim dhe mëkatin e popullit tim të Izraelit dhe po paraqisja lutjen time para ZOTIT, Perëndisë tim...’ (Daniel 9:20).

Ndiq shembullin e këtyre njerëzve të perëndishëm. Rrëfeja Perëndisë mëkatet. Nëse nuk e bën, marrëdhënia jote me Perëndinë asnjëherë nuk do të jetë në rregull. ‘Kush i fsheh shkeljet e tij nuk do të ketë mbarësi; por ai që i rrëfen dhe i braktis ato, ka për të fituar mëshirën’ (Fjalët e Urta 28:13).

Ashtu siç thashë më parë për kërkesën dhe falenderimin, ka një dimension të plotë të ri kërkesë që duhet t`i shtosh lutjeve të tua në llogari të mëkatëve të tua. Duhet t`i kërkoh Perëndisë të të falë dhe gjithashtu të të çlirojë nga pushteti i mëkatit. Këtë e kam quajtur ‘përgjërim’, por në të vërtetë është tamam një lutje-kërkesë në lidhje me mëkatin.

Është e qartë se nuk ka kuptim të rrëfesh mëkatet e tua, nëse nuk i kërkon Perëndisë të t`i falë. Në fakt, të lutesh për falje është shumë e rëndësishme, saqë Zoti Jezu Krisht e bëri atë pjesë të modelit të lutjes ditore për ndjekësit e tij: ‘Na i fal fajet tona, ashtu siç ua falim ne fajtorëve tanë’ (Mateu 6:12). Ka dy gjëra për të cilat dua të ndalem këtu. E para, kur rrëfen mëkatet dhe i kërkon Perëndisë falje, ti nuk po i lutesh dikujt që mund të thotë ‘Jo’. Në ungjill, Perëndia ka premtuar t`i falë të gjithë ata që i afrohen atij nëpërmjet Zotit Jezu Krisht, që rrëfejnë mëkatet e tyre dhe kërkojnë mëshirë. Përgjigjja e tij është gjithmonë ‘Po’. Si mund të vonohesh të rrëfesh mëkatin tënd dhe të kërkoh faljen e Perëndisë, po të jetë rasti? ‘Lum ai të cilit i kanë falur shkeljen, ai të cilit i kanë mbuluar mëkatin!...Para teje pranova mëkatin tim, nuk e fsheha paudhësinë time. Thashë: “Do t`ia rrëfej shkeljet e mia ZOTIT” dhe ti e ke falur paudhësinë e mëkatit tim’ (Psalmi 32:1,5).

Pika e dytë është se në këtë lutje, Krishti mëson se nuk mund të kërkoh falje prej Perëndisë nëse nuk je gati të falësh njerëzit që të kanë lënduar. Perëndia i ka lidhur këto dy gjëra bashkë; ai dëshiron rrëfim dhe përgjërim për të shuar flakët e zemërimit dhe të së keqes në zemrën njerëzore. Nëse dëshiron të marrësh faljen e Perëndisë, duhet të kesh një frymë falëse ndaj të afërmit tënd. Kështu, kur i afrosh Perëndisë për t`i rrëfyer mëkatet e shumta që ke kryer, duhet të të mbushë me keqardhje për gabimet e të tjerëve. ‘Dhe kur nisni të luteni, nëse keni diçka kundër ndokujt, faleni që dhe Ati juaj që është në qiejt, t`ju falë mëkatet tuaja’ (Marku 11:25).

Ashtu siç i kërkon Perëndisë të të falë, po ashtu duhet t'i kërkohet atij të të çlirojë nga pushteti i mëkatit, ta pastrojë zemrën tënde nga ndotja. Këtë gjë e bëri dhe Mbreti David pasi kishte shkelur kurorën me Bathsheban. Ai i rrëfeu mëkatit të tij Perëndisë, kërkoi falje, dhe gjithashtu u lut që Perëndia ta pastronte në brendësi: 'O Perëndi, krijo tek unë një zemër të pastër dhe përtëri tek unë një frymë të patundur' (Psalmi 51:10). Braktisja e mëkatit të rrëfyer është e rëndësishme për rrëfimin e vërtetë, por nuk mund të pushosh së mëkatuari pa ndihmën e Perëndisë. Ja përse përgjërimi përfshin të luturit për hirin shenjtëruës si dhe për falje. 'Përkule zemrën time parimeve të tua dhe jo lakmisë. Largoji sytë e mi nga gjërat e kota dhe gjallëromë në rrugët e tua' (Psalmi 119:36-37).

Pika për reflektim ose diskutim

Si mund të bindësh veten dhe të tjerët të kenë ndjenjë fajësie për mëkatit? Kur një ndjenjë faji është e gënjeshtërt dhe jo e shëndetshme?

Çfarë lloj gjërash mund ta ndalojnë dikë t'i rrëfejë Perëndisë mëkatet e tij? Cilat janë pasojat e mëkatit të parrëfyer?

Deri ku duhet t'ia rrëfeni mëkatet tuaja të tjerëve?

Gjej më tepër shembuj në Bibël të njerëzve që luten për shenjtërimin e tyre. Zgjidhi dhe diskutoni dy prej tyre. Psalmi 119 është një vend i mirë për të filluar.

Kapitulli 5

Ndërmjetësimi

'Vëllezër, lutuni për ne' (1 Thesalonikasve 5:25).

Tani vijmë në një tjetër dimension të lutjes-kërkesë: të luturit për njerëzit e tjerë. Kjo është kaq e rëndësishme, sa që zakonisht të krishterët e thërrasin me një emër të veçantë 'ndërmjetësim', po kështu kam vepruar dhe unë.

Bibla, në shumë vende na mëson se duhet të lutemi jo vetëm për nevojat tona, por edhe për njëri-tjetrin. Apostulli Pal shpesh lutej për të tjerët dhe kërkonte që të tjerët të luteshin për të:

'Edhe i lutem Perëndisë që të mos bëni ndonjë të keqe' (2 Korintasve 13:7).

'Nuk pushoj së falenderuari për ju dhe duke ju kujtuar në lutjet e mia, që Perëndia i Zotit tonë Jezu Krisht, Ati i lavdisë, t'ju japë juve frymën e diturisë dhe të zbulesës, në njohurinë e tij' (Efesianët 1:16-17).

'Dhe ju bëj thirrje, o vëllezër, për Zotin tonë Jezu Krisht dhe për dashurinë e Frymës, të luftoni bashkë me mua në lutje te Perëndia për mua' (Romakëve 15:30).

'Ngulmoni në të lutur, duke ndenjor zgjuar në të me falenderim. Dhe duke u lutur në të njëjtën kohë edhe për ne, që Perëndia të hapë edhe për ne derën e fjalës, për të shpallur misterin e Krishtit, për shkakun e të cilit jam edhe i burgosur, në mënyrë që ta bëj të njohur duke e folur siç duhet' (Kolozianëve 4:2-4).

Pali i siguronte miqtë e tij se ai po lutej për ta dhe, po ashtu u kërkonte atyre të luteshin për të. Sa për shembuj të vërtetë njerëzish që ndërmjetësojnë për të tjerët, ne gjejmë lutje të këtij lloji si në Dhjatën e Vjetër ashtu dhe në të Re-në. Shih, për shembull, lutjen e Abrahamit për Sodomën te Zanafilla 18:23-32, lutjen e Moisiut për Izraelin te Eksodi 32:11-14 dhe te Ligji i Ripërtërirë 9:25-29, dhe lutja e Shpëtimtarit tonë për njerëzit e tij te Gjoni 17.

Ndërmjetësimi del nga fakti se ne njerëzorët jemi nga natyra qenie shoqërore. ‘Sepse asnjë nga ne nuk jeton për veten e tij dhe askush nuk vdes për veten e tij’ (Romakët 14:7). Këtë të vërtetë mund ta vësh re lehtësisht në vetë jetën tënde. Vetë lindja jote të vendosi në një rrjet marrëdhëniesh njerëzore përmes familjes. Këto marrëdhënie shumohen gjatë udhëtimit tënd në jetë duke takuar njerëz dhe duke lidhur miqësi. Ti nuk mund të zgjedhësh që të dalësh nga raca njerëzore. Sikur të përpiqeshe, do të dhunoje çdo instikt të natyrës tënde, i cili të tregon se ti nuk je një individ i vetëm dhe i izoluar, por një anëtar i njerëzimit. Në përputhje me këtë të vërtetë, Perëndia dëshiron që ti të hysh në praninë e tij për t`u lutur si anëtar i racës njerëzore. Mbaj mend që, përveçse ta duash atë, Perëndia kërkon të duash të afërmit e tu. A ka mënyrë dashurie më të vërtetë sesa kur i ngre lart në krahët e lutjes dhe i çon ata para Perëndisë? Lutja bëhet ushtrim i dashurisë më të lartë kur ti harron nevojat dhe mëkatet e tua, merr problemet dhe shqetësimet e njerëzve të tjerë dhe i vendos ato në zemrën e Perëndisë.

Perëndia e ka bërë secilin nga ne mbajtësin e vëllait të tij. Në të gjitha marrëdhëniet tona ne jemi mbrojtësit e njëri-tjetrit. Kjo do të thotë se ti je përgjegjës për ndikimin që ke mbi të tjerët. Apostulli Pal ishte shumë i shqetësuar për ndikimin që mund të kishte sjellja e tij te të krishterët e tjerë: ‘Prandaj në qoftë se një ushqim skandalizon vëllanë tim, unë nuk do të ha më kurrë mish, që të mos e skandalizoj vëllanë tim’ (1 Korintasve 8:13). Sa më e afërt të jetë lidhja, aq më i çmuar është besimi që Perëndia të ka dhënë. ‘Sepse çfarë di ti, o grua, nëse ke për ta shpëtuar burrin? Ose ç`di ti, o burrë, nëse ke për ta shpëtuar gruan?’ (1 Korintasve 7:16).

Por si mund të veprosh vërtet si mbrojtësi i vëllezërve dhe i motrave të tua, nëse nuk lutesh për ta? Ka gjithfarë bekimesh që në të vërtetë ti nuk ke pushtet t'ia japësh ndonjërit. E vetmja gjë që mund të bësh, është të shkosh te Perëndia dhe të lutesh që ai t'ia japë ato bekime të afërmit tënd. Kështu mos u bëj si Kaini që mohoi se kishte ndonjë përgjegjësi për vëllanë e tij. Pranoje përgjegjësinë tënde. Lutu për vëllanë tënd.

Lutja ndërmjetësuese është pjesë e marrëdhënies ndërmjet besimtarëve në trupin e madh shpirtëror të kishës. Ti i përket miqve të tu të krishterë dhe ata të përkasin ty. 'Dhe nëse vuan një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët vuajnë; kurse po të nderohet një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të' (1Korintasve 12:26). Në të luturin ndërmjetësues, kisha mbledh bashkë nevojat e ndryshme të të gjithë anëtarëve të saj dhe ia paraqet me dashuri Perëndisë. Ne afrohemi me njëri-tjetrin në dobësinë që ndajmë si qenie të krijuara dhe mëkatarë fajtorë, dhe së bashku pastaj i lutemi si një trup i vetëm Perëndisë së hirit që mund të na ndihmojë të gjithëve.

Të ndërmjetësuarit për të tjerët do të ketë një ndikim pozitiv në shpirtin tënd. Do të të ndihmojë të kontrollosh tendencën që ke (e përbashkët për të gjithë të krishterët), për të qenë i përqendruar te vetja madje dhe në jetën tënde shpirtërore. Nëse lutesh shumë për të tjerët, të ndihmon të harrosh veten dhe të bën më dashamirës ndaj të afërmit tënd. Mbreti David na jep një shembull të mirë të këtij shpirti joegoist në Psalmin 51. Kjo është lutja që ai bëri pasi kreu mëkatin me Bathshebën. Ai nuk mund ta derdhte fajin dhe turpin e tij para Perëndisë pa shtuar një lutje për popullin e Perëndisë: 'Bëj të mirën Sionit për dashamirësinë tënde, ndërto muret e Jeruzalemit. Atëherë do të gëzohesh në flijimet e drejtësisë, në olokaustet dhe në ofertat që digjen tërësisht; atëherë do të ofrohen dema të rinj mbi altarin tënd' (vargjet 18-19). Kërkoji Perëndisë të të bëjë si Davidi: një ndërmjetësues, madje dhe në mes të mëkateve të tua të rënda dhe nevojave të tua të mëdha.

Pika për reflektim ose diskutim

Lexo një nga lutjet ndërmjetësuese të përmendura në këtë kapitull – Abrahamin që lutet për Sodomën, Moisiun për Izraelin, Zotin Jezu Krisht për kishën e tij. Çfarë mund të mësoni prej tyre?

Apostulli Pal u kërkoi të tjerëve të luteshin për të. Kur e bëni ose kur duhet ta bëni të njëjtën gjë?

Shpesh lutemi për nevojat fizike të njëri-tjetrit. Si mund të sigurohemi se lutemi për nevojat shpirtërore të njëri-tjetrit?

Në ç`mënyra mund të përmirësojmë aspektin ndërmjetësues të lutjeve tona, si individë por edhe si kishë?

Kapitulli 6

Përfitimet shpirtërore të të luturit

'I cili po lutet' (Veprat e Apostujve 9:11).

Nëse ndërton zakonin e të luturit në jetën tënde, ai do të ketë ndikimin më të thellë shpirtëror në ty. Në fakt, lutja është një nga mënyrat kryesore që përdor Perëndia për të të edukuar nga ana shpirtërore. Vetëm në shkollën e lutjes shpirti yt do të zhvillohet, do të zgjerohet dhe do të arrijë kënaqësinë më të lartë.

Mendoje kështu: Në zemrën tënde ka dëshira të thella të cilat nuk mund të plotësohen prej gjërave të krijuara. Këto dëshira të çojnë te Perëndia, Krijuesi yt, si i vetmi që mund të të sjellë kënaqësi dhe përmbushje të vërtetë. Por ka një largësi kaq të madhe midis shpirtit tënd dhe Perëndisë! Si mund ta arrish atë? Në mirësinë e tij të pamasë, Perëndia ka siguruar një urë që të çon tek ai. Kjo urë është lutja. Duke udhëtuar përmes kësaj ure te Perëndia, dëshirat e tua më të mëdha do të plotësohen.

Për shembull, ti ke një kuriozitet natyror, etje për njohuri; dëshiron të kuptosh se përse egziston, kuptimin e jetës dhe se si duhet të jetosh. Vetëm Perëndia mund ta shuajë këtë etje të madhe. Ai është burimi i gjithë njohurisë, gjithë dritës dhe diturisë. Mënyra e vetme se si mund të gjesh kënaqësi për mendjen tënde, është të shkosh te Perëndia përmes urës së lutjes dhe të hysh në miqësi me të, mendjen më të lartë, burimin e diturisë dhe të së vërtetës. 'Po kështu asnjëri si njeh gjërat e Perëndisë, përveç Fryma e Perëndisë. Dhe ne nuk kemi marrë frymën e botës, por Frymën që vjen nga Perëndia, që të njohim gjërat që na janë dhuruar falas nga Perëndia' (1 Korintasve 2:11-12).

Konsidero dhe faktin që u krijove për të dashur. Zemra jote mund të gjejë gëzim të vërtetë vetëm nëpërmjet dashurisë – përmes të dashurit dhe të qenit i dashuruar. Por shih rreth teje: nuk ka asgjë në këtë botë objektësh të krijuara, të vogla dhe të kufizuara që mund të kënaqë me të vërtetë aftësinë tënde për dashuri. Ka një arsye të fortë për këtë. Perëndia ka për qëllim ta gësh kënaqësinë vetëm tek ai, duke e dashur atë, Krijuesin e dashur. Vetëm Perëndia është aq i madh sa duhet për të përmbushur aftësinë e zemrës tënde për të dhënë dhe marrë dashuri. Kështu, zemra jote duhet të shkojë tek ai përmes urës së lutjes dhe të hyjë në një lidhje të bekuar me të. ‘Unë jam e të dashurit tim dhe i dashuri im është imi’ (Kantiku i kantikëve 6:3).

Gjithashtu ke një uri të madhe për bukurinë. Ti përballesh me të në gjërat rreth teje. Gjatë gjithë historisë, njerëzit janë përpjekur të riprodhojnë ose të krijojnë bukuri në skulpturë, pikturë, muzikë, poezi dhe prozë. Megjithatë, në fund të ditës, këto vepra arti njerëzore si dhe bukuritë e krijimit nuk mund të të kënaqin. Ti pyet veten: ‘Ku është bukuria e vetme dhe origjinale, burimi i bukurisë, veç të cilit të gjitha këto gjëra tokësore janë vetëm një reflektim i errët dhe i turbullt?’ Përgjigjja është – Perëndia. Reflektimet e errëta të bukurisë tokësore nxjerrin në pah bukurinë e vetë Krijuesit. Vetëm ai mund ta kënaqë urinë tënde. Duhet ta shohësh fytyrën e tij duke shkuar tek ai përmes urës së lutjes. ‘Një gjë i kërkova ZOTIT dhe atë kërkoi: të banoj në shtëpinë e ZOTIT tërë ditës e jetës sime, për të soditur bukurinë e ZOTIT dhe për të admiruar tempullin e tij’ (Psalmi 27:4).

Shih, pra, se si Perëndia e edukon shpirtin tënd përmes lutjes duke ushqyer dëshirat e tua për të vërtetë, dashuri dhe bukuri, dhe duke të mësuar t`i zbulosh ato tek ai. Largoju shkollës së lutjes dhe kurrë nuk do t`i mësosh këto gjëra. Ti do të jesh një injorant shpirtëror, i cekët dhe i pazhvilluar dhe i paaftë për të kuptuar gjërat e Frymës. Po të mendohesh me kujdes për shkollën e lutjes, do të kuptosh se si të luturit forcon çdo pushtet që Perëndia i ka dhënë shpirtit tënd, dhe i shkrin ato së bashku në një harmoni të mrekullueshme.

Lutja e sjell natyrën tënde njerëzore në përsosmëri. (Kjo është tërësisht ndryshe nga idetë që kanë njerëzit e botës për burrin ose gruan e përsosur; sa nga heronjtë e tyre luten?) Për shembull, ti me të vërtetë nuk mund të lutesh pa menduar se çfarë po bën. Në fjalët e psalmistit: ‘Kam shqyrtuar rrugët e mia dhe i kam kthyer hapat e mia ndaj urdhrave të tua’ (Psalmi 119:59), ‘Kam shqyrtuar’, ka një kuptim të gjerë në atë frazë të vogël. Përpara se të nxjerrësh një fjalë të vetme lutjeje, të duhet të mendohesh. Të duhet të përdorësh mendjen. Ke nevojë të dish se kujt po i lutesh. Të duhet të dish se përse po lutesh. Duhet të dish bazat mbi të cilat po i ofron këto lutje. Kështu, nëse lutjet e tua janë të vërteta dhe jo disa fjalë rituale të pamenduara, ato do të të përfshijnë në një përdorim energjik të të kuptuarit tënd. Ndërsa fillon të lutesh, do të shqyrtosh veten, motivet e tua, sjelljen e kaluar, fatin e ardhshëm. Do të kërkosh në të gjithë atë që mund të dish, ndoshta për atë Zot të bukur dhe të lavdishëm në praninë e të cilit të sjellin lutjet e tua. Kur vërtet flet me të, do të harxhosh të gjitha pasuritë e inteligjencës tënde duke e admiruar, lavdëruar, duke i kërkuar dhe falenderuar me kujdes. Nuk është vetëm të kuptuarit, por dhe ndërgjegjja jote gjithashtu që zgjohet në lutje. Vetëm në lutje më shumë se kudo tjetër, ndërgjegjja mbron të drejtat e saj mbretërore. Ndërsa hyn në praninë e shenjtë të Perëndisë përmes lutjes, ndërgjegjja jote të vendos ballë për ballë me përgjegjësitë e tua morale; ajo mban dhe shfaq një regjistrim se sa besnik ke qenë në zbatimin e këtyre përgjegjësive; ajo mbërthen te ty sensin e drejtë të fajit ose miratimit. Një ndërgjegje vepruese dhe e shëndetshme varet nga një jetë lutjeje vepruese dhe e shëndetshme. Një ndërgjegje e vdekur ose që po vdes është një simptomë e tmerrshme që lutja është e vdekur ose po vdes në shpirtin tënd. Të luturit gjithashtu i jep jetë zemrës tënde, emocioneve të tua shpirtërore. Ndërsa lutesh, vizioni yt shpirtëror do të bëhet më i qartë. Do të shohësh se mirësia nuk është vetëm detyra jote, por dhe e bukur dhe e dëshirueshme gjithashtu; dhe se mëkati jo vetëm që është i gabuar, por dhe i neveritshëm.

Lutja e vërtetë e bën zemrën të zbrapset me tmerr nga e keqja dhe të nxitojë me dëshirë të papërmbajtur për të përqaftuar të mirën.

Pra, mund të kuptoni se si të luturit e forcon dhe e përsos natyrën tënde njerëzore duke vendosur në punë inteligjencën, ndërgjegjen dhe ndjenjat, duke i harmonizuar ato rreth Perëndisë. Burri apo gruaja e përsosur është ai ose ajo që është përsosur nëpërmjet lutjes. Injoroje lutjen, dhe jo vetëm që braktis Perëndinë, por shkatërron dhe veten si qenie njerëzore.

E kam quajtur lutjen një 'urë' përmes së cilës ti mund të shkosh te Perëndia. Të gjitha përfitimet shpirtërore që sapo kam përmendur varen në të vërtetë nëse ti e merr rrugën dhe e takon Perëndinë.

Bashkësia me të është lavdia e shkëlqyer e lutjes. Mendo: ti, një qenie e krijuar mëkatore dhe e kufizuar, të kesh bashkësi-lutjeje personale me Krijuesin tënd të shenjtë e të pakufizuar! Ashtu siç thotë dhe proverbi: 'Më thuaj me kë rri të të them se cili je', Solomoni thotë: 'Kush shkon me të urtët bëhet i urtë' (Fjalët e Urta 13:20). Çfarë mund të themi atëherë për një person, i cili i gëzon përditë bashkësinë me Mbretin e mbretërve? Lutja nuk mund të jetë një punë e parëndësishme, nëse përfshin bashkësi mes shpirtit tënd dhe Sovranit të shenjtë të universit.

Bashkësia jote me Perëndinë nëpërmjet lutjes ka një numër tiparesh të shkëlqyera. E para, është shumë personale. Bashkësia e çdo besimtari me Zotin është thellësisht intime dhe individuale, një marrëdhënie një me një midis Perëndisë dhe fëmijës së tij. Kjo është shumë e vërtetë në lutjen private. 'Por ti, kur lutesh, futu në dhomëzën tënde, mbylle derën dhe lutju Atit tënd në fshehtësi' (Mateu 6:6). Ky aspekt individual i lutjes është, gjithashtu, i vërtetë kur bashkohesh me të krishterë të tjerë për t'u lutur si grup ose si kishë. Secili besimtar akoma përjeton kontaktin e vet personal me Perëndinë. Një gjë e çuditshme e të luturit me të krishterë të tjerë është se çdo notë lutjeje individuale shkrihet me gjithë të tjerat për të krijuar një lloj simfonie adhurimi. Po ku do të ishte simfonia pa notat individuale? Bashkësia jote me Perëndinë në lutje është i një besimi të plotë. Nuk ka vend për turp ose heshtje në lutje. Mëkate të cilat nuk do të guxonit t'ia pranoni mikut tuaj më të ngushtë njerëzor, ti ia rrëfen lirshëm Perëndisë që fal gjithçka.

Nëse po kalon kohë jo të mira aq sa nuk mund ta shprehësh me fjalë, fare thjesht mund të lëshohesh në krahët e Atit tënd dhe të qash. Ai do të të mbajë. Dhe në mënyrën më të mrekullueshme, Perëndia nuk është i turpshëm ose i heshtur kur lutesh vërtetë. Ai të jepet pa asnjë rezervë. ‘Sekreti i Zotit u tregohet atyre që kanë frikë prej tij, dhe ai u bën të njohur atyre besëlidhjen e tyre’ (Psalmi 25:14). Çfarë paqe derdh ai në zemrën tënde, kur të siguron për faljen e tij! Çfarë gëzimi ai fal ndonjëherë, kur si Moisiu ti i afrosh ‘errësirës së dendur ku ndodhet Perëndia’ (Eksodi 20:21)! Është pjesë e shkëlqimit të lutjes që ti dhe Perëndia i jepeni njëri-tjetrit plotësisht.

Marrëdhënia jote lutëse me Perëndinë, gjithashtu, të lidh me të gjitha cilësitë e tij hyjnore. Çfarëdo nevoje të kesh, do të gësh diçka në Perëndinë që do të të përshtatet dhe do ta plotësojë. Jeni i paqartë dhe i paditur? Mund të përdorësh thesaret e diturisë së tij të përsosur. Je i dobët, copë-copë dhe i rraskapitur? Mund të marrësh prej furnizimeve të fuqisë së tij të pashterueshme. Je i papastër dhe i korruptuar? Mund të lejosh që lumenjtë e tij të pastërtisë shëndet-dhuruese të derdhen mbi ty. A e ke zemrën të plagosur, të gjakosur dhe të shuar prej shqetësimit? Mund të pish nga pusi i pamasë i gëzimit të tij të lartë. Ti, vazhdimisht mund të mbushësh boshllëkun e shpirtit tënd nga burimet e përjetshme të natyrës së Perëndisë – burim nga i cili do të pish përgjithmonë në parajsë. Perëndia do të plotësojë gjithçka që ti ke nevojë, me gjithçka që ai është.

Bashkësia jote me Perëndinë në lutje do të të japë një pamje të duhur të kohës dhe përjetësisë. Kur e kalon urën e lutjes ndeshesh me dy fjalë ndeshen: i dukshmi dhe i padukshmi. Lutja e ngre shpirtin tënd prej gërmadhëve shkatërruese në praninë e ‘Mbretit të amshuar, të pavdekshmit, të padukshmit’ (1Timoteut 1:17). Kufijtë e kohës dhe të hapësirës zhduken dhe ti futesh në parajsë dhe në përjetësi ‘për të shijuar mrekullitë e jetës së ardhme’ (Hebrenjtë 6:5). Për shkak se lutja të sjell ballë për ballë me Perëndinë e përjetshëm, të bën të kuptosh se bota që mund të shohësh është nën kontroll të një bote më të madhe, që nuk mund ta shohësh. Si rezultat, fillon ta orientosh jetën në dritën e asaj bote më të lartë.

Në këtë mënyrë, bashkimi në lutje me Perëndinë ndihmon që të të lirojë nga të qenit i skllavëruar në botën fizike të ndjesive të tua; ai ndërton supremacinë e shpirtërores mbi fiziken. Nëse nuk lutesh, kurrë nuk do të kesh një vlerësim të vërtetë mbi marrëdhënien midis tokës dhe parajsës, kohës dhe përjetësisë. Një person që nuk lutet është si një i burgosur i mbyllur në errësirën e ngushtë të së tashmes. Por besimtari që lutet është si një shqiponjë që ngrihet përmes qiellit, në dritën e diellit të përjetshëm.

Atëherë, mund të kuptosh se çfarë pasurish të pafundme e të pahulumtueshme do të vijnë duke u derdhur në shpirtin tënd nga bashkësia me Perëndinë përmes lutjes. A mund të rrish pa u lutur? Por ende nuk kam mbaruar. Ka akoma përfitime të tjera shpirtërore që do t'i shijosh prej një praktike të rregullt lutjesh. Sa për fillim, a ke menduar ndonjëherë për efektin që do të ketë në shenjtërimin tënd të përditshëm? Nëse dëshiron 'të zhveshësh njeriun e vjetër që korruptohet me anë të lakmive të gënjeshtres dhe të ripërtërihesh në frymën e mendjes tënde, dhe të vishesh me njeriun e ri, të krijuar sipas Perëndisë në drejtësinë dhe shenjtërinë e së vërtetës' (Efesianët 4:22-24), duhet të vazhdosh në lutje. Të luturit do të ushqejë, thellojë dhe forcojë parimet e shenjta të mendjes së ripërtërirë që Perëndia të ka dhënë në Krishtin. Ndërsa hyn në praninë e Perëndisë përmes lutjes, mendja jote e njeh atë në gjithë përsosmërinë e tij. Ti përulesh me një ndjenjë respekti para madhësisë së tij. Ti ndjen një përzierje frike dhe besimi ndërsa sheh në drejtësinë e tij të pakopromentueshme. Zemra jote shkrihet nga tërheqja dhe mirënjohja, ndërsa sheh hirin dhe dhembshurinë e tij. Duke e sjellë Perëndinë në këtë mënyrë para teje, lutja shenjtëron proceset e të menduarit në adhurim; ajo e transformon gjithë mënyrën tënde të të menduarit. Nëse lutesh rregullisht, këto veprime të brendshme adhurimi do të kthehen në zakone të gjata, dhe ana shpirtërore e natyrës tënde do të ketë një zotërim më të madh mbi orekset e mishit.

Lutja e rregullt do të të forcojë në luftën kundër mëkatit. E gjithë bindja e vërtetë ndaj Perëndisë buron nga një zemër që e do atë. Padiskutim që gjithë mosbindja buron nga një zemër që është larguar prej tij. Nëpërmjet të luturit, nëse është një lutje e vërtetë, godet tamam në rrënjët e atij egoizmi.

Lutja të sjell në praninë e Perëndisë dhe përul zemrën tënde krenare në pluhur përpara madhësisë së tij tejkaluese, shenjtërisë dhe sovranitetit të tij. Ti i thua atij: ‘U shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë vullneti yt’ (Mateu 6:9). Kjo do të thotë se ti duhet ta lësh fiksimin tënd mëkatar që ka të bëjë me emrin tënd, mbretërinë tënde të vogël dhe vullnetin tënd. Nëpërmjet të luturit ti thyen vetë-përqendrimin tënd natyror duke bërë të njohura nevoja të cilat vetëm Perëndia mund t’i plotësojë, duke rrëfyer mëkate të cilat vetëm Perëndia mund t’i falë dhe duke falenderuar për bekime që vetëm Perëndia i ka siguruar. Lutja e udhëheq zemrën tënde rebele nën varësinë e Perëndisë duke të bërë më pak të përqendruar te vetja dhe më tepër tek ai.

Të luturit do të të bëjë më të përshtatshëm nga ana shpirtërore për detyrat praktike të jetës. Kjo është e vërtetë madje edhe kur lutjet e tua nuk kanë të bëjnë me detyrat dhe rrethanat tokësore. Thjesht, të adhuroarit e Perëndisë dhe të kënaqurit me të në lutje do të të kthejë në konfliktet e jetës me freski dhe forca të ripërtërira. Në mënyrë akoma dhe më të qartë ky është rasti kur lutjet e tua lindin nga domosdoshmëritë e jetës në botën e sotme. Nëse kërkon dituri dhe drejtim, kjo e thëllon ndjenjën tënde të detyrimit për të ndjekur vullnetin e Perëndisë kur arrin të dallosh. Nëse i pranon Perëndisë sa i dobët ndihesh, ky pranim të pengon të harxhosh atë pak fuqi që ke në aktivitete të gabuara. Nëse i kërkon Perëndisë të të ndihmojë në ndonjë situatë të veçantë, po kjo lutje do të ushqejë durim dhe kurajo për të bërë vullnetin e Perëndisë në atë situatë. Në këto mënyra dhe në shumë të tjera, lutja do të ketë një ndikim të fshehtë, por të fuqishëm në jetën dhe karakterin tënd.

Lutjet e rregullta do ta ngrenë gjithashtu përvojën tënde shpirtërore mbi kontrollin e gjendjeve të ndryshueshme dhe ta bëjnë atë më të qëndrueshme dhe më të balancuar. Shpesh, gjendjet tona mund të na drejtojnë në mënyrë të gabuar përse i përket gjendjes së vërtetë të shpirtit tanë. Të krishterët e rinj në veçanti priren të mendojnë se të ndihesh i lumtur është një shenjë e sigurt e një shpirti të shëndetshëm, dhe të ndihesh i mërzitur është shenjë e sigurt e një shpirti të sëmurë. Por kjo nuk është e vërtetë. Gjendjet e tua ndikohen nga të gjitha llojet e faktorëve joshpirtërorë.

Për shembull, temperamenti yt natyror do t'j japë ngjyrë të gjitha emocioneve të tua. Ana fizike e trupit tënd, në shëndet apo sëmundje, do të ketë një ndikim të madh në mënyrën se si ndihet shpirti yt. Rrethanat e tua të jashtme, nëse je i suksesshëm dhe ke mbarësi ose je i thyer dhe i hidhëruar, natyrisht do të të ngrenë ose do të të dëshpërojnë. Gjendja jote emocionale ka po ashtu një ritëm të brendshëm të vetin, një sekuençë natyrore ngritjesh dhe uljesh.

E gjithë kjo do të thotë se duhet të jesh shumë i kujdesshëm në përdorimin e ndjenjave të tua si udhëheqës drejt gjendjes tënde shpirtërore. Të duhet të dallosh me kujdes ndërmjet emocioneve vërtet shpirtërore të cilat janë lulëzim i këndshëm i karakterit të krishterë, dhe ndjenjave të tjera të cilat lindin nga faktorë joshpirtërorë.

Pikërisht, në këtë rast mund të të ndihmojnë zakonet e rregullta të lutjes. Lutja do t'j japë mendjes tënde qartësi dhe ton shpirtëror, ndërsa e lini mbrapa tokën dhe hyni në bashkësi me Perëndinë. Kjo të ndihmon të besosh dhe t'j besosh Perëndisë në bazën e patundur të Fjalës së tij, madje edhe atëherë kur çdo gjë rreth teje është e errët. Të luturit gjithashtu ushqen besimin, shpresën dhe durimin në mënyrë që ato të bëhen zakone të forta dhe të përhershme të mendjes tënde. Atëherë, mund të strehohesh te Perëndia për t'j larguar gjithë paqartësisë së rrethanave dhe gjendjeve të tua të ndryshueshme.

Praktika e rregullt e lutjes e ngre shpirtin tënd mbi hijet emocionale ndryshuese të shkaktuara nga faktorë joshpirtërorë dhe të ndihmon ta bësh përvojën tënde të krishterë më të qetë, më të paqtë dhe më të qëndrueshme.

Pika për reflektim ose diskutim

Nëse lutja është në qendër të jetës së krishterë aq sa thuhet në këtë kapitull, a mendoni se ka mjaft mësim për të në kishë? Sa e rëndësishme është lutja në jetën e shpirtit tënd dhe në kishën tënde?

‘Të luturit fuqizon dhe përsos natyrën tënde njerëzore’. Sa vend zë praktika e lutjes në idenë tënde të burrit ose gruas së përsosur? Po idetë e shoqërisë, skenat e filmave, shfaqjet televizive dhe romanet?

Zgjidh dhe diskuto dy nga mënyrat që ky kapitull thotë se lutja do të kontribuojë në shenjtërimin tuaj.

Kapitulli 7

Bekimet e Perëndisë dhe lutja-kërkesë

'dhe ndodhi që, kur Moisiu ngrinte dorën e tij, Izraeli fitonte; përkundrazi, kur e ulte dorën, fitonte Amaleku' (Eksoki 17:11).

Deri tani kam folur për ndikimin që ka lutja mbi **ne**. Po çfarë ndikimi ka ajo mbi **Perëndinë**? A mund të flasim për lutje që e 'ndikojnë' atë? Pastaj, ne shpesh i kërkojmë Perëndisë në lutje-kërkesë që të bëjë gjëra për ne, dhe ne presim që diçka të ndodhë përveç efektit frymëror që lutja jonë ka patur mbi shpirtrat tanë. Nuk do të kishte shumë kuptim në të luturit 'bukën e përditshme na e fal sot', nëse lutja do të kishte ndikim vetëm frymëror në shpirtrat tanë! Duhet të mendojmë me kujdes dhe në mënyrë të qartë. Pavarësisht nga shprehja e njohur 'fuqia e lutjes', lutja në të vërtetë nuk ka ndonjë fuqi në vetvete. Nuk është ndonjë formulë magjike e cila mund të bashkojë duart e Perëndisë dhe ta bëjë atë në gjendje të veprojë. Më mirë mendo për të në këtë mënyrë: kur Perëndia vendos të na japë disa dhurata, ky është një vendim i lirë dhe sovran nga ana e tij; por gjithashtu ai na nxit dhe na frymëzon të lutemi, kështu që, të luturit tonë bëhet porta përmes së cilës dhurata e tij hyn te ne. Ashtu siç ka e thënë dikush: 'Kur Perëndia e zgjidh gjuhën tënde me një kërkesë, kjo ndodh për shkak se ai dëshiron të të japë diçka'.

Mund ta shohësh se si funksionon ky parim kur apostulli Pal flet për lutjen - kërkesë te Rom. 8:26-27.

‘Po ashtu, edhe Fryma na ndihmon në dobësitë tona sepse ne nuk dimë çfarë të kërkojmë në lutjet tona, sikurse duhet; por vetë Fryma ndërhyt për ne me psherëtima të patregueshme. Dhe ai që heton zemrat e di cila është mendja e Frymës, sepse ai ndërhyt për shenjtoret, sipas Perëndisë’. Pali na tregon këtu se Fryma e Shenjtë është fuqia sekrete pas lutjes sonë dhe se ai ndërhyt ‘sipas Perëndisë’. Perëndia Atë, në diturinë dhe sovranitetin e tij, e ka vendosur tashmë se çfarë dhuratash dhe bekimesh do të nisë. Perëndia Frymë e Shenjtë, vullneti i të cilit është një me atë të Atit, krijon në zemrën e besimtarit një dëshirë korresponduese për këto dhurata dhe bekime. Besimtari lutet për to. Kështu që Ati ‘që heton zemrat’ e sheh qëllimin e bekimit të tij të reflektuar në lutjen e besimtarit. Fryma e Shenjtë ka krijuar një harmoni shpirtërore midis vullnetit të besimtarit dhe vullnetit të Atit. Kjo harmoni është kanali që Perëndia kënaqet ta përdorë për të na bekuar.

Disa të krishterë mendojnë se sovraniteti i Perëndisë largon çdo kuptim prej lutjeve tona, përveç efektit që lutja jonë ka te ne. Nëse (thonë ata) Perëndia tashmë ka vendosur se çfarë bekimesh do të japë, e gjithë ajo që mund të bëjnë lutjet tona është të na sjellë në një gjendje pritëse të mendjes dhe të na bëjë gati për t’i marrë ato bekime. Tani, ndërsa është e vërtetë që lutjet tona na çojnë në një gjendje pritjeje, mendoj se bëjnë më shumë se kaq. Nëse gjithë ajo që po bëjmë në lutjet tona është thjesht të përgatisim veten tonë, përse t’ia drejtojmë lutjet Perëndisë? Mendohu. Nëse po i flet Perëndisë thjesht për të ndikuar në veten tënde, lutjet e tua bëhen të pavërteta. Ti fare mirë mund të mos i lutesh Perëndisë, por thjesht të mendosh **për** Perëndinë. Por lutja e vërtetë është një proces kërkesash me Perëndinë. Ti përqendrohesh tek ai si dhënë, jo te vetja jote si marrës.

Kështu, nuk është e mjaftueshme të themi se lutja thjesht na bën gati të marrim bekimet e Perëndisë. Është më shumë se kaq. Lutja shpreh një marrëdhënie të vërtetë personale ndërmjet teje dhe Perëndisë. Perëndia të ka dhënë inteligjencë, ndjenja, ndërgjegje dhe vullnet. Ai dëshiron që t’i përdorësh plotësisht të gjitha në marrëdhënien me të.

Prandaj të ka thënë ta praktikosh lutjen si një portë përmes së cilës ai dëshiron që bekimet e tij të vijnë te ty. Perëndia dëshiron të të përfshijë personalisht bashkë me të në mënyrën se si të bekon. Ai e bën këtë përmes dhuratës së lutjes ndërsa flet me të, i shpreh nevojat e tua, i kërkon dhe vendos vullnetin tënd në vullnetin e tij. Rezultati është se ti ‘punon për shpëtimin tënd me frikë dhe me dridhje’ ndërsa në të njëjtën kohë ‘Perëndia është ai që vepron në ty vullnetin dhe veprimtarinë, sipas pëlqimit të tij’ (Filipianët 2 12:13). Vullneti yt dhe vullneti i Perëndisë, puna jote dhe puna e Perëndisë të bashkuara në një mënyrë të mistershme.

Në fakt, ndodh e njëjta gjë me lutjet e tua ashtu si dhe me pjesën tjetër të jetës. Zoti sovran i universit kontrollon gjithçka, por kontrolli i tij nuk do të thotë se ai shkel ose nuk i konsideron mendjen, ndjenjat, ndërgjegjen apo vullnetin tënd. Ai në mënyrë sovrane punon tek ato, me to dhe përmes tyre. Mendo për një fermer që lëron tokën, mbjell farën dhe e kultivon atë. Dikush i afrohet dhe i thotë: ‘Pse po mundohesh për ta bërë këtë? A nuk ke dëgjuar për sovranitetin e Perëndisë? Perëndia ka një dituri të përsosur dhe di si ta rrisë këtë bimë pa ndërhyrjen tënde. Perëndia është përsosmërisht i mirë dhe sido që të jetë do ta bëjë të rritet, kështu që bima do të rritej çfarëdo që të bëje sepse qëllimet e Perëndisë janë të përjetshme dhe të pandryshueshme. Përse nuk shkon në shtëpi dhe lëre Perëndinë të vazhdojë me këtë?’

Ky lloj argumenti do të na linte të paralizuar, në rast se duke bërë diçka kemi ofenduar sovranitetin e Perëndisë. Por nuk është kjo mënyra se si Perëndia e kontrollon botën. Puna e tij nuk e pengon tënden. Ai punon në punën tënde, me punën tënde dhe përmes punës tënde. E njëjta gjë ndodh me lutjen. Perëndia është ‘frymëzuesi dhe dëgjuesi i lutjes’. Ai punon **në, me dhe përmes** të luturit tënd. Kështu ai të jep një mundësi të plotë për aktivitetin e mendjes, ndjenjave, ndërgjegjes dhe vullnetit tënd në sigurimin e bekimeve të tij. Nëse ai do të të jepte çdo gjë pa bërë që t’ia kërkojë, ti do të ishe më

shumë si një kafshë që nuk mund të arsyetojë sesa një person. Duke të bërë që të kërkosh, Perëndia të ngre në dinjitetin e lartë të të qenit një person në një marrëdhënie personale me të vetë. Nuk duhet të mendoni atëherë, se sovraniteti i Perëndisë i heq ndonjë kuptim lutjeve – kërkesë, përveç efektit që kanë mbi ty. Lutjet e tua vetë janë pjesë e sovranitetit të Perëndisë; ai vetë nxit dhe frymëzon të luturin si portë për ardhjen e dhuratave të tij, kështu që ai mund të nderojë qenien tënde si person në mënyrën se si të bekon. Kështu, lutja - kërkesë ka një ndikim shenjtërues te ty, por përveç saj ajo gjithashtu, shpreh marrëdhënien personale mes teje dhe Perëndisë, e cila është lavdia e të qenit i krishterë.

Pika për reflektim dhe diskutim

Në ç`mënyra mund ta trajtojmë lutjen sikur ajo të ishte një formulë magjike?

Si mund të dëmtojë jetët tona shpirtërore veçanërisht të luturit tonë, një kuptim i gabuar (gënjeshtërt) i sovranitetit të Perëndisë?

Nëse Perëndia do të na e jepte çdo gjë pa u lutur, si do ta ndryshonte kjo marrëdhënien tonë me të?

Kapitulli 8

Lutja dhe Ati Perëndi

“Kur të luteni thoni: ‘Ati ynë që je në qiej...’ (Luka 11:2).

Kur lutesh, nuk duhet të mendosh për Perëndinë thjesht si ‘Zot’ apo ‘Krijues’, por si Trini. Në zbatimin e qëllimeve të mëdha për shpëtim të Perëndisë të regjistruara në Bibël, Perëndia ka zbuluar se natyra e tij hyjnore nuk egziston vetëm në një person, por në tre: Ati, Biri dhe Fryma e Shenjtë. ‘Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë’ (Mateu 28:19). Trinia do të thotë se ne adhurojmë një Perëndi në tre persona. Kjo e vërtetë e shenjtëruar ka ndërlikime të mëdha për lutjen.

Sa për fillim, ti mund t’i lutesh secilit prej tre personave të Trinisë, sepse secili prej tyre është vërtet dhe komplet Perëndi. Nuk janë tre perëndi, por një Perëndi: një qenie ose natyrë hyjnore që ka egzistuar përjetësisht si tre persona. Njësia e thellë e të qenit, të cilën e gëzojnë këta tre persona hyjnorë do të thotë se ata nuk mund të ndahen kurrë nga njëri-tjetri; kështu nuk duhet t’i ndash ata as në adhurim, por adhuroji të tre njësoj si Perëndia i vetëm i admirueshëm.

Përveç kësaj, çdo person i Trinisë luan një rol individual në shpëtimin tënd. Si person i shpëtuar, ti ke një marrëdhënie çliruese trepalëshe me Atin, me Birin dhe me Shpirtin e Shenjtë. Mund t’i lutesh çdo personi hyjnor në gjithçka që ka të bëjë me pjesën e tij të veçantë në shpëtimin tënd. Për shembull, ti mund t’i lutesh Atit, duke e lavdëruar që të ka adoptuar si fëmijën e tij të dashur. Mund t’i lutesh Birit,

duke e falenderuar që vdiq për ty, përderisa ishte Krishti, jo Ati apo Fryma e Shenjtë që u bë mish dhe e dha veten për ty..Mund t`i lutesh Frymës së Shenjtë gjithashtu si njërit, që banon në zemrën tënde dhe të shenjtëron.

Ajo që do të shohim në kapitujt e ardhshëm është marrëdhënia ndërmjet lutjes dhe rolet e ndryshme të luajtura prej tre personave të Trinisë në shpëtimin tonë. Do të fillojmë të konsiderojmë lutjen dhe Perëndinë Atë.

Gjëja e parë që duhet të kuptojmë këtu është: Perëndia Atë është përfaqësuesi zyrtar i të tre personave hyjnorë në lidhjet e tyre me ne. Ai vepron për të tërë Trininë, kështu në marrëdhënien tonë me të si Ati ynë, ne në të vërtetë i drejtohem Birit dhe Shpirtit gjithashtu. Ky rol përfaqësues i përket natyrshëm Atit sepse ai është personi **i parë** i Trinisë. Ka mundësi që disa prej lexuesve të mi të mos jenë të sigurt se çdo të thotë ta quash Atin personin e ‘parë’ të Trinisë, prandaj më lejoni t`jua shpjegoj.

Mes të tre personave të Trinisë, duke lënë mënjanë lidhjet e tyre me ne, ka një rregull të përjetshëm. Në këtë rregull Ati vjen i pari sepse ai është origjina ose burimi i dy personave të tjerë. Përtej gjithë limiteve dhe konceptimeve të kohës, Perëndia Atë lind Birin dhe fryn përjetësisht Frymën e Shenjtë. Kështu brenda jetës së Trinisë, Biri dhe Fryma rrjedhin nga Ati si përrenj uji që rrjedhin përjetësisht nga një burim i pakohë. Por, Ati vetë vjen nga askush. Në këtë kuptim, Perëndia Atë është personi i parë i Trinisë. Ai nuk është më shumë ‘Perëndi’ se Biri apo Fryma sepse ata ndajnë plotësisht natyrën hyjnore të Atit; por ai është burimi i tyre.

Atëherë, Ati zë vendin e parë në rregullin e përjetshëm të Trinisë. Kështu që, është e përshtatshme që ai duhet të zërë vendin e parë gjithashtu në rregullin në të cilin të tre personat veprojnë ndaj nesh. Ja

pse Bibla na e paraqet Atin si burimin e vetëm të shpëtimit tonë. Ai dërgoi Birin në botë; Biri nuk dërgoi Atin. Ai i dha Frymën e Shenjtë Birit në lumin Jordan; Biri nuk i dha Atit Frymën e Shenjtë. Biri ia ofroi veten në kryq Atit, dhe jo Ati Birit, etj. Çdo gjë na çon tek Ati.

Kështu, shpresoj se mund të kuptosh sa e natyrshme dhe e përshtatshme është për Atin, jo për Birin ose për Frymën, të zërë vendin e përfaqësuesit – ai i cili merret me ne në emër të të tre personave hyjnorë. Ja, përse Ati shpesh quhet ‘Perëndi’ në Bibël. Nuk është se Biri dhe Fryma nuk janë Perëndi, por sepse Ati i përfaqëson të tre. Dhe, ja përse mënyra e natyrshme dhe normale për ty të lutesh është, që t`i flasësh Perëndisë Atë si përfaqësuesi zyrtar i Trinisë në njësinë dhe tërësinë e saj. Ashtu siç thotë apostulli Pal, ti shkon te Ati **përmes** Birit **nëpërmjet** Frymës (Efesianët 2:18). Ose siç mëson Zoti Jezu Krisht në ‘lutjen model’: “Kur luteni thoni: ‘Ati ynë që je në qiej’” (Luka 11:2). Kjo nuk do të thotë se nuk do t`i lutesh kurrë Birit apo Frymës, por këto lutje do të jenë më shumë përjashtim sesa rregull. Zakonisht do t`i luteni Atit.

Më lejoni t`ju sugjeroj një arsye tjetër përse normalisht duhet t`ia drejtoni lutjet Perëndisë Atë. Ai është personi i Trinisë që mban pretendimet e ligjit hyjnor. Jam i sigurt se tashmë ti e di se planit të shpëtimit i duhet një zëvendësim për të kënaqur kërkesat e ligjit të Perëndisë për mëkatarët – t`i bindej urdhërimeve të tij dhe të vuante dënimet e tij për ne. Por nëse mëkatarëve u duhej një përfaqësues, po kështu i duhej edhe ligjit. Dikush, që e miraton ligjin nga ana e Perëndisë, është po aq i domosdoshëm sa dikush që i nënshtrohet ligjit për njerëzimin.

Bibla na tregon se personi i parë dhe i dytë i Trinisë mbajnë këto role përkatëse. Ati vepron si sunduesi dhe gjykatësi qiellor që mban autoritetin e ligjit; Biri vepron si zëvendësuesi i njerëzimit që i nënshtrohet kërkesave të shenjta të ligjit. Si miratues i ligjit, Ati pranon veprën shlyese të Birit për ne

dhe e deklaroi atë një bazë të drejtë për shpëtimin e mëkatarëve. 'Atë ka paracaktuar Perëndia për të bërë shlyerjen nëpërmjet besimit në gjakun e tij, për të treguar kështu drejtësinë e tij... me qëllim që ai të jetë i drejtë dhe shfajësues i atij që ka besimin e Jezusit' (Romakët 3:25-26). Kjo do të thotë se Perëndia Atë është i vetmi që zyrtarisht na bën të drejtë nga mëkatet tona dhe na siguron të gjitha bekimet e shpëtimit. 'Në qoftë se Perëndia është me ne, kush mund të jetë kundër nesh? Sepse ai që nuk e kurseu Birin e vet, por e dha për ne të gjithë, qysh nuk do të na dhurojë të gjitha gjërat bashkë me të? Kush do t'i padisë të zgjedhurit e Perëndisë? Perëndia është ai që i shfajëson. Kush është ai që do t'i dënojë?' (Romakët 8:31-34). ('Perëndia' këtu, qartësisht Perëndia Atë). Kështu duhet t'i lutesh Atit si të vetmit që mban në duart e tij administrimin e ligjit. Është Ati që ka autoritet të sigurojë faljen dhe jetën, që është bindja deri në vdekje e Birit të tij që ka blerë për mëkatarët.

Një tjetër arsye se pse duhet t'i luteni Atit është se ai është i vetmi që të adopton në familjen e tij si fëmijën e tij të dashur. Nga të gjitha fjalët që ne të krishterët përdorim për të përshkruar shpëtimin tonë, 'adoptimi' ndoshta është e vetmja që na jep pamjen më të madhe dhe më të pasur të asaj që Perëndia ka bërë për ne. Përshkrimet e tjera për shpëtimin janë si petalet e një luleje, të cilat i shkulim një nga një; kur arrijmë në zemër dhe në qendër të lules, atje gjejmë adoptimin.

Konsidero lavdinë e adoptimit! Ai të çon në ndryshimin e mrekullueshëm të statusit tënd ligjor nëpërmjet të cilit ti kalove nga të qenit një skllav i vërtetë, në një fëmijë të çmuar të Perëndisë me të drejtën e hyrjes për te Perëndia dhe me garancinë e trashëgimisë qiellore. 'Sepse ju nuk keni marrë një frymë skllavërie, që të keni përsëri frikë, por keni marrë frymën e birësisë, me anë të së cilës ne thërrasim: "Aba, o Atë!". Vetë Fryma i dëshmon frymës tonë që jemi bij të Perëndisë. Dhe nëse jemi bij, jemi dhe trashëgimtarë; si trashëgimtarë të Perëndisë ashtu edhe bashkëtrashëgimtarë të Krishtit' (Romakët 8:15-17). Gjithashtu ai të drejton në transformimin shpirtëror, nëpërmjet të cilit Perëndia të çliron së brendshmi nga pushteti i mëkatit, dhe të bën ty pasardhës shpirtëror duke ndarë në natyrën e

tij të shenjtë – me fjalë të tjera, lindjen dhe shenjtërimin e ri. ‘Shikoni ç`dashuri të madhe na dha Ati, që të quhemi bij të Perëndisë...Kush lindi nga Perëndia nuk kryen mëkat, sepse fara e Perëndisë qëndron në të dhe nuk mund të mëkatojë, sepse lindi nga Perëndia’ (1 Gjon 3:1, 9). Adoptimi gjithashtu, të drejton në lavdërimin tënd në qiellin e ri dhe tokën e re, ku ti merr trashëgiminë tënde të plotë si fëmijë i Perëndisë, e sheh Atin tënd ballë për ballë dhe kënaqesh me të përjetësisht. ‘vetë krijesa të çlirohet nga skllavëria e prishjes për të hyrë në lirinë e lavdisë së bijve të Perëndisë. Sepse e dimë se deri tani mbarë bota e krijuar rënkon dhe është në mundim. Dhe jo vetëm kaq, por edhe ne vetë që kemi frytet e para të Frymës, vajtojmë në veten tonë duke pritur birërimin, shpengimin e trupit tonë’ (Romakët 8:21-23). Në të vërtetë, adoptimi është si një sënduk thesari plot e përplot me margaritarë shpëtimi.

Adoptimi është bekimi më i lavdishëm; dhe Ati është personi i Trinisë që të adopton. Ai e ndryshon statusin tënd ligjor nga një skllav dhe i dëbuar, në një fëmijë të dashur dhe hedh mbi ty të gjitha bekimet dhe privilegjet që përfshin kjo marrëdhënie e re. Ja, këtu kemi një arsye tjetër të fortë që t`ia drejtosh lutjet e tua Atit. Shpirti që po lufton në agonitë e lindjes së re do t`i thërrasë Atit nga i cili vjen kjo lindje. Zemra që rropatet për t`iu larguar shpirtit të skllavërisë do t`i kërkojë Atit t`i japë Frymën e adoptimit. Dhe besimtari që po i gëzohet lirisë së lavdishme të të qenit fëmijë i Perëndisë do t`i japë falenderime Atit, krahët e të cilit e strehojnë atë.

Ja arsyeja e fundit që dua t`ju sugjeroj pse duhet t`i luteni Atit: ai është fokusi suprem për adhurimin e krishterë. Tashmë e dimë se sa i rëndësishëm është adhurimi si një nga aspektet e lutjes. Po ashtu kemi parë se si Bibla e zbulon Perëndinë si Atë, Bir dhe Frymë e Shenjtë, një Perëndi në tre persona; duhet t`i adhurosh të tre sepse ata janë një Perëndi. Por kemi parë se si Ati është personi i

parë i Trinisë. Ai është përjetësisht origjina e Birit dhe e Frymës që ka bërë të mundur egzistencën e bashkëbarabartëve të tij të përjetshëm, të cilët kanë të njëjtën natyrë të tij. Në këtë kuptim Ati është burimi i unitetit brenda Trinisë. Kështu, uniteti i Perëndisë shkëlqen specifikisht në personin e Atit. Gjithashtu, mbaj mend që Ati përfaqëson të tre personat në gjërat që ata merren me ne. Uniteti i gjithë veprave dhe aktiviteteve të Trinisë gjithashtu reflektohet te Ati.

Nga e gjithë kjo rrjedh se ti duhet të fokusosh adhurimin tënd ndaj Trinisë mbi personin e Atit. Të lutem, mos më keqkupto. Nuk do të thotë se duhet ta adhurosh atë veç Zotit Jezu Krisht dhe Frymës së Shenjtë. Sigurisht jo. Çfarë dua të them është kjo: kur e adhuron gjithë Trininë si Perëndi të vetëm pa i dalluar personat nga njëri-tjetri, atëherë duhet t'ia drejtosh adhurimin veçanërisht Atit. Ja pse ai vesh unitetin e Trinisë: edhe në jetën e përjetshme të të tre personave, edhe në marrëdhënien e tyre me ne. Pra, ti e bën Atin fokusin më të lartë për adhurimin tënd. Sipas fjalëve të Birit: 'Por vjen ora, madje ajo ka ardhur, që adhuruesit e vërtetë ta adhurojnë Atin në frymë dhe në të vërtetën, sepse të tillë janë adhuruesit që kërkon Ati' (Gjoni 4:23).

Pika për reflektim ose diskutim

Sa përqendrohesh te Ati në jetën dhe adhurimin tënd?

A mendon se i këndojmë aq sa duhet himne Atit Perëndi?

Çfarë është gabim kur i lutesh normalisht dhe rregullisht më shumë Jezusit, sesa Atit?

A na jep adoptimi ‘ idenë më të madhe dhe më të pasur të asaj që Perëndia ka bërë për ne’? Në qoftë se po, çfarë vendi duhet të zërë në mendimin dhe predikimin tonë?

Sugjeroni mënyrat në të cilat Bibla portretizon Atin si personin e ‘parë’ të Trinisë dhe ‘burimin e vetëm të shpëtimit tonë’.

Kapitulli 9

Lutja dhe Krishti si profeti ynë

'Zot, na mëso të lutemi' (Luka 11:1).

Tani do ta shohim lutjen në lidhje me Perëndinë Bir. Nuk do të mendojmë për të luturit **ndaj** Zotit Jezu Krisht, përderisa tashmë e kam konsideruar në kapitullin e kaluar. Çfarë do të bëjmë tani, është të shohim se si lutja lidhet me tre detyrat që Krishti mori përsipër në punën e shpëtimit - detyrën e profetit, priftit dhe mbretit. Do t'i shohim sipas kësaj radhe dhe do të fillojmë me lutjen në lidhje me detyrën e profetit të Krishtit.

Perëndia i premtoi Moisiut: 'unë do të nxjerr për ta një profet nga gjiri i vëllezërve të tyre dhe do të vë në gojën e tij fjalët e mia, dhe ai do t'u thotë atyre të gjitha ato që unë do t'i urdhëroj' (Ligji i Ripërtërirë 18: 18). Dhjata e Re e bën të qartë se ky profet është Zoti Jezu Krisht (Veprat e Apostujve 3:22-26). Atëherë, Krishti është profeti yt. Si i tillë ai të zbulon Perëndinë. Profetët e tjerë në Dhjatën e Vjetër kanë zbuluar diçka nga vullneti i Perëndisë, por Krishti e zbulon Perëndinë në mënyrë të përsosur. 'Perëndia, mbasi u foli së lashti shumë herë dhe në shumë mënyra etërve me anë të profetëve, së fundi, këto ditë na ka folur me anë të Birit' (Hebrenjtë 1:1-2).

Por asnjë qenie e krijuar nuk mund ta zbulojë zemrën e Perëndisë. Vetëm Krishti mund ta bëjë këtë, sepse ai ka plotësisht të njëjtën natyrë hyjnore me Atin. 'Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi... Askush se pa Perëndinë kurrë; i vetëmlinduri Bir që është në gjirin e t'Et, është ai që e ka bërë të njohur' (Gjoni 1:1,18).

Ndoshta mund të pyesësh: ‘Por a nuk thotë Bibla se Perëndia zbulohet në krijim? A nuk e zbulon krijimi Krijuesin?’ Po, kjo është e vërtetë. Pasazhe si Psalmi 19: 1-3 dhe Romakët 1:19-20 na e mësojnë këtë. Por edhe krijimi është vepra e Zotit Jezu Krisht. Para mishërimit të tij, ai, Perëndia Bir, krijoi universin nëpërmjet fuqisë së tij të lartë. ‘Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij, dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë’ (Gjoni 1:3). ‘Sepse në të u krijuan të gjitha gjërat, ato që janë në qiejt dhe ato mbi dhe, gjërat që duken dhe ato që nuk duken: frone, zotërime, principata dhe pushtete; të gjitha gjërat janë krijuar me anë të tij dhe në lidhje me të’ (Kolosianët 1:16). Pra, vetë krijimi është pjesë e aktivitetit të Krishtit për të të zbuluar Perëndinë.

Megjithatë, krijimi të jep vetëm një zbulues të largët të Perëndisë. Zemra jote mezi pret për një bashkim më intim dhe më personal me Krijuesin e saj. Kjo është veçanërisht e vërtetë në lidhje me mëkatshmërinë tënde. Zemra jote e rënduar prej fajit i thërret Perëndisë të të tregojë faljen dhe mëshirën e tij, të cilat krijimi nuk mund të t’i zbulojë kurrë.

Për të shuar etjen e zemrës tënde, Perëndia Bir, u bë njeri duke përmbushur detyrën e profetit. ‘Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne soditëm lavdinë e tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë’ (Gjoni 1:14). Si profeti yt, Zoti Jezu Krisht ta ka shpallur Perëndinë në mënyrë të përsosur. ‘Unë dhe Ati jemi një’ (Gjoni 10:30). ‘Kush më ka parë mua, ka parë Atin’ (Gjoni 14:9). Ja një zbulues e Perëndisë që i përshtatet saktësisht nevojave dhe dëshirave të tua si një qenie njerëzore mëkatore. Për shkak se je njerëzor, Biri manifestoi te ty natyrën hyjnore duke u bërë një njeri. Kështu, Zoti Jezu Krisht është Perëndia me fytyrë njerëzore. Ç’zbulues e ëmbël dhe tërheqëse: zemra e Perëndisë e hapur për ty në një jetë dhe shpirt njerëzor. Mund ta gjeshe dhe ta njohësh Perëndinë në anën njerëzore të Jezusit me më shumë intimitet sesa te yjet, pemët apo lulet. Dhe në Jezusin të shfaqet Perëndia jo vetëm si Krijues, por si Çliruesi yt i dhembshur që të sjell dhuratën çliruese të shpëtimit

dhe racës tënde të rënë. Këtu është mëshira për të cilën zemra jote mezi pret, të cilën nuk mund të ta japë asnjë meditim mbi yjet, pemët ose lulet.

Zbulesa e Atit, që ka bërë Jezusi, është ajo që të jep mundësinë të lutesh. ‘Ne nuk dimë çfarë të kërkojmë në lutjet tona, sikurse duhet’, thotë Pali. (Romakët 8:26). Si mund të lutemi, nëse nuk na mëson dikush? Ne pengohemi, përpiqemi nëpër errësirë derisa dëgjojmë zërin e Krishtit, profetit tonë, të na thojë: ‘Askush nuk vjen tek Ati, përveçse nëpërmjet meje’ (Gjoni 14:6). Krishti është i vetmi që t’i bën të njohura pasuritë e pafundme të dashurisë së Atit, dhe rrugën e shpëtimit nëpër të cilën Perëndia udhëheq për në parajsë mëkatarët fajtorë. Kjo zbulesë e jashtëzakonshme e hirit dhe fuqisë çliruese të Perëndisë është ajo që të frymëzon me guximin, shpresën dhe këmbënguljen e lutjes së vërtetë. ‘...sepse përmes tij që të dy kemi hyrje tek Ati nëpër një Frymë të vetme’ (Efesianët 2:18). Personi që e njeh Krishtin më mirë është personi që lutet më mirë.

Pika për reflektim dhe diskutim

Nëse krijimi nuk mund të zbulojë mëshirën shpëtuese të Perëndisë në Krishtin, a duhet të këndojmë ‘Jezusi është Zot! Zëri i Krijimit e shpall’? Si Perëndia Bir, Krishti krijoi Universin, por a mund të mësojmë vërtet prej yjeve, pemëve dhe luleve që ‘Jezusi është Zot’?

Si profeti ynë, Jezusi na mëson përmes shembullit dhe po ashtu përmes fjalës. Çfarë mund të mësojmë për lutjen nga shembulli i jetës lutëse të vetë Krishtit?

Cilat janë përfitimet e shfaqjes së Birit të Perëndisë në formë njerëzore? Çfarë kuptoni se nuk do të ishte e qartë përmes krijimit?

Kapitulli 10

Lutja dhe Krishti si Prifti ynë

'Duke pasur, pra, o vëllezër, guxim për të hyrë në shenjtërore me anë të gjakut të Jezusit, me anë të një udhe të re dhe të gjallë, që ai përuroi për ne me anë të velit, domethënë të mishit të tij, edhe duke pasur një kryepriфт mbi shtëpinë e Perëndisë, le t`i afrohemi me një zemër të vërtetë, në siguri të plotë besimi' (Hebrenjtë 10:19-22).

Bibla thotë se Zoti Jezu Krisht është prifti i popullit që i beson atij. Ç`do të thotë kjo për lutjet tona? Për t`iu përgjigjur kësaj na duhet të mendojmë se çdo të thotë vërtetë priftërimi i Shpëtimtarit tonë. Ai përfshin dy gjëra. Së pari, Jezusi ofroi trupin dhe shpirtin e tij për ne në altarin e kryqit si një sakrificë të përsosur për të shlyer njëherë e përgjithmonë mëkatet tona. 'Dhe ndërsa çdo prift rri përditë në këmbë duke shërbyer dhe duke blatur shpeshherë të njëjtat flijime, që nuk mund të heqin kurrë mëkatet, ai, përkundrazi, pasi dha përgjithnjë një flijim të vetëm për mëkatet, u ul në të djathtë të Perëndisë' (Hebrenjtë 19:11-12). Së dyti, duke qenë se u ringjall prej së vdekurish, Jezusi tani ndërhyt për ne në qiell për të siguruar kënaqësinë tonë personale të bekimeve që vdekja e tij bleu për ne. '...kurse ai, mbasi mbetet përjetë, ka priftëri të patjetërsueshme, prandaj edhe mund t`i shpëtojë plotësisht ata, që me anë të tij i afrohen Perëndisë, sepse gjithmonë rron që të ndërmjetësojë për ta' (Hebrenjtë 7:24-25). Këto dy aspekte të veprës priftërore të Jezusit kanë një marrëdhënie shumë të ngushtë me të luturin tonë.

Atëherë, vdekja shlyese e Jezusit mbi kryq është ajo që të jep lirinë e mrekullueshme për t`u afruar te Perëndia. Po të vije para Mbretit të universit si një mëkatar i pafalur, e vetmja gjë që mund të prisje prej tij do të ishte dënimi i drejtë. A do të ishte e mundur që të luteshe në këto rrethana? Ideja se Perëndia do të të refuzonte, do ta mbyste zërin e lutjes në dëshpërimin më të skëterrshëm. Por, shpirt i krishterë, ti ke një prift: sakrifica shlyese e Jezusit e largon gjithë fajin tënd. Përmes gjakut të tij të derdhur, ti ke një falje të plotë dhe të lirë përgjithmonë, të të gjitha mëkateve të tua. Perëndia nuk të dënon më. ‘Tani, pra, nuk ka asnjë dënim për ata që janë në Krishtin Jezus’ (Romakët 8:1). Sigurisht që kjo e hap zemrën dhe buzët e tua në lirinë e lutjes. Tani mund të hysh në praninë mahnitëse të Perëndisë jo si kriminel i dënuar, por si një bir i falur, i pajtuar dhe i pranuar!

Kështu, kur ndien sulmet e një ndërgjegjeje fajtoze duke të akuzuar egërsisht për mëkatet e tua dhe shpirti yt i torturuar kërkon paqe me Perëndinë, ti e di që duhet të bësh. Duhet të mbahesh pas besimit në vetë-sakrificën priftërore të Jezusit. Ti vendos vdekjen e Birit të tij ndërmjet mëkatit dhe inatit të shenjtë të Perëndisë. Përmes sakrificës së gjithëmjaftueshme shlyese të priftit të lavdishëm, tani mund të lutesh me besimin plot gëzim se Perëndia të pranon, Perëndia të dëgjon dhe se Perëndia të jep paqe me të. ‘Të shfajësuar, pra, me anë të besimit, kemi paqe me Perëndinë nëpërmjet Jezu Krishtit, Zotit tonë, me anë të të cilit edhe patëm, nëpërmjet besimit, hyrjen në këtë hir në të cilin qëndrojmë të patundur’ (Romakët 5:1-2).

Së dyti, i luturi yt është gjithashtu i lidhur ngushtë me ndërmjetësimin priftëror, të cilin Jezusi po e kryen tani në qiell për njerëzit e tij. Prifti yt, jo vetëm sakrifikoi veten e tij për ty, por gjithashtu u ngrit nga të vdekurit për ty, u ngjiti në qiell për ty, dhe tani në mënyrë aktive po ndërhyr për ty në praninë e Atit të tij. Se si ndërhyr për ty dhe për gjithë besimtarët e tjerë, mund ta kuptosh nga lutja e tij priftërore te Gjoni 17: ‘Unë lutem për ta, nuk lutem për botën, po për ata që më ke dhënë, sepse janë të

tutë... O Atë i shenjtë, i ruaj ata në emrin tënd, ata që më ke dhënë, që të jenë një sikurse ne... Unë nuk kërkoj që ti t'i heqësh nga bota, por që t'i mbrosh nga i ligu... Shenjtëroi në të vërtetën tënde; fjala jote është e vërteta... Tani unë nuk lutem vetëm për ta, por edhe për ata që do të besojnë në mua me anë të fjalës së tyre, që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty; edhe ata të jenë një në ne, që bota të besojë se ti më ke dërguar' (Gjoni 17:9,11,15,17,20-21).

Fakti që prifti yt është edhe Perëndi edhe njeri në një person, e pajis atë në mënyrë të përsosur për këtë vepër të madhe të ndërmjetësisimit për ty. Si Perëndia Bir, Krishti di çdo gjë. Kështu, ai di gjithçka për ty dhe di saktësisht si të lutet për ty. Si njeri, përvojat e vuajtjes, të cilat i kaloi në jetën e tij tokësor, i japin një keqardhje njerëzore të gjallë dhe të thellë lutjeve të tij për ty ndërsa kalon probleme dhe prova të ndryshme. Ndjenjat e tij njerëzore arrijnë te të gjithë ata për të cilët vuajti, duke forcuar dëshirën e tij për t'i sjellë të gjithë në pasuritë e bekimit që ai bleu për ta në këmbim të vetë gjakut të tij.

Kështu, në qiell Zoti Jezu Krisht i lavdëruar, po lutet për ty pikërisht tani. Njësoj si të krishterët e tjerë, ndonjëherë mund të jesh i tërhequr në lutjet e tua sepse ndieni kaq shumë dyshime dhe frikë që ngrihen prej ndjesisë së dobësisë dhe pavlefshmërisë. Si mundet Perëndia, pyet veten, të dëgjojë lutje kaq të dobëta nga një mëkatar i pavlerë? Ajo që duhet të kuptoni është: asnjëherë nuk je vetëm kur lutesh. Asnjëherë nuk vjen te Perëndia vetëm. Ti vjen në bashkim me Zotin Jezu Krisht, priftin qiellor, i cili vetë po lutet për ty. E vetmja mënyrë që mund të lutesh është duke i përzier lutjet e tua me ato të Jezusit dhe Perëndia Atë i dëgjon gjithmonë lutjet e Birit të tij të dashur.

Kjo të jep një bindje të paqtë se Perëndia do ta shohë me favor të luturin tënd të dobët. Lutjet e tua nuk shkojnë tek ai vetë, por të përziera me lutjen e bukur dhe të përsosur të Jezusit, të cilin Perëndia e caktoi si priftin tënd të përsosur. Mund ta themi dhe kështu: Perëndia nuk ka ndërmend ta refuzojë Jezusin për shkak të atyre lutjeve të tua të njollosura me mëkat të cilat Jezusi ia çon. Përkundrazi, Perëndia do të të pranojë ty dhe lutjet e tua të njollosura me mëkat për shkak të Jezusit të dashur e të pamëkat, nëpërmjet të cilit ti lutesh. Kështu, pra, kurrë mos lejo që ndjesia e mëkatit dhe e pavlefshmërisë të të ndalojë të shkosh te Perëndia në lutje. Nuk je vetëm. Ati të ka dhënë një kryepriest të madh dhe të dhembshur në Krishtin. Përsosmëria e pamëkat dhe sakrifica shlyese e Jezusit do të shenjtërojë lutjet e tua, që në mënyrë mëkatore janë të papërsosura, dhe t'i kthejë ato në një temjan shpirtëror të ëmbël dhe aromatik, të pranueshme prej Perëndisë.

Ka dhe një pikë të fundit që dua t'ju tregoj. Nëse e kupton priftërinë qiellore të Jezusit, kjo do të të ndihmojë të kuptosh se çfarë i bën lutjet e tua efektive. Çelësi i lutjes efektive është harmonia që egziston midis dëshirave të tua shpirtërore dhe lutjeve që prifti yt po ofron në qiell. Ato dëshira të shenjta të shpirtit që i shpreh në lutje nuk vijnë nga ty. Ato vijnë nga Fryma e Shenjtë. Dhe Fryma i ka nxjerrë këto dëshira të shenjta nga zemra e Jezusit, priftit tënd, dhe i vendosi ato në zemrën tënde. Duke vepruar kështu, Fryma krijon një unitet misterioz ndërmjet teje dhe ndërmjetësuesit qiellor, ndërsa lutesh. Ti bëhesh një me Jezusin; kërkesa e tij e fuqishme qiellore derdhet në zemrën tënde dhe bëhet lutja jote. Me fjalë të tjera lutja jote mbi tokë është aftësia që të jep Fryma e Shenjtë për të kumbuar lutjen e Jezusit në qiell. Ti po bëhesh pjesë e jetës-lutëse të vetë Jezusit! A nuk të bën kjo të kuptosh se çfarë gjëje e lavdishme, e bukur dhe e shenjtë është lutja?

Pika për reflektim ose diskutim

Si të ndihmon doktrina e priftërisë së Jezusit për t`u lutur?

Shih ‘lutjen kryepriftërore’ të Jezusit te Gjoni 17. Për çfarë po lutet Jezusi në qiell për njerëzit e tij? Si mund të bashkëpunojmë?

Mendoni se si dy natyrat e Jezusit, njerëzorja dhe hyjnorja, e bëjnë atë një prift të përsosur.

Kapitulli 11

Lutja dhe Krishti si Mbreti ynë

'Atij që rri ulur mbi fron dhe Qengjit i qofshin bekimi, nderi, lavdia dhe forca në shekuj të shekujve!'
(Zbulesa 5:13).

Zoti Jezu Krisht, përveçse është profeti dhe prifti ynë, është gjithashtu mbreti i popullit të tij, pasardhësi i Davidit që mbretëron në një mbretëri të përjetshme. 'Ai do të jetë i madh dhe do të quhet Biri i Shumë të Lartit; dhe Zoti Perëndi do t'i japë fronin e Davidit, atit të tij; dhe do të mbretërojë mbi shtëpinë e Jakobit përjetë, dhe mbretëria e tij nuk do të ketë kurrë të sosur' (Luka 1:32-33). Si mbret, Krishti i jep popullit të tij bekimet që i bleu për ne nëpërmjet veprës së tij çliruese në tokë. Shenjtërimi yt në veçanti është manifestimi i mbretërimit të Krishtit. Mbreti yt përçon te ty jetën e tij të ringritur e të lavdishme, i mund mëkatet e tua, të bën të shenjtë, të mbron të mos biesh përsëri në pushtetin e Satanit dhe në fund të bën të përsosur në ringjallje për jetën e përjetshme në qiell. Të gjithë këtë e bën përmes Frymës së Shenjtë. "Ai, pra, duke qenë i ngritur në të djathtë të Perëndisë dhe duke marrë nga Ati premtimin e Frymës së Shenjtë, ka përhapur atë që ju tani shihni dhe dëgjoni. Sepse Davidi nuk është ngritur në qiell, madje ai vetë thotë: 'Zoti i ka thënë Zotit tim: Ulu në të djathtën time, derisa unë t'i vë armiqtë e tu si stol të këmbëve të tua' (Veprat e Apostujve 2:33-35). Fryma e Shenjtë është Fryma e mbretit Mesia.

Kur lutesh, je në kontakt me Krishtin mbret. Duhet të mbash në mendje të vërtetën e mrekullueshme

se e tërë jeta jote shpirtërore është në duar mbretërore. Ndërsa përpiqesh me mëkatin e tundimin, dhe lutesh për hir, nguli sytë te sovranit i ngritur dhe i lartësuar. Ai ka pushtet mbretëror për t'iu përgjigjur atyre lutjeve dhe të të forcojë me hir të fuqishëm. Kujto që ky mbret është vëllai yt. Nuk do të gesh një të huaj apo jashtëtokësor të ulur në fronin e universit, por një qenie njerëzore si ne, një prej nesh, një çlirues që është i afërmi ynë. Mbretit tonë qiellor mund 't'i vijë keq për dobësitë tona', sepse ai vetë 'u tundua në të gjitha, ashtu si ne, por pa mëkatuar' (Hebrenjtë 4:15). Përfundimi praktik për lutjen tonë, të cilin autori i Hebrenjve e nxjerr prej njerëzores së sovranit tonë të ngritur, është: 'Le t'i afrohem, pra, me guxim fronit të hirit, që të marrim mëshirë e të gjejmë hir, për të pasur ndihmë në kohë nevojë' (Hebrenjtë 4:16). Mund të vish te ky mbret i lavdishëm me besim të ngrohtë, sepse ai është vëllai yt njerëzor, të cilit i vjen keq për ty.

Krishti mbret nuk është thjesht në kontroll të jetës tënde shpirtërore. Ai është Zoti sovran i të gjitha rrethanave të tua. Është e rëndësishme për një jetë lutjeje të shëndetshme të kapësh këtë të vërtetë. Së bashku me gjithë fëmijët e Perëndisë, shpesh, do t'i gesh përvojat e tua në jetë të errëta dhe stresuese. Apostulli Pal flet për 'pikëllimin, ngushticën, përndjekjen, urinë, të zhveshurit, rrezikun dhe shpatën' si ato lloj gjërash që mund të kapen pas teje dhe që përpiqen të shkatërrojnë besimin tënd (Romakët 8:35). Nëse i sheh këto gjëra sikur po bien mbi ty prej vullnetit të një Perëndie të ftohtë, të largët dhe që nuk i vjen keq, ato do të të copëtojnë dhe do ta mbysin zërin e lutjes.

Por sa ndryshe do të duket çdo gjë nëse sytë e tu do të përqendrohen te Jezusi, mbreti-prift, dhe ta shohësh atë të ulur në bukuri në fronin e universit! Ai që vdiq për ty po i cakton rrethanat e tua nëpërmjet të njëjtës dashuri të shfaqur në kryq. Mund t'i besosh atij? Nëse e ke vendosur besimin tek ai për fatin tënd përfundimtar në jetën që do të vij, gjithashtu mund t'i besosh Zotit tënd të dashur në të gjitha çështjet e jetës së tashme. Nëpërmjet pushtetit të tij mbretëror, ai mund të sigurohet që 'të gjitha gjërat bashkëveprojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë, për ata që janë të thirrur sipas qëllimit të tij' (Romakët 8:28).

Kështu asgjë nuk mund t`ju ndajë nga dashuria e tij. Ai dha gjakun e jetës së tij për të të çliruar dhe nuk do të lejojë asnjë kombinim rrethanash të të shkatërrojë. Ai është mbreti. Ai është në kontroll. Ai është gati të derdh hir mbretëror për të të ndihmuar në çdo përvojë të ashpër. Besoje këtë dhe do të jesh në gjendje të bësh lutje prej besimi të pamposhtur në mes të zjarrit që djeg dhe ujit që të fundos.

Pika për reflektim ose diskutim

Çdo të thotë mbretërimi i Krishtit për sjelljen tënde ndaj jetës së përditshme dhe përpjekjeve shpirtërore?

‘Le të hyjmë me guxim te froni i hirit’ (Hebrenjtë 4:15). Çfarë na jep guxim për të hyrë?

Krahaso mbretërimin dhe priftërimin e Krishtit. Çfarë të përbashkëta dhe të veçanta mund të dalloni? Si të inkurajojnë secila të lutesh?

Kapitulli 12

Lutja dhe Fryma e Shenjtë

'Duke u lutur në çdo kohë dhe me çdo lloj lutjeje dhe përgjërimi në Frymën' (Efesianët 6:18).

Titulli zyrtar që Shkrimi i jep Frymës së Shenjtë në veprën e shpëtimit është 'Ngushëlluesi' (Gjoni 14:16,26; 15:26; 16:7). Ky term rrjedh nga fjala greke **paracletos**. Shkrimi, në mënyrë interesante, ia jep gjithashtu këtë titull dhe Zotit Jezu Krisht te 1 Gjonit 2:1: 'Në qoftë se ndokush mëkaton, kemi një avokat te Ati, Jezu Krishtin, të drejtin'. Fjala 'avokat' është e njëjtë me fjalën greke **paracletos**. Krishti foli në të njëjtën kohë si për vete dhe për Frymën e Shenjtë si ngushëllues te Gjoni 14:16. Pra, çdo të thotë kjo fjalë?

Një ngushëllues (ndihmës) është dikush që vjen dhe qëndron me ty për të të ndihmuar kur je në telashe. Për shembull, po të gjendeshe në vështirësi ligjore, do të merrje një avokat dhe ai do ta mbronte çështjen tënde në gjyq. Avokati do të ishte ngushëlluesi yt. Ose, po të ishe i sëmurë rëndë, do të shkoje te doktori për të zbuluar se nga se vuaje dhe të të shëronte. Doktori do të ishte ngushëlluesi yt. Në shpëtimin e përjetshëm ke dy ngushëllues: Zotin Jezu Krisht dhe Frymën e Shenjtë. Krishti është si

një avokat që merret me drejtësinë hyjnore për ty, duke e mbrojtur çështjen tënde dhe duke të siguruar pafajësinë. Fryma është si doktor, që punon brenda shpirtit të sëmurë duke i hapur sytë ndërgjegjes tënde ndaj realitetit të mëkatit, që zbulon Krishtin dhe të bën ta pranosh si Shpëtimtarin e vetëm. Mund të thuash se Krishti është ngushëlluesi yt në qiell dhe Fryma e Shenjtë është ngushëlluesi yt në tokë. Në gjithë këtë, Fryma nuk ecën i pavarur nga Krishti, por mban anën e Krishtit. Krishti mbret, është ai që dërgon Frymën e Shenjtë për të të përçar në shpirt bekimet shpirtërore të siguruara në kryq. Kështu që puna e Frymës dhe e Birit si ngushëllues është një bashkëpunim.

Ka një lidhje tjetër të rëndësishme ndërmjet punës së Krishtit dhe asaj të Frymës si dy ngushëlluesit e tu. Ashtu siç e pamë te Lutja dhe Krishti prifti ynë, Fryma e Shenjtë është ai që të lidh në shërbesën ndërmjetësuese që Zoti Jezu Krisht po bën në qiell për gjithë njerëzit e tij. Fryma merr dëshirat e zemrës së Jezusit dhe i thur ato në zemrën tënde, në mënyrë që të bëhen dhe dëshirat e tua. Kjo ndjenjë simpatie dhe harmonie e gjallë zemre mes teje që lutesh në tokë dhe Jezusit që ndërmjetëson në qiell, është ajo që i jep lutjeve të tua efektivitet shpirtëror.

Ka dhe një mënyrë tjetër me anë të së cilës Fryma vetë ndërhyt për ne. Dëgjo se ç`thotë Pali te Romakët 8:26: 'Kështu, pra, edhe Fryma na ndihmon në dobësitë tona, sepse ne nuk dimë çfarë të kërkojmë në lutjet tona, sikurse duhet; por vetë Fryma ndërhyt për ne me psherëtimat e patregueshme'. Nëse Fryma e Shenjtë 'ndërhyt për ne,' a do të thotë se kemi dy ndërmjetësues – Krishtin në qiell dhe Frymën në zemrën tënde? Po, por janë gjithmonë në një mendje me njëri-tjetrin në mënyrë të përsosur. Fryma e Shenjtë lutet brenda teje, e pandarë nga Krishti, por duke kumbuar lutjen e Krishtit në qiell. Ashtu siç tha Zoti Jezu Krisht për Frymën, ai merr nga gjërat e Krishtit dhe ia kumton ato ndjekësve të tij (Gjoni 16:14). Kështu, mund të themi se Fryma e Shenjtë merr nga lutja qiellore e Krishtit dhe e

kumton brenda teje, duke të frymëzuar të lutesh me të njëjta dëshira hyjnore si ndërmjetësuesi yt hyjnor.

Kjo ndihmë e Frymës së Shenjtë në lutje është e domosdoshme. Po të ta linte veten në duart e tua, shpejt do të rrëzoheshe nën peshën dërrmuese të barrës tënde. Por, atje ku do të merreshin këmbët në dobësinë tënde njerëzore, atje gjendet Fryma; ai i përziën energjitë e tij hyjnore me të tuat; ai të ngre, të bashkon me Krishtin, dhe riprodhon në zemrën tënde lutjen e një ngushëlluesi qiellor. A ndihet fryma jote e rëndë dhe e plogët në lutje? A është barra jote tepër e rëndë, sa mbetesh pa fjalë dhe të merren këmbët? Kërkoji Frymës së Shenjtë të të ndihmojë.

Eja, Frymë e Shenjtë, zemrat na i ço
Dhe na ngroh me zjarr të pashuar.

Ka një arsye pse Bibla e quan Frymën e Shenjtë ‘Ngushëlluesi’.

Te Romakët 8:27, apostulli Pal vazhdon të thotë: ‘Dhe ai që heton zemrat e di cila është mendja e Frymës, sepse ai ndërhyr për shenjtorët, sipas Perëndisë’. Ka dy gjëra të rëndësishme që duhet t’i vini re në mësimin e Palit. Së pari, ndërsa Perëndia kërkon zemër lutëse, ai dallon në shfaqjen e dëshirave të tua, ndërmjetësimin e Frymës së tij të Shenjtë. Kur lutesh vërtet, zemra jote është si një pasqyrë shpirtërore, në të cilën Perëndia mund të shohë veten!

Së dyti, ky ndërmjetësim i Frymës e kthen të luturin tënd në një derë të hapur për bekimet e Perëndisë. Ja, pse Fryma kërkon vetëm gjërat që janë ‘sipas Perëndisë’. Fryma e Shenjtë është po aq ‘Perëndi’, sa edhe Ati dhe Biri, kështu që, ka të njëjtën njohuri; ai di gjithçka që fshihet në qëllimet hyjnore. Kjo do të thotë se ai mund të vendosë në zemrën tënde një dëshirë për ato gjëra që Perëndia ka vendosur të të japë. Kështu, Fryma e Shenjtë, ngushëlluesi yt në tokë, krijon një njësi midis sovranitetit të Perëndisë

dhe lutjeve të tua. ‘Fryma ndërhyt për shenjtorët, sipas Perëndisë’. ‘Kjo është siguria që kemi përpara tij: nëse kërkojmë diçka sipas vullnetit të tij, ai na e plotëson’ (Romakët 8:27; 1 Gjonit 5:14).

Pika për reflektim ose diskutim

A mbështetesh te Fryma e Shenjtë për të të ndihmuar që të lutesh? Si mund ta bësh këtë?

Si mund t`i dallojmë lutjet e frymëzuara nga Fryma e Shenjtë prej lutjeve joshpirtërore?

Diskutoni Romakët 8:26-27, duke u nisur nga ajo që thuhet për të në këtë kapitull.

Kur mendoni se do të ishte e përshtatshme t`i luteni Frymës së Shenjtë?

Kapitulli 13

Ç`mund të themi për lutjet e papërgjigjura?

'Ju luteni dhe nuk merrni' (Jakobi 4:3).

Në këta kapitujt e fundit do të shohim disa nga problemet e lutjes, të cilat ende nuk i kemi trajtuar. I pari që dua të shqyrtojmë është një nga më të mëdhenjtë dhe nga më të vështirët: problemi i lutjes së papërgjigjur.

Lutja e papërgjigjur shkakton dhimbje. Të bën të dyshosh nëse ka ndonjë kuptim të lutesh. Do të jesh veçanërisht i prirur të ndihesh kështu, nëse po kalon kohë trishtimi dhe zhgënjimi shkatërrues. U lute, prite që Perëndia të të ndihmonte, por ai dështoi. Kështu që, pse të marr mundimin e të vazhdoj të lutem akoma?

Nëse ndihesh kështu, dua të të sugjeroj se ndoshta mund të gjesh një përgjigje për pyetjen tënde dëshpëruese në një nga këto tre mënyra.

Ndoshta ke qenë duke u lutur për diçka të gabuar.

Po të mendohesh, ka dy lloj gjërash për të cilat mund të lutesh. E para, mund të lutesh për gjëra që Perëndia qartësisht dhe në mënyrë pozitive të ka urdhëruar në Shkrim të lutesh: për shembull, bukën e përditshme dhe rritjen tënde shpirtërore. Për sa u përket këtyre çështjeve, premtimi i Perëndisë është: 'Lypni dhe do t`ju jepet; kërkoni dhe do të gjeni; trokitni dhe do t`ju çelet' (Mateu 7:7).

Ndonjëherë, është e vërtetë se Perëndia mund ta vonojë përgjigjen e tij edhe për këto kërkesa. Ose, ai mund t'ju përgjigjet atyre në një mënyrë të çuditshme dhe të papritur, saqë ti heziton të mendosh se kjo mund të jetë në të vërtetë përgjigja e Perëndisë për lutjen tënde. Por përsëri, detyra jote si i krishterë është thjesht të besosh, të lutesh dhe të presësh derisa Perëndia të përgjigjet. Ai, patjetër që do të përgjigjet në kohën dhe mënyrën e caktuar prej diturisë së tij të pafund.

Megjithatë, ka raste të tjera kur nuk mund të jesh i sigurt se cili është vullneti i Perëndisë – atje ku Perëndia nuk e ka treguar saktësisht në Shkrim se për çfarë dëshiron që ti të lutesh. Në këto raste duhet të ofrosh kërkesat-lutje me nënshtrim të plotë ndaj sovranitetit të Perëndisë. Nëse mund të shprehësh kështu, duhet të lejosh Zotin tënd të japë ose jo, në veprim lirie dhe gjykimi.

Dështimi për t'ju nënshtruar sovranitetit të Perëndisë në këto fusha, do të të çojë në gjithfarë problemesh. Ndoshta ti mendon se e di atë që Perëndia duhet të bëjë dhe se si duhet t'ju përgjigjet lutjes tënde. Mund të ngresh lloj-lloj argumentash në mendje se pse Perëndia duhet të bëjë këtë apo atë. Ndoshta, pastaj vini në lutje te Perëndia dhe i kërkoni atij me guxim dhe siguri të bëjë gjërat për të cilat je i bindur se janë të drejta. Por, nëse Perëndia nuk e ka zbuluar në Fjalën e tij se ai dëshiron që të lutesh për atë gjë të veçantë, guximi dhe siguria jote janë thjesht pandehma. Nuk ia ke nënshtruar veten sovranitetit dhe diturisë së lartë të Perëndisë. Ke dështuar të kuptosh sa e gabueshme është mendja jote dhe se sa lehtësisht mund ta drejtojnë në rrugë të shtrembër mendimin, pasionet dhe paragjykimet e tua. Nëse Perëndia refuzon ta plotësojë lutjen tënde, si mund ta akuzosh se të ka lënë në baltë? Ajo gjë për të cilën je lutur, fare mirë mund të ketë qenë e gabuar. Nënshtrimi absolut ndaj sovranitetit mbretëror të Perëndisë është i rëndësishëm për lutjet e tua, nëse po lutesh për gjëra ku vullneti i tij nuk është i sigurt.

Mund të jesh lutur për atë që duhet, por në frymë të gabuar.

Fryma me të cilën lutesh është shumë më e rëndësishme se gjërat për të cilat lutesh. Në fakt do të

vazhdoj më tej: fryma e lutjes **është** lutja! Nëse nuk lutesh në frymën e duhur, nuk po lutesh fare; thjesht sa po vë në gojë fjalë të kota. Duhet të vish te Perëndia në frymë të drejtë: një frymë adhurimi të shenjtë, varësi të përulur dhe rrëfim të ndershëm të mëkatit.

Për fat të keq, të krishterët jo gjithmonë i afrohen Perëndisë për t'iu lutur në këtë frymë. Ndonjëherë vijmë duke menduar vetëm për lumturinë tonë, jo për lavdinë e Zotit tonë. Vijmë pa ndonjë ndjesi për mëkatin tonë të madh ose për nevojën e pashmangshme që kemi për Krishtin. Ne vijmë të fryrë me arrogancë, duke i diktuar Mbretit të universit dhe duke i mohuar atij çdo të drejtë për të zgjedhur kohën dhe metodën e vet për të na u përgjigjur. Nëse vijmë kështu te Perëndia, zemrat tona në të vërtetë nuk po luten fare, edhe pse buzët tona mund të jenë duke kërkuar atë që duhet. Nuk është çudi pse Perëndia nuk na përgjigjet. Për sa i përket atij, ai ende po pret që ne të lutemi.

Mund të kesh keqkuptuar përgjigjen e Perëndisë ndaj lutjes tënde.

Ky është gabimi më i zakonshëm që mund të bëjmë. Edhe pse lutemi për atë që duhet dhe në frymën e duhur, nuk duket se Perëndia po na përgjigjet. Mund ta kemi keqkuptuar përgjigjen e tij.

Gjithmonë duhet të mbash mend se kjo jetë është një lloj shkolle shpirtërore, në të cilën Perëndia po të stërvit dhe po të përgatit për në qiell. Bekimi më i lartë i mundëshëm që Perëndia mund të të japë mbi tokë është shenjtërimi. Ja, pse ndonjëherë Perëndia vonohet të të kthejë përgjigje – sepse ai dëshiron ta pasurojë shpirtin tënd me bukurinë e brendshme të durimit, përulësisë dhe shpresës. Edhe atëherë kur të ka premtuar se do të të përgjigjet, ai përsëri mund të bëjë të presësh, në mënyrë që të të kujtojë për varësinë tënde në vullnetin e tij sovran. Kur më në fund e plotëson kërkesën tënde, përgjigja ndonjëherë vjen në një mënyrë kaq të befasishme, saqë ti mëson shumë për diturinë dhe fuqinë e mahnitshme të Zotit tënd.

Mund të ketë raste kur Perëndia refuzon të plotësojë menjëherë lutjet e tua, sepse një ‘po’ e shpejtë mund të mos përshtatet me planet e tij të mira. Po ju jap një shembull për këtë nga përvoja ime. Kam

njohur një grua të krishterë, e cila kishte kaluar një kohë të gjatë larg shtëpisë dhe mezi po priste të kthehej në familjen e saj. Kështu, ajo u lut që Perëndia ta çonte shëndoshë e mirë në shtëpi dhe bëri plane të nisëj me anije. Por të gjitha vendet në anije ishin zënë me kohë. Shoqja ime, të cilën e kishte marrë malli për shtëpinë, derdhi lotë të hidhur kur kuptoi se do t'i duhej të qëndronte në atë vend të largët për dy javë të tjera, përpara se të nisëj me anije tjetër. Imagjinoni se si u ndje ajo kur mësoi pak ditë më pas se anija me të cilën kishte vendosur të ikte, ishte mbytur dhe të gjithë kishin vdekur. Perëndia me të vërtetë iu përgjigj lutjes së mikes sime, edhe pse dukej se po ia mohonte; ai tha 'Jo' në mënyrë që të thoshte 'Po'. Për ta çuar të sigurt në shtëpi, Perëndia, në fillim duhej ta ndante nga ata, fati i të cilëve ishte të vdisnin në atë anije. Ja, pse kjo grua e krishterë nuk mori një përgjigje të shpejtë për lutjen e saj.

Gjithashtu, duhet të mbash mend se ti nuk je i vetmi që Perëndia ka parasysh kur ai u përgjigjet lutjeve të tua. Plotësimi i kërkesës tënde mund të ketë një marrëdhënie të ndërlikuar me rrethanat e njerëzve të tjerë. Ndoshta duhet të ndodhin gjëra në jetët e njerëzve të tjerë, nëse duhet të marrësh një përgjigje të vërtetë për kërkesën tënde. Ndoshta Perëndisë do t'i duhet të merret me të tjerët, para se të merret me ty.

Ndonjëherë, Perëndia ndoshta mund t'u përgjigjet lutjeve duke të dhënë diçka më të mirë se ajo për të cilën je lutur. Në këtë rast lutja të vjen e fshehur. Ti po e kërkon bekimin në një formë, dhe ai vjen në një tjetër. Ndoshta në atë kohë ka të ngjarë të mos e kuptosh se kjo është përgjigja. Kur e kupton, zemra të mbushet me mirënjohje. Dashuria e Perëndisë ka bërë më shumë nga ç'ke kërkuar, duke të dhënë një bekim më të madh dhe më të pasur nga ai që dëshiroje në fillim. 'Tani, atij që, sipas fuqisë që vepron në ne, mund të bëjë jashtë mase më tepër nga sa kërkojmë ose mendojmë, atij i qoftë lavdia në kishën në Krishtin Jezus për të gjitha brezat, në jetë të jetëve. Amen.' (Efesianët 3:20-21).

Pika për reflektim ose diskutim

Si mund të dështojmë t`i nënshtrohemi sovranitetit dhe diturisë së lartë të Perëndisë në lutjen tonë si individë dhe si kishë?

Si mund ta dallojmë guximin nga pandehma në lutje?

Lexo shëmbëlltyrën e mysafirit që vjen në mes të natës (Luka 11:5-8). Çfarë na mëson për vonesat e Perëndisë për t`iu përgjigjur lutjes?

Sillni shembuj nga jeta juaj ose e të tjerëve të një përgjigjeje që ka ardhur pas një kohe të gjatë, dhe që Perëndia e plotësoi në një mënyrë të habitshme?

Kapitulli 14

A mund të më kthejë gjithë ky i lutur në një fetar fanatik?

'Unë nuk jam tërbuar, shumë i shkëlqyeri Fest' (Veprat 26:24).

Disa të krishterë kanë frikë se mos besimi i tyre kalon në besim fanatik. Nuk është e habitshme kur sheh njerëz që janë fetarë fanatikë; ata i japin një nam të keq krishtërimit. Megjithatë, nuk ke pse të frikësohesh që një praktikë e vërtetë lutjeje do të të kthejë në një fanatik. Perëndia ka vendosur kufizime të caktuara mirë rreth lutjes së vërtetë, që e pengojnë nga të degjeneruarit në një fanatizëm fetar të neveritshëm.

Vullneti i Perëndisë i zbuluar në Shkrim rregullon lutjen e vërtetë. Kur lutet një fanatik fetar, ai e lë mënjanë vullnetin e Perëndisë të zbuluar në Bibël. Ai pretendon se merr zbulesa të veçanta personale prej Perëndisë. Pastaj, ai kërkon që edhe njerëzit e tjerë t'i pranojnë këto zbulesa dhe t'u nënshtrohen atyre; në këtë mënyrë, ai e vendos veten si një autoritet fetar mbi të tjerët. Ai nuk do të lejojë që ta kritikojnë ose të hetojnë zbulesat e deklaruara prej tij për të provuar vërtetësinë e tyre. Megjithatë, kjo sjellje bie ndesh me autoritetin përfundimtar dhe të gjithëmjaftueshëm të Shkrimit. Të krishterët e kanë për detyrë të provojnë të gjitha doktrinat, opinionet dhe përvojat nëpërmjet standartit të Fjalës së shkruar të Perëndisë. 'Përmbajuni ligjit dhe dëshmisë! Në rast se një popull nuk flet në këtë mënyrë, kjo do të thotë se ai nuk ka dritë' (Isaia 8:20). Fanatiku fetar e vendos veten mbi Biblën kur

kërkon nënshtrim ndaj pretendimeve të tij dhe nuk do që ndonjë t'i provojë ato. Por Bibla thotë: 'Provoni të gjitha' (1 Thesalonikasve 5:21).

Kjo është pengesa e parë që do ta ndalojë besimin tënd të shpërbëhet në ëndrrat dhe përçartjet e një fanatiku fetar. Kur bashkohesh me Perëndinë në lutje, duhet t'i nënshtrohesh autoritetit të vetëm të Fjalës së tij të shkruar. Lejo që Bibla të kontrollojë mendimet dhe ndjenjat e tua ndërsa lutesh.

Duhet të praktikosh vetëkontroll në lutje.

Njohuria e Perëndisë dhe njohuria jote janë miq të pandarë. Nuk mund t'i ndash nga njëri-tjetri. Bibla e përshkruan Perëndinë si një që heton zemrën dhe mendjen: 'Unë, Zoti, hetoj zemrën, vë në provë mendjen për t'i dhënë secilit sipas rrugëve të tij, sipas frytit të veprimeve të tij' (Jeremia 17:10). **Ti** duhet të shqetësohesh për atë që ndodh në zemrën dhe në mendjen tënde. Me ndihmën e Perëndisë duhet të praktikosh një kontroll të kujdesshëm.

Kjo është shumë e rëndësishme në jetën tënde lutëse, nëse dëshiron të jetë e lirë nga fanatizmi fetar. Fanatiku nuk e njeh me të vërtetë veten e vet. Ai ka një ide të gënjeshtërt mëkatore se kush është ai dhe cilat janë motivet e tij. Ai e ka bindur veten se po i shërben Perëndisë, ndërsa në të vërtetë po i shërben vetes së tij dhe lavdisë së tij personale. Lutjet e tij janë si të Fariseut të Luka 18:9-14; ai i lutet vetes për veten, dhe se sa shpirtëror dhe i afërt është me Perëndinë.

Nëse dëshiron ta shmangësh këtë kancer të shpirtit, të duhet të praktikosh një kontroll në lutjet e tua. Para se të flasësh me Perëndinë, duhet të ndalesh dhe të gjykosh veten. Duhet të hetosh mendimet më sekrete dhe të provosh zemrën me vetëhetimin më të ndershëm. Do të gjesh shumë gjëra që do të të mërzhisin, por është e vetmja mënyrë se si mund ta përgatitësh veten për adhurim të frytshëm me Perëndinë. Praktikoje këtë lloj vetëkontrolli, dhe lutjet e tua nuk do të përfundojnë në një fanatizëm fetar që lavdëron vetveten. Në vend të saj, do të shohësh se do të bëhesh një njeri i kujdesshëm, i përvuilur dhe i thjeshtë.

Lutja e vërtetë e pengon fanatizmin, sepse ajo njihet si Ndërmjetës.

Kur vjen para Perëndisë në adhurim të vërtetë, duhet të largosh krenarinë dhe rëndësinë që i jep vetes. Ti nuk je aq i mirë sa të hysh në praninë e shenjtë të Perëndisë me përsosmërinë tënde. I mbuluar nga pislleku i mëkateve të tua, mund të ulesh në pluhur dhe të kërkosh përsosmërinë e një tjetri – Zotit Jezu Krisht. Vetëm Ndërmjetësi yt i drejtë dhe i dashur, të bën ty dhe lutjet e tua të pranueshme para Perëndisë.

Kjo bie ndesh me frymën e fanatizmit fetar. Fanatiku mendon se ai është i preferuari i Perëndisë dhe pretendon një vend të veçantë për vete para Perëndisë. Kjo e mbush atë me një krenari të madhe, me një ndjesi superioriteti shpirtëror. Ai ndien përbuzje për vdekatarët që nuk e kanë këtë pozicion të lartë. Por lutja e vërtetë është e kundërta e gjithë kësaj. Ajo të përul me një ndjenjë të thellë të pavlefshmërisë tënde. Të bën të mendosh jo për pozicionin tënd të veçantë, por për varësinë e plotë të pozicioni i veçantë i Zotit Jezu Krisht. Krishti është Ndërmjetësi i vetëm për gjithë mëkatarët e pavlerë. Duke iu lutur Atit përmes tij, e gjen veten në të njëjtin nivel me të tjerët. Nuk je ndonjë i veçantë. Ti je një mëkatar në një kompani të panumërt mëkatarësh, që mbështeten të gjithë njësoj në përsosmërinë e Birit të dashur të Perëndisë. Nuk ka vend për një fanatizëm fetar vetë-lartësues.

Nga e gjithë kjo mund të kuptosh se larg nxitjes së një fryme fanatizmi fetar, lutja është ilaçi më i mirë kundër tij.

Pika për reflektim ose diskutim

A është e drejtë t`i kunsiderosh ndjenjat dhe përshtypjet që merr ndërsa lutesh, si zbulime të veçanta personale? Si mund t`i provosh ato? A duhet t`u kërkosh të tjerëve t`u nënshtrohen atyre?

Cila është mënyra më e mirë për të praktikuar vetëkontroll para se të lutesh?

Në ç`mënyra mund të futen në lutjet tona krenaria dhe ndjenja e superioritetit shpirtëror?

Kapitulli 15

A përputhet lutja me ndonjë pikëpamje shkencore?

'ZOTI bën ç`të dojë në qiell dhe në tokë, në dete dhe në të gjitha humnerat. Ai i larton avujt nga skajet e tokës, prodhon vetëtimat për shiun, e nxjerr erën nga depozitat e tij' (Psalmi 135:6-7).

Disa njerëz kanë probleme me këtë, të cilat mund t'i shprehin si më poshtë: 'Universi është si një makineri e madhe dhe komplekse. Çdo ngjarje që ndodh në të vepron sipas ligjeve të caktuara të ndërtuara prej Krijuesit të tij. Lutja, sidoqoftë, do të thotë se Perëndia po ndërhyr vazhdimisht te këto ligje, duke bërë të ndodhin gjëra në përgjigje të kërkesave tona personale. Kjo do ta përmbyste të gjithë natyrën e universit si një sistem i ligjit dhe rregullit shkencor.

Njerëzit që kanë këtë pikëpamje po nxjerrin probleme jo thjesht për lutje, por për kuptimin tonë të plotë për Perëndinë. Në fakt, ata po e kufizojnë lirinë e sovranitetit të Perëndisë duke e mbyllur si të burgosur të 'ligjeve të vendosura' të universit. Ata mund të pranojnë se Perëndia krijoi gjithçka në fillim, por pastaj u largua nga punët e detajuara të përditshme të botës së tij, e cila (sipas tyre) vepron vetë, nëpërmjet ligjeve të shkakut dhe efektit. Universi është një 'sistem i mbyllur', ku Perëndia nuk mund të ndërhyjë. Perëndia bëhet spektator i largët, duke parë ngeshëm makinerinë e universit që lëviz sipas akrepave të orës.

Ne duhet ta hedhim poshtë idenë se universi ka 'ligje të caktuara', të cilat Perëndia nuk mund t'i ndryshojë. Ato që mund t'i quajmë 'ligjet e natyrës', janë në të vërtetë mënyra se si Perëndia kontrollon personalisht universin e tij. Për shembull, ligji i rëndesës është thjesht mënyra jonë e të përshkruarit se çfarë bën Perëndia normalisht, kur ne lëshojmë një objekt. Perëndia dëshiron që objekti të bjerë. Ose, kjo është ajo që ai dëshiron normalisht. Por ai është i lirë të dëshirojë të kundërtën. Perëndia nuk është skllav i mënyrës se si i bën gjërat zakonisht.

Kështu që, është e gabuar të flasësh për 'ligje të caktuara' të natyrës dhe të Perëndisë që 'ndërhyn' tek to. Ne duhet ta shohim të gjithë universin fizik si një manifestim të vazhdueshëm të vullnetit dhe fuqisë së Perëndisë, ashtu si bëri psalmisti kur shkroi fjalët e cituara në fillim të kapitullit. Kur diçka e quajmë 'ligj', ajo që kuptojmë në të vërtetë është mënyra se si Perëndia i bën zakonisht gjërat. Të ashtuquajturat ligje të natyrës, janë thjesht zakone të Perëndisë. Nëse zgjedh të veprojë ndryshe nga herë të tjera – për shembull, kur i përgjigjet një kërkese-lutjeje – ai nuk thyen ndonjë ligj. Ai vetëm sa po i jep variacion rutinës së vet.

Gjithashtu, duhet të kuptojmë se Perëndia mund t'i përgjigjet lutjeve tona përmes mënyrës se si e kontrollon universin. Mendoje kështu: bota ka sa dimension fizik aq edhe shpirtëror. Njerëzit janë qeniet më të larta në këtë botë dhe ne jemi qenie shpirtërore; kemi shpirt dhe lutja është aktiviteti më i lartë i shpirtit. Kur Perëndia e krijoi në fillim botën, ai e krijoi atë me këtë fakt në mendje. Ai e ndërtoi botën në mënyrë të tillë, sa gjithë strukturat dhe ngjarjet e saj organizohen fshehtësisht rreth dimensionit të saj shpirtëror. Me fjalë të tjera, është pjesë e kontrollit normal të Perëndisë për botën që qeveris në interes të shpirtit njerëzor dhe aktivitetit të lutjes. Ky është 'ligji' më kryesor në botën tonë. Nga kjo rrjedh se Perëndia mund t'i përgjigjet lutjeve tona përmes mënyrës normale me të cilën vepron universi. Ndoshta nuk mund ta kuptojmë se si, por në mënyrë misterioze bota fizike dhe ngjarjet e saj kanë qenë qysh prej fillimit të harmonizuara në realitetet shpirtërore. Kështu që Perëndia nuk ka

nevojë të dalë vazhdimisht nga mënyra normale se si e kontrollon botën në mënyrë që t`iu përgjigjet lutjeve tona. 'Kontrolli i tij' normal mbi gjërat, ka përfshirë gjithmonë një varësi të fizikes ndaj frymërores, të materies ndaj shpirtit, të ngjarjeve ndaj lutjes.

Pika për reflektim dhe diskutim

Si ndikon në pikëpamjen që kemi për botën fizike njohuria e duhur e sovranitetit të Perëndisë? Shihni pasazhe të tjera në Bibël që flasin për këtë.

A mund të përcaktojmë një mrekulli ndërsa Perëndia i largohet mënyrës normale të të bërit të gjërave? Nëse po, a duhet të presim mrekulli si përgjigje të lutjeve tona? A keni përjetuar ndonjëherë, ndonjë mrekulli si përgjigje ndaj lutjes?

Në pikëpamje të kësaj marrëdhënie të ngushtë ndërmjet fizikes dhe frymërores, sa e rëndësishme është se ç`bëjmë me trupat tanë në lutje?

Kapitulli 16

A duhet të luten njerëzit e pakthyer në besim?

'E mburrshin qiejt dhe toka' (Psalmi 69:34).

Disa të krishterë mund të hasin në vështirësi këtu, sepse ata e kuptojnë shumë mirë se lutja e vërtetë del nga një gjendje shpirtërore e mendjes. Vetëm ata, mendja e të cilëve është te gjërat shpirtërore mund të luten dhe të pranohen prej Perëndisë. Pra, a nuk do të thotë kjo se një person jo besimtar të cilit i mungon ky përqendrim i mendjes në gjërat shpirtërore, vetëm sa do ta ofendojë Perëndinë nëse lutet? A nuk do të ishte më mirë për atë të mos lutet derisa të kthehet në besim?

Duket bindëse, por ka një problem. Ky argument me të vërtetë do të thotë se mungesa e një **dëshire** të vërtetë shpirtërore për t'u lutur, na çliron nga **detyrimi** për ta bërë atë. Gjendja jonë prej mëkatari bëhet arsyeja jonë për të mos bërë atë që duhet bërë. Asnjë nuk mund ta pranojë një ide kaq të ulët.

Nëse do t'u ktheheshit kapitujve të parë dhe të shihnit aspektet e lutjes që kemi theksuar atje, duhet të jetë e qartë se secili e ka për detyrë të lutet. A nuk duhet që secili ta adhurojë dhe ta lavdërojë Perëndinë? A nuk duhet që të gjitha qeniet njerëzore të shprehin varësinë e tyre te Krijuesi përmes kërkesës dhe falenderimit? A nuk duhet që gjithë mëkatarët të rrëfejnë mëkatet e tyre dhe të luten për falje dhe çlirim? A nuk duhet ta duam njëri-tjetrin dhe ta shprehim dashurinë duke ndërmjetësuar në lutje për njëri-tjetrin? Një person i pakthyer te Krishti nuk mund të pretendojë se është i lirë nga detyrimi për t'i bërë këto gjëra. Ai nuk mund të thotë: 'Nuk jam besimtar, kështu që nuk është detyra ime të adhurojë ose lavdërojë Perëndinë, të varem te Perëndia, ose të rrëfejë mëkatet e mia'. Por, nëse është detyra e personit jobesimtar të bëjë këto gjëra, është detyra e tij të lutet sepse të gjitha këto janë aspekte të lutjes.

Ç` mund të themi për argumentin se lutjet e një personi jo të kthyer nuk pranohen nga Perëndia, sepse nuk lutet me mendje të përqendruar në gjëra shpirtërore? Kjo na çon tek ajo që thashë më parë se: me të vërtetë do të thotë se gjendja prej mëkatari e çliron nga detyra e tij. ‘ Mungesa e përqendrimit të mendjes në gjëra shpirtërore, më justifikon nga detyrimi im për të adhuruar Perëndinë, të varem te Perëndia dhe të rrëfejë mëkatet e mia’. Jo! Nëse mendoni për një moment do ta kuptoni se sa e gënjeshtërt është kjo ide.

Mendoni sikur dikush sapo është martuar dhe pastaj i thotë gruas: ‘Grua, nuk jam i detyruar të të dua dhe të kujdesem për ty, sepse nga natyra jam egoist që nuk do t`ia dijë për të drejtat e të tjerëve. Natyra ime egoiste më çliron nga detyra për të të dashur.’ Asnjë grua nuk do të mendonte se ky do të ishte justifikim i mirë për ta rrahur atë. E njëjta gjë është dhe me marrëdhënien tonë me Perëndinë. Të refuzosh të lutesh në bazë të paperëndishmërisë tënde, do të thotë ta fyesh Perëndinë dy herë. Ne nuk jemi të gatshëm të lutemi dhe e bëjmë mosgadishmërinë tonë mëkatore një justifikim për të mos u lutur. Ky është një justifikim i ulët!

Nëse do të mund të justifikoheshim për të luturit tonë sepse na mungon dëshira, atëherë do të ishim të lirë nga pretendimet për gjithë të mirat për të njëjtën arsye. Mund të themi: ‘ Nuk kam dëshirë të jem i drejtë, i vërtetë, mirëdashës ose i vetëkontrolluar. Prandaj, nuk jam i detyruar të praktikoj këto virtyte’. A nuk është gjë tjetër veçse ta kthesh mëkatin në justifikim? Do të na jepte liri të praktikonim çdo lloj të keqeje pa marrë përsipër asnjë faj dhe pa asnjë detyrim për ta reformuar veten ose për t`u penduar. E gjithë ideja është e keqe. Ajo bie ndesh me dëshminë më të qartë të ndërgjegjeve tona. S`ka rëndësi sa mëkatarë jemi, ne e **dimë** se duhet t`i bindemi Perëndisë. Ky detyrim nuk mund të anulohet nga asnjë lloj korrupsioni.

Kështu, nëse nuk je akoma i krishterë, edhe kur je i pashpëtuar, është përsëri detyra jote të lutesh: të adhurosh, të lavdërosh, të kërkosh dhe të falenderosh Krijuesin tënd, të rrëfesh mëkatet, të kërkosh

faljen e tij dhe të ndërmjetësosh për të tjerët. Është e vërtetë se zemra jote e pashpëtuar nuk mund t'i bëjë këto gjëra në mënyrë shpirtërore që të kënaqë Perëndinë. Por, të mos i bësh fare, është akoma më keq. Më e mira për ty është t'i rrëfesh Perëndisë mëkatin e të mospaturit një zemër të shpëtuar dhe të lutesh për kthimin tënd përmes fuqisë shpëtuese të Zotit Jezu Krisht dhe Frymës së Shenjtë. Atëherë Perëndia do t'i pranojë lutjet e tua; do të kesh një mendje të re, do të kesh dëshirë të vërtetë për t'u lutur dhe drejtësia e përsosur e Jezu Krishtit, Birit të dashur të Perëndisë, kryepriutit të lartë, do të mbulojë dhe do të fshehtë gjithë mëkatin e mbetur.

Pika për reflektim ose diskutim

Si duhet t'i inkurajojmë jobesimtarët të kuptojnë detyrën e tyre për të adhuruar Perëndinë dhe të varen tek ai? Po nëse ata nuk do të besojnë te Perëndia?

Edhe pse të krishterë, ndonjëherë na mungon dëshira për t'u lutur. Si mund të zbatohet këshilla e këtij kapitulli për ne atëherë?

Sot nuk dëgjojmë shpesh që predikuesit të nxisin jobesimtarët të luten për kthimin e tyre. Më parë kjo ishte e zakonshme. Përse ka dalë nga moda kjo gjë?

Pjesa e dytë

Të përfituarit prej lutjes

**Një rishkrim i përmbledhur i
“Kthimi i lutjeve”
nga Thomas Goodwin (1600-1680)**

Përgatitur nga David Harman

Kushtuar, në mirënjohje të Perëndisë, kujtimit të
zonjushës Stephanie Wright
(ish-punonjëse në Bibliotekën Ungjillore)
që e para propozoi një përmbledhje të
“Kthimi i lutjeve”
dhe filloi punën deri në vdekjen e saj të papritur
në një aksident tragjik më 1990.

Përmbajtja

Kapitulli	Faqe
Hyrje	93
1. Njerëzit e Perëndisë duhet t'i kushtojnë vëmendje përgjigjeve të lutjeve të tyre	95
2. Si të zbulosh qëllimet e Perëndisë për ty kur lutesh	99
3. Si i përgjigjet Perëndia lutjes për të afërmit, miqtë dhe për bekimet e përkohshme	101
4. Si mund ta dimë se çfarë ndikimi kanë patur lutjet tona që të ndodhin ngjarjet	105
5. Si na ndihmon Perëndia për t'u lutur	107
6. Rëndësia e gjendjes së zemrave tona pas lutjes	112
7. Si mund ta dimë se përmbushja e një çështjeje u bë falë lutjes, apo falë Providencës së zakonshme	114
8. Vëzhgime mbi efektin që përgjigjet ndaj lutjeve kanë në zemrat tona	118
9. Si të qëndrojmë të qetë dhe të dallojmë përgjigje për lutjen, kur nuk është siguruar ajo për të cilën jemi lutur	120
10. Vërejtje për ata që nuk do të kërkojnë bekime prej lutjeve të tyre	124

Citimet biblike janë marrë nga Holy Bible, New International version, 1973, 1978, 1984 nga International Bible Society. Përdorur me leje të Hodder dhe Stoughton, anëtar i Hodder Headline Group. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Hyrje

Thomas Goodwin (1600-1680), një kongregacionalist, ishte një nga këshilltarët më të mirë të Oliver Cromwell, dhe shërbeu nën detyrën e gjeneralit si president i Magdalen College në Oksford. Në karrierën e tij të hershme Goodwin u dallua si ‘një puritan hyjnor i fuqive shumë të larta, veprat e të cilit hedhin shumë dritë mbi Shkrimet’. Në “*Kthimi i lutjeve*”, Goodwin në mënyrën e tij më të mirë shtjellon me qartësi dhe mprehtësi fjalët e Psalmi 85:8: ‘Unë kam për të dëgjuar atë që Perëndia, ZOTI ka për të thënë; me siguri ai do t’i flasë për paqe popullit të tij dhe shenjtorëve të tij, por nuk do të lejojë që ata të jetojnë përsëri si njerëz pa mend’.

Goodwin e shkroi këtë libër për të ndihmuar të krishterët të binden më shumë për vlerën e lutjes dhe të këmbëngulin në të. Disa të krishterë pushojnë së luturi sepse ata ndiejnë sikur Perëndia nuk po i përgjigjet lutjeve të tyre. Të tjerët janë të hutuar se Perëndia u përgjigjet ndryshe nga ç`prisnin. Disa besimtarë nuk e marrin mundimin të vëzhgojnë përgjigjet e Perëndisë, dhe kështu humbasin qetësinë dhe bekimin. Për të gjithë këta, ky libër do të jetë një ndihmë e madhe.

Vepra origjinale e Goodwin ndahet në tre pjesë:

1. Të dëgjosh se çfarë ka Perëndia për të thënë
2. Paqja që flet e Perëndisë
3. Marrëzia e të kthyerit në zakonet e vjetra

Kjo vepër e përmbledhur ka të bëjë vetëm me pjesën e parë. Kapitujt janë të ndarë sipas origjinalit të Goodwin. Citimet e Shkrimeve janë marrë prej New International Version i Biblës.

Psalmi 85 profetizon për kthimin e Hebrenjve nga robërimi i Babilonisë. Gjithashtu është një lutje që njerëzit e Perëndisë mund t'u gëzohen edhe njëherë bekimeve të mëparshme. Psalmisti e nxiti Zotin që të jetë i hirshëm me kishën e tij, duke i kujtuar të ketë parasysh çlirimet e mëparshme. Pastaj me të mbaruar lutjen, ai pret një përgjigje prej qiellit. 'Unë kam për të dëgjuar atë që Perëndia ka për të thënë', thotë ai.

D. G. H

Kapitulli 1

Njerëzit e Perëndisë duhet t`i kushtojnë vëmendje të veçantë përgjigjeve ndaj lutjeve të tyre

Së pari, kur i jemi lutur Perëndisë, mund të sigurohemi se ai do të na përgjigjet. ‘Perëndia im do të më dëgjojë’, thotë profeti Mikea (Mikea 7:7). ‘Do t`i hap sytë për të parë atë që do të më thotë’, thotë Habakuku (Habakuk 2:1). Përse duhet ta bëjmë këtë? Sepse ndryshe do të përçmonim sigurimin e hirshëm të Perëndisë, nëse mendojmë se lutja nuk do të ketë vlerë në realizimin e qëllimit për të cilin Perëndia e ka caktuar atë. Çdo lutje besnike është caktuar prej Perëndisë për të qenë mjet i përfitimit të asaj që kemi dëshiruar dhe jemi lutur. ‘Kjo është siguria që kemi përpara tij; nëse kërkojmë diçka sipas vullnetit të tij, ai na e plotëson’ (1Gjon 5:14). Është e vërtetë se Perëndia e dëgjon një armik, por nuk po flasim për këtë lloj kuptimi. Perëndia i dëgjon lutjet e njerëzve të tij me *dashamirësi*. Thuhet, se veshët e Perëndisë janë *të hapura* për lutjet e tyre dhe kështu Gjoni vazhdon pohimin e tij duke thënë në vargun pasardhës: ‘Dhe, nëse dimë se ai na i plotëson të gjitha ato që i kërkojmë, ne dimë se i kemi ato që i kërkuam atij’ (1 Gjoni 5:15). Lutjet tona janë marrë parasysh sapo i kemi shprehur, edhe pse procesi i përmbushjes së kërkesave tona akoma nuk ka filluar. Në momentin që një person i perëndishëm lutet, lutja shkon menjëherë në qiell dhe kërkesa mbështetet në çast. Kur Danieli u lut, u dha një përgjigje, megjithëse engjëlli që solli mesazhin arriti më vonë (Danieli 9:20-23). Asnjë lutje nuk është pa vlerë. Kur Perëndia ka dhënë një zemër për të folur, ai ka një vesh për të dëgjuar. Po ta

mendosh ndryshe do të thotë se përçmon sigurimin e hirshëm që Perëndia ka për ne.

Së dyti, nëse nuk jemi të sigurtë se lutja jonë do të dëgjohet, jo vetëm që është keqpërdorur sigurimi i Perëndisë për ne, por edhe emri i tij gjithashtu. Është e qartë se ti mendon se krahu i Perëndisë është tepër i shkurtër për të shpëtuar, ose veshi i tij tepër i shurdhër për të dëgjuar. Kështu, ti i vjedh Perëndisë një nga titujt më mbretëror, sepse ai e përshkruan veten si ‘një Perëndi që dëgjon lutjen’.

Duhet të mbash mend se kërkesat e njerëzve të Perëndisë nuk i largohen syve të tij derisa të dërgojë një përgjigje. Pasi u lut, Davidi tha se ai priste për përgjigjen më shumë sesa roja pret për mëngjesin (Psalmi 130:6). Diku tjetër Davidi thotë: ‘O ZOT, ti në mëngjes dëgjon zërin tim; në mëngjes do ta lartoj drejt teje lutjen time dhe do të pres’ (Psalmi 5:3). Ai e priste një përgjigje.

Së treti, nëse Perëndia të jep një përgjigje dhe nuk i kushtoni vëmendje, Perëndia të flet më kot. Ky është një ofendim i madh për Perëndinë. Të folurit me Perëndinë në lutje dhe përgjigja e tij për ne formojnë një pjesë të madhe të të ecurit tonë me Perëndinë. Ne duhet të studiojmë mënyrat e të vepruarit me ne dhe t’i krahasojmë lutjet tona me përgjigjet e tij. Te 1 Mbretërve 8:56, Solomoni pohon se as edhe një fjalë nga premtimet e mira të Perëndisë nuk ka dështuar. Ne duhet t’i mendojmë lutjet tona si mënyrë e plotësimit të premtimeve të Perëndisë.

Përsëri, nëse nuk pret që Perëndia të të flasë, do ta provokosh që të të mos përgjigjet fare. Perëndia do ta kuptojë se nuk do t’ia vlejë të të përgjigjet. Nuk mjafton vetëm të lutesh. Pasi je lutur të duhet të dëgjosh për një përgjigje në mënyrë që të marrësh atë për të cilën je lutur. Ndryshe, nuk do të vësh re se si Perëndia i përmbush lutjet e tua. Si do ta bekosh dhe do ta falenderosh Perëndinë që të ka dëgjuar? Të ndenjurit zgjuar dhe falenderimi janë gjëra që kërkohen në lutje (Kolosianët 4:2). Ndoshta, arsyeja pse ti lutesh kaq shumë dhe falenderon kaq pak, është se i kushton kaq pak vëmendje përgjigjeve të Perëndisë. Kur kemi ofruar një lutje besnike, Perëndia është bërë borxhli për shkak të premtimeve të tij.

Duhet të kemi parasysh pagesën e tij dhe t'i japim një dëftesë pagese. Ndryshe Perëndia humbet lavdërimin që i takon.

Nëse për shkak të kësaj, Perëndia humbet atë që i takon edhe ti do të humbasësh. Do të humbasësh përvojën që mund të kishe përmes saj – një përvojë të Perëndisë dhe besnikërisë së tij. Nëse keni provuar herë pas here se Perëndia i përgjigjet lutjeve të tua, përvoja të tilla do t'ju japin shpresë dhe besim te Perëndia për herë të tjera. Davidi thotë: 'Duke qenë se e ka kthyer ndaj meje veshin e tij, unë do ta kërkoj në gjithë ditët e jetës sime' (Psalmi 116:2). Është njësoj sikur të kishte thënë: 'Tani që Perëndia më ka dëgjuar, e di ku të shkoj. Kjo përvojë, edhe sikur të mos kisha më, mjafton për të më inkurajuar që të vazhdoj t'i lutem Perëndisë'.

Për më tepër, duke vënë re përgjigjet e Perëndisë ndaj lutjeve të tua, do të fitosh një mprehtësi brenda zemrës, rrugëve e lutjeve të tua, dhe do të mësosh si t'i gjykosh ato. Siguria e Davidit se në zemrën e tij nuk kishte dëshira mëkatore u forcua nga fakti se Perëndia i dëgjoji lutjet e tij. Ja, se si arsyeton ai: 'Po të kisha ruajtur të keqen në zemrën time, Zoti nuk do të më kishte dëgjuar. Por Perëndia më dëgjoji dhe i kushtoi kujdes zërit të lutjes sime' (Psalmi 66:18-19). Nëse Perëndia nuk do t'i përgjigjet kërkesave të tua, do të të bëjë që të kërkosh arsyen për këtë. Atëherë do të shqyrtosh lutjet e tua dhe gjendjen e lutjeve të tua për të parë nëse, në fakt, je lutur sipas motiveve të gabuara (shiko Jakobi 4:3). Nëse një miku yt, që zakonisht është i përpiktë kur i përgjigjet letrave të tua, nuk e bën këtë në një rast të veçantë, ti fillon të mendosh se diçka nuk ecën. Atëherë mundohesh të zbulosh se çfarë e ka shkaktuar vonesën. Ndoshta në ndonjë farë mënyre e ke ofenduar mikun tënd. Ndodh njësoj me lutjet e tua. Nëse nuk i kushton vëmendje përgjigjeve të lutjes, do të humbasësh qetësinë. Nuk ka gëzim më të madh sesa të shohësh lutjet të përgjigjura. 'Kërkoni dhe do të merrni, që gëzimi juaj të jetë i plotë', thotë Jezusi (Gjoni 16-24). Ashtu siç është gëzim i madh të shohësh dikë të kthyer te Krishti, është një gëzim akoma dhe më i madh për atë që ka ndihmuar për këtë. Të shohësh Perëndinë që i bën të mirë kishës së tij dhe të dëgjosh lutjet e të tjerëve për të, ky vërtet që është ngushëllim. Aq më tepër, është

gëzim të shohësh Perëndinë ta bëjë atë si rezultat i lutjeve të dikujt! Që Perëndia dhe ne duhet të jemi të një mendjeje dhe të dëshirojmë të njëjtat gjëra, është një arsye për t' u gëzuar. Është e mrekullueshme kur kuptojmë se kemi marrë një përgjigje. Ti humbet qetësinë dhe bekimin kur nuk i kushton vëmendje përgjigjeve të lutjeve të tua.

Kapitulli 2

Si të zbulosh qëllimet e Perëndisë për ty kur lutesh

Si i dallon përgjigjet për lutjet e tua dhe si e di kur Perëndia po vepron për t'iu përgjigjur atyre? Së pari, duhet të jesh i lumtur kur sheh se disa lutje kurrë nuk kanë marrë përgjigje në gjithë jetën tënde. Për shembull, përmbushja e lutjeve të tua për rënien e plotë të armiqve të Perëndisë dhe lulëzimin e ungjillit duhet të presë që Kisha të korrë në vitet që do të vijnë. Këto lutje nuk do të humbasin. Nëse janë ofruar nga Fryma e përjetshme, ato kanë kuptim të përjetshëm. Për shembull, lutja që bëri Stefani për persekutorët e tij, te Vep. e Apostujve 7:60, u përmbush pas vdekjes së tij në kthimin e Saulit nga Tarsus. Lutja e Davidit kundër armiqve të tij në Psalmin 109:8-9, përmbushjen e tij përfundimtare e arriti pas njëmijë vitesh më vonë me rënien Judës (Vep. Apostujve 1:20). Kur profetët parashikuan vuajtjet e Krishtit dhe lavdinë që do të pasonte, atyre iu zbulua se nuk po i shërbenin vetes, por neve (1 Pjetrit 1:10-12). Kështu, në lutje, nëse lutemi nën udhëheqjen e Frymës së Shenjtë, ne mund të kërkojmë shumë gjëra që do të realizohen shumë vonë. Ndoshta, Perëndia do të të zbulojë, nëpërmjet një përshtypjeje të fshehtë në frymën tënde, se ai do t'iu përdorë lutjet e tua ndërmjet të tjerave për realizimin e qëllimeve të tij në ditët që do të vijnë. Në këtë mënyrë, Perëndia do të të japë sigurinë se ai të ka pranuar si person që i përket atij.

Perëndia kurrë më parë nuk i zbuloi më shumë nga dashuria e tij Moisiut, sesa kur ai u lut për njerëzit e Perëndisë. Një nga dëshmitë më të mira të qëndrueshmërisë së zemrës tënde është se mund të lutesh për të mirën e kishës edhe për të ardhmen, edhe pse nuk do të mund ta shohësh kurrë me sytë e tu. Kur të arrish në qiell, gëzimi yt do të jetë i plotë kur të kuptosh se lutjet e tua kanë rezultuar në kthimin e atyre për të cilët je lutur dhe shkatërrimin e armiqve të kishës. Ka gëzim në qiell për një mëkatar që pendohet. Po ashtu, ata, lutjet e të cilëve janë përdorur nga Perëndia në çdo rast, do të kenë arsye të fortë për t`u gëzuar në qiell!

Kapitulli 3

Si i përgjigjet Perëndia lutjes për të afërmit tanë, miqtë dhe bekimet e përkohshme

Ne jemi urdhëruar të lutemi për të tjerët. Shiko, për shembull, Jakobin 5:16 dhe 1 Gjoni 5:16. Si e kanë marrë përgjigjen këto lutje? Ne e dimë se këto lutje shpesh plotësohen. Përndryshe, përse Perëndia do të bënte premtime që kanë të bëjnë me to? Perëndia na jep premtime që na inkurajojnë të lutemi dhe të dëshmojmë dashurinë e tij të pasur për ne. Kjo tregon se mbështetemi nga Perëndia kur na dëgjon dhe është një dëshmi e priftëritit tonë. Ne e kemi këtë mbështetje përmes bashkësisë që kemi në Krishtin si Kryepriftin tonë. Perëndia na ka bërë mbretër dhe priftërinj për t'i bindur të tjerët dhe për të ndërmjetësuar për ta. Nëse Perëndia dëgjon lutjet për të tjerët, a nuk do të na dëgjojë akoma më shumë ne për nevojat tona? Kur Krishti shëroi të paralizuarin te Mateu 9:2, shkruhet se ai i kushtoi vëmendje besimit të atyre që e sollën njeriun tek ai. Ky shkrim ka për qëllim të na inkurajojë që t'i sjellim të tjerët në lutje te Zoti.

Megjithatë, lutjet tona për të tjerët, ndoshta shpesh mund të mos marrin përgjigje ashtu si shpresonim ne. Lutja e Samuelit për Saulin nuk u mbështet (krahaso 1 Samueli 15:11 me vargun 35). Lutja është si mjetet e tjera që Perëndia ka ndërtuar për të mirën e të tjerëve. Ne mund t'u predikojmë shumë njerëzve dhe prapë pak mund të besojnë. Po ashtu, mund të lutemi për shumë, pa e ditur se cilët janë caktuar të marrin jetë të përjetshme. Megjithatë, edhe pse nuk e dimë se ç'do të ndodhë, ne prapë duhet

të lutemi për ta (1 Timoteu 2: 1-4). Atje ku Perëndia jep mundësi për predikim ka më shumë të ngjarë që ai ka disa njerëz për të kthyer. Zakonisht, Fjala e Perëndisë zë rrënjë te disa, edhe pse shpesh në pak prej tyre.

Në të njëjtën mënyrë, kur Perëndia ka trazuar zemrat tona për t'u lutur për të tjerët, është një shenjë se ai do të na dëgjojë, për të paktën disa prej tyre. Mbase Perëndia, në urtësinë e tij, i mohon kërkesat tona për disa. Perëndia na kërkon të lutemi sipas detyrës sepse lutja është një mjet i caktuar prej tij, përmes së cilës ai shpesh lejon që të ndodhin gjëra. Megjithatë, Perëndia nuk e detyron veten t'i përgjigjet çdo lutjeje në të njëjtën mënyrë siç e kemi kërkuar. Edhe pse premtimi i Perëndisë për të dëgjuar dhe për të pranuar lutjen është i përgjithshëm dhe universal, përsëri premtimi i tij për ta dëgjuar atë, duke mbështetur atë gjë për të cilën është bërë lutja, është i papërcaktuar. Perëndia bën premtime të njëjta përsa i përket mjeteve të tjera të të bërit mirë njerëzve, si predikimet dhe qortimet tona. Për shembull, premtimi i shërimit te Jakobi 5:15, nuk mund të jetë universal. Po të ishte premtimi universal, do të arrinim në përfundimin se njerëzit e sëmurë për të cilët janë lutur nuk do të vdisnin kurrë. Por e dimë se për të gjithë njerëzit është caktuar që të vdesin. Shkrimi te Jakobi është siguri, të cilit Perëndia i ka lidhur një premtim të hirshëm, sepse shpesh ai e shëron të sëmurin përmes lutjes, edhe pse jo në çdo rast. Në raste të tjera të veçanta ne duhet të mbështetemi te Perëndia për të përmbushur premtimet e tij, duke pushuar qetësisht në Fjalën e tij. Sidoqoftë, nuk mund të kemi një siguri të plotë se do të marrim gjithçka që kërkojmë, sepse premtimi nuk është universal, por i papërcaktuar.

Kjo mund të ilustronet nëpërmjet referencave për premtime të tjera të një natyre të dukshme dhe të përkohshme. Ka një premtim për jetë të gjatë për ata që nderojnë prindërit e tyre, megjithatë nga përvoja dhe nga Shkrimi e dimë se nuk del gjithmonë kështu. Prandaj, ky premtim i veçantë nuk mund të jetë absolut, i pagabueshëm ose universal, por vetëm i papërcaktuar.

Ndërkohë, që ne duhet t'i afrohem premtimeve të tilla në besim, duhet ta bëjmë këtë duke u prehur qetësisht te Perëndia dhe në përulje ndaj vullnetit të tij. Ne duhet t'i nënshtrohemi kënaqësisë së mirë të Perëndisë sipas mënyrës që ai i jep fund çështjes. Besimi duhet të përqafojë premtimet, në përgjithësi,

në besim të plotë se Perëndia mendon seriozisht për ato që ka thënë dhe se me siguri ai do t'i përmbushë premtimet e ti, sipas qëllimit të tij. Megjithatë, nuk duhet të supozojmë se në ndonjë rast të veçantë premtimet e Perëndisë do të plotësohen në po atë mënyrë si e kemi menduar ne. E vërteta, qëllimi dhe synimi i premtimit nuk është universal, por i papërcaktuar. Ajo që Perëndia kërkon prej nesh nuk është një bindje e plotë absolute se ai do të zbatojë një premtim për ne në ndonjë mënyrë të veçantë. Perëndia kërkon një veprim varësie, të prehesh qetësisht në vullnetin e tij. Prapëseprapë, nëse Perëndia duhet të na japë një besim të veçantë që ka të bëjë me ndonjë bekim të përkohshëm të veçantë për ne ose të tjerët, duhet të jemi të sigurt se do ta marrim.

Kur Perëndia u dha apostujve pushtet për të kryer mrekulli, ata ishin të detyruar të besonin se mrekullitë do të kryeheshin prej tyre pa dështim, ashtu si në rastin e dëbimit të demonëve. Prandaj në një rast Jezusi i qorton ata për mungesë besimi në këtë drejtim (Mateu 17:19-20). Prandaj fjalët e Jezusit te Mateu 21:21-22 duhet të kuptohen në këtë mënyrë: "Po të keni besim dhe të mos dyshoni... mund t'i thoni këtij mali: 'Hiq andej dhe hidhu në det', kjo do të ndodhë. Dhe gjithçka të kërkonti në lutje, duke patur besim, do ta merrni". Kur Perëndia vepron në ne një besim të tillë, duhet të besojmë me siguri absolute se kjo gjë do të bëhet, dhe ajo do të bëhet. Por Perëndia jo gjithmonë na thërret në një lloj besimi kaq të veçantë. Nëse Perëndia e ngriti një besim të tillë, ai do ta realizojë atë që është kërkuar, por në përgjithësi premtimet e bëra për gjërat e jashtme nuk janë universale, por të papërcaktuara. Prandaj, ne nuk mund të besojmë me siguri absolute se Perëndia është i detyruar t'u japë ndonjë bekim të përkohshëm të tjerëve ose neve në përgjigje të lutjeve tona.

Kur lutemi për të tjerët dhe Perëndia nuk e sheh të përshtatshme ta mbështesë atë bekim të veçantë, atëherë, edhe pse lutjet tona duket se na kthehen të papërgjigjura, do të kthehen për të mirën tonë. Në Psalmin 35:12-13, Davidi thotë se ai u lut për armiqtë e tij kur ata ishin sëmurë, porse lutjet e tij iu kthyen të papërgjigjura. Në lutjet e tij, Davidi tregoi sinqeritetin e zemrës së tij për Perëndinë dhe faljen

e vërtetë për armiqtë e tij. Edhe pse lutja nuk i fitoi armiqtë e tij, ajo doli për të mirën e Davidit. Lutja u kthye me bekime për të. Perëndia ngre te fëmijët e tij këtë vullnet për t`u lutur për armiqtë e tyre, por jo gjithmonë mendon t`u përgjigjet atyre lutjeve në mënyrën se si i është kërkuar. Ai mendon t`u hapë rrugën dhe t`i vlerësojë këto qëndrime të shenjta të zemrës, të cilat janë pjesa më fisnike e imazhit të Perëndisë në fëmijët e tij dhe me të cilat ai kënaqet aq shumë.

Nëse jemi lutur për një kohë të gjatë për ata të cilët Perëndia nuk ka për qëllim t`i bekojë, në fund ai do të na e largojë dëshirën e të luturit për ta. Atë që i bëri Perëndia me anë të një zbuluese nga qielli Samuelit (1 Samuel 16:1) dhe Jeremias (Jeremia 7:16), ai e bën këtë tani me anë të një metode më pak të dukshme. Ai do ta tërheqë ndihmën e Frymës së Shenjtë në lutje. Perëndia e bën këtë sepse ai nuk ka qejf të mos i dëgjojë njerëzit e tij kur luten. Kur Perëndia nuk ka dëshirë të dëgjojë, ai e largon çelësin e lutjes, kaq dëshirë ka ai t`i përgjigjet çdo lutjeje. Ndonjëherë Perëndia na lejon të lutemi për kthimin ose të mirën e dikujt që ai nuk ka qëllim ta bekojë. Ai e bën këtë për të treguar se mendimet e tij nuk janë të njëjta me tonat, sepse ai mund t`i përgjigjet atyre lutjeve në jetën e dikujt tjetër. Perëndia do të na japë aq gëzim, sa do të na jepte po të përgjigjej sipas qëllimit tonë origjinal. Abrahami u lut për Ishmaelin, por në vend të tij Perëndia i dha Isakun (Zanafilla 17:18-19). Mund të lutesh për një person më shumë se për një tjetër për shkak të tërheqjes natyrore ndaj tij. Megjithatë, Perëndia mund të të përgjigjet duke bekuar një tjetër për të cilin zemra jote nuk ka qenë shumë e trazuar. Kur tjetri është kthyer, del që të jetë po aq ngushëllim i madh sa po të bekohej i pari për të cilin u lute.

Kapitulli 4

Si mund ta dimë se çfarë ndikimi kanë lutjet tona në realizimin e ngjarjeve

Si mund ta dimë se çfarë efekti ka patur kontributi ynë kur jemi bashkuar me të tjerët në lutje? Satani është gati ta kundërshtojë. Edhe pse lutja mori përgjigje, nuk ishte falë ndonjë kontributi nga ana jonë. Përgjigjet janë:

1. Nëse je bashkuar me gjithë zemër në lutje me të tjerët, atëherë është e sigurt që zëri yt ka ndihmuar që ajo të jetë më e efektshme. Jezusi tha: 'Në qoftë se dy prej jush bien në ujdë mbi tokë të kërkojnë çfarëdo gjëje, kjo do t'u jepet atyre nga Ati im që është në qiej' (Mateu 18:19). Shprehja 'bie në ujdë', këtu ka kuptimin që t'i biesh të njëjtës melodi në mënyrë të harmonishme. Lutjet janë muzikë për veshët e Perëndisë. Kjo do të thotë se nuk është e rëndësishme thjesht të qenit në një mendje për atë që lutesh; përfshihen gjithashtu edhe emocionet. Emocionet janë ato që bëjnë bashkësinë dhe melodinë. Tani, nëse të njëjtat emocione të shenjta ngrihen prej Frymës së Perëndisë në zemrën tënde ashtu si tek të tjerët, atëherë ti ndihmon për të formuar bashkësinë. Me të vërtetë që pa zërin tënd melodia nuk do të jetë e plotë. Veçanërisht ndodh kështu kur, pa e ditur, të tjerët luteshin për të njëjtën gjë. Atëherë, patjetër që lutjet e tua kanë patur efekt po ashtu si ato të të tjerëve.

2. Perëndia shpesh siguron dëshmi në mënyra të ndryshme që lutjet e një personi kanë kontribuar në përmbushjen e diçkaje.

(a) Perëndia mund të ketë caktuar që personi që është lutur më shumë për një problem të marrë lajmin e parë të përmbushjes së tij. Pa diskutim, që Simeoni ka qenë më i zjarrtë kur i ka kërkuar Perëndisë të dërgojë Mesian në botë dhe të shpëtojë popullin e tij Izraelin. Perëndia i kishte zbuluar atij se ai nuk do të vdiste derisa ta kishte parë vetë Krishtin. Kështu, për t' i dhënë dëshmi Simeonit për vëmendjen e Perëndisë për lutjet e tij, Perëndia e solli plakun në tempull në po atë kohë që fëmija u soll për t' iu paraqitur Zotit (Luka 2:27-28). Ana, që i kishte shërbyer Perëndisë me agjërime dhe lutje, erdhi gjithashtu në tempull në të njëjtën kohë (Luka 2:36-38). Nëpërmjet këtyre rrethanave apo të tjerave, Perëndia shpesh i dëshmon zemrave tona se i ka dëgjuar lutjet bashkë me ato të të tjerëve.

(b) Perëndia mund të ta gëzojë zemrën në përmbushjen e asaj për të cilën je lutur. Kjo është një dëshmi e fuqishme se lutjet tona, po ashtu dhe ato të të tjerëve, e bën Zotin që të realizonte atë gjë. Simeoni ishte i tejmbushur me gëzim, saqë ishte gati të vdiste kur pa përgjigjen e lutjeve të tij. Nëse ke një zemër falenderuese për bekimin e marrë nga dikush për të cilin ti u bashkove me të tjerët në lutje, është një shenjë se lutjet e tua kanë patur pjesën e tyre në rezultat.

(c) Perëndia mund të të shtyjë të lutesh për veten, dhe bën që dhe të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë për ty. Nëse këto lutje dëgjoen, atëherë me siguri që Perëndia i ka kushtuar kujdes lutjeve të tua, madje më shumë se lutjeve që të tjerët kanë bërë për ty.

Kapitulli 5

Si na ndihmon Perëndia të lutemi

Kur Perëndia dëshiron që ne të lutemi, ai krijon një kornizë lutëse të mendjes. Ai krijon motive dhe sugjeron argumente dhe kërkesa për t' i sjellë para Perëndisë. Së bashku me këtë gjejmë një ngrohje të zemrave tona, një dëshirë, një pritje dhe një shqetësim të frymës për të qenë vetëm, dhe të hapë shpirtin para Perëndisë. Duhet t' u kushtojmë vëmendje këtyre momenteve dhe jo t' i lëmë pas dore, sepse atëherë është e sigurt që Perëndia na dëgjon. Është një mundësi e veçantë për lutje, saqë të tillë mund të mos kemi kurrë. Psalmisti thotë: 'O ZOT, ti dëgjon dëshirën e njerëzve të përlurur; ti e fortëson zemrën e tyre, veshët e tu janë të vëmendshëm' (Psalmi 10:17). Është shenjë e sigurt që Perëndia ka ndërmend të të dëgjojë kur ai i ngrë kërkesat e tua në këtë mënyrë. Në këtë drejtim, sido që të jetë, duhet të vërejmë ndryshimin midis punës së Perëndisë dhe asaj të Satanit. Satani shpesh do të bëjë sugjerime dhe nxitje të paarsyeshme për t' u lutur kur punojmë ose kemi nevojë për të ngrënë ose për të fjetur. Ai e përdor këtë mjet, veçanërisht për të lodhur të kthyerit e rinj. Ndryshimi është se djalli vjen në një mënyrë arrogante dhe të dhunshme në ndërgjegje, por në asnjë mënyrë nuk e përgatit zemrën për t' u lutur. Në anën tjetër, nëse Perëndia na thërret në lutje në kohë të jashtëzakonshme, e përshtat dhe e përgatit zemrën për këtë. Ai e mbush shpirtin me dëshira të shenjta dhe të jep aftësinë për të bërë gjërat që ai kërkon. Kur Perëndia dëshiron të ketë të përfunduara ndonjë nga çështjet, i vendos zemrat e njerëzve në punë për t' u lutur nëpërmjet një lloj instikti të hirshëm.

Ai i trazon ato dhe i lëviz zemrat e tyre nga ndikimi i Frymës së Shenjtë. Kur Danieli e dinte nga Shkrimet se koha e robërisë së Judës po mbaronte, ai u shty t`ia kërkonte atë Perëndisë (Danieli 9:2). Kjo ishte tamam ajo që Perëndia kishte thënë se do të ndodhte. Përmes Jeremisë, Perëndia tha se do të bënte të mundur kthimin e popullit të tij në vendin e tyre. ‘Kur të mbushen shtatëdhjetë vjet për Babiloninë, unë do t`ju vizitoj dhe do ta realizoj fjalën time të mirë, duke bërë të riktheheni në këtë vend...do të më kërkoni dhe do të vini të më luteni, dhe unë do t`ju kënaq. Do të më kërkoni dhe do të më gjeni, sepse do të më kërkoni me gjithë zemrën tuaj. Unë do të bëj që ju të më gjeni, thotë ZOTI’ (Jeremia 29:10-14). Prandaj, na duhet t`i kushtojmë vëmendje momenteve kur Perëndia veçanërisht prek zemrat tona për t`u lutur.

Ndonjëherë, mund të mos mendojmë të lutemi për ndonjë gjë të veçantë, por Perëndia na nxit të lutemi duke na sjellë në praninë e tij dhe duke na bërë ta thërrasim emrin e tij. Kështu, kur Perëndia na thërret në lutje është një shenjë e sigurt se ai synon të na dëgjojë.

Ka gjithashtu mënyra të tjera në të cilat jemi të sigurt që Perëndia na dëgjon.

1. Kur Perëndia qetëson, pushon dhe kënaq zemrën në lutje, kjo është shenjë e mirë. Pali u lut me zell që Perëndia t`i largonte gjembin në mish. Ai thotë se ia ka kërkuar këtë tre herë Zotit. Megjithatë, Perëndia e siguroi Palin se hiri i tij ishte i mjaftueshëm për të dhe se fuqia e tij përsosej në dobësi. Kjo e qetësoi mendjen e apostullit (2 Korintasve 12:7-9). Mund t`i jesh lutur Perëndisë për një kohë të gjatë për të të larguar një shqetësim, dhe Perëndia të ngushëllon me një premtim si ky: ‘Nuk do t`ju lë dhe nuk do t`ju braktis’. Kjo e qetëson dhe e kënaq mendjen. Është përgjigjja e Perëndisë dhe ti duhet t`i kushtosh vëmendje përgjigjeve të tilla, sepse janë të çmuara.

2. Kur Perëndia të afrohet dhe të zbulon dashurinë e tij në lutje, është një shenjë se ai të dëgjon duke e konsideruar atë kërkesë të veçantë. Duhet t'i kushtosh rëndësi kësaj, sepse Perëndia, duke të buzëqeshur dhe duke të mirëpritur, tregon që jo vetëm e dëgjon lutjen tënde, por se të pranon edhe ty si person. Isaia thotë: “ Atëherë do të thërrasësh dhe ZOTI do të të përgjigjet, do të bërtasësh dhe ai do të thotë: ‘Ja ku jam!’”(Isaia 58:9). Do të ketë kohë kur nuk do të vish në praninë e Perëndisë për ta kërkuar më shpejt, por ai thotë: ‘Ja ku jam’. Kur Perëndia afrohet në këtë mënyrë, kjo është një shenjë e sigurt se ai të dëgjon.

Danieli agjëroi dhe u lut për tre javë, kur një mesazher qiellor erdhi dhe i tha atij se ishte vlerësuar shumë dhe se fjalët e tij ishin dëgjuar që nga dita e parë (Danieli 10:11-12). Njësoj, kur Perëndia me anë të Frymës së tij zbrit, të takon dhe të thotë fshehtësisht se ti je i dashur për të dhe se ai është për ty, atëherë lutjet e tua me siguri janë dëgjuar. Nëse ai të pranon si person, aq më tepër ai i pranon lutjet e tua.

Sido që të jetë, duhet patur kujdes. Kjo nuk është gjithmonë një shenjë e pagabueshme se një kërkesë e veçantë do të merret parasysh, megjithëse lutja është pranuar. Pa dyshim që është një dëshmi se lutja jote është dëgjuar. Madje dhe ajo që kërkon bie dakort me vullnetin e Perëndisë dhe ai të mbështet ty dhe kërkesën tënde. Nëse Perëndia atëherë afrohet, përse nuk ka në mendje të marrë parasysh kërkesën? Përgjigja është se Perëndia *miraton* shumë gjëra të cilat nuk *i dekreton*. Ai ka një vullnet miratues dhe një vullnet dekretues. Perëndia mund ta tregojë vullnetin e tij miratues për atë që kërkon duke u afruar në mënyrën e përshkruar. Le të supozojmë se ke qenë duke kërkuar diçka e cila ka shumë rëndësi për kishën. Perëndia tregon miratimin e tij për inkurajimin tënd, megjithatë nuk do të thotë domosdoshmërisht se ai ka dekretuar ta bëjë atë gjë të veçantë. Zbulesa e vetes së tij shpesh është e vetmja përgjigje që kishte për një lutje të tillë. Është përgjigje e mjaftueshme t'i gëzohesh sigurisë së dashurisë së Perëndisë.

Mund të jesh lutur kundër një të keqeje të cilën e kupton se vjen mbi kishën. Perëndia përsëri mund të ketë për qëllim ta lejojë atë të keqe, por për shkak se e bën zemrën tënde të lutet kundër saj duke demonstruar sinqeritetin tënd, ai afrohet. Ai të tregon se do të shkojë mbarë me ty dhe se ai të do shumë. Ndonjëherë kjo është e vetmja përgjigje që Perëndia synon të japë. Ndonjëherë e bën këtë për të kënaqur zemrën tënde dhe e përgatit atë për një refuzim. Ndryshe, refuzimi i asaj që ke kërkuar me zjarr mund të të bëjë të diskutosh ose të dyshosh dashurinë e Perëndisë.

3. Është shenjë e mirë kur Perëndia nxit një besim të veçantë për diçka, duke na mbajtur në pritje për të, pavarësisht nga gjithë dekurajimet. Këtë e bëri për Davidin në Psalmi 27. Në atë kohë, Davidi ishte në rrezik të madh nga Sauli ose Absolomi dhe kaq shpesh, sa në gjithë mundësinë e dukshme ai kurrë nuk do të jetonte qetësisht përsëri në Jeruzalem. Davidi, megjithatë, u lut dhe e bëri atë kërkesën më të lartë të gjithë jetës së tij. Ai tha: 'Një gjë i kërkova ZOTIT dhe atë kërkoj: të banoj në shtëpinë e ZOTIT tërë ditët e jetës sime' (Psalmi 27:4). Perëndia i siguroi atij një besim të veçantë se do të ishte kështu, sepse kishte thënë më parë në vargun 3: 'Edhe sikur një ushtri të dilte kundër meje, zemra ime nuk do të kishte frikë; edhe sikur një luftë të pëlçiste kundër meje, edhe atëherë do të kisha besim. Besimi i Davidit ishte i përligjur. Me anë të lutjes zemrat tona mund të forcohen dhe sigurohen, veçanërisht, se Perëndia me siguri do të veprojë. Kjo është e rrallë dhe e jashtëzakonshme, por në asnjë mënyrë e panjohur.

Edhe këtu nevojitet kujdes. Gjëja për të cilën jemi lutur jo gjithmonë ndodh. Ato bindje të nxitura prej Perëndisë, mund të jenë, dhe shpesh janë të kushtëzuara mbi bindjen. Në rastin e familjes së Elit, Perëndia tha: 'Unë kisha shpallur që shtëpia jote dhe shtëpia e atit tënd do të kishin ecur gjithnjë para meje'. Por Perëndia vazhdon të thotë: 'Qoftë larg meje kjo gjë; sepse unë nderoj ata që më nderojnë, por ata që më përçmojnë do të përçmohen gjithashtu nga ana ime' (1 Samuelit 2:30). Bijtë e Elit e thyen kushtin e përfshirë në premtim dhe kështu ata i humbën bekimet.

4. Gjithashtu, shenjë e mirë është kur Perëndia krijon një këmbëngulje të vazhdueshme, pavarësisht nga gjithë dekurajimet. Ashtu si më lart kur Davidi tha: 'Një gjë i kërkova dhe atë kërkoj', ai nuk pushoi së kërkuari për të prej Perëndisë. Jezusi u mësoi të njëjtën të vërtetë në shëmbëlltyrën e vejushës këmbëngulëse (Luka 18:1-8). Vini re, megjithatë, se është e mundur të jesh këmbëngulës nga një dëshirë e padukshme. Është e mundur të kërkosh me motive të gabuara dhe atëherë nuk do të marrim atë që kemi kërkuar (Jakobi 4:3). Megjithatë, nëse këmbëngulja jonë i bashkangjitet varësisë në vullnetin e Perëndisë, atëherë është Perëndia që e ka nxitur atë dhe ne me besim mund të presim një përgjigje.

Kapitulli 6

Rëndësia e gjendjes së zemrave tona pas lutjes

Ty të duhet të sigurohesh se ke një zemër të bindur dhe që varet te Perëndia. Nëse Perëndia të mban në një kornizë më të bindur frymërore pasi je lutur, kjo është një shenjë se ai synon të të përgjigjet. Davidi thotë: ‘Po të kisha ruajtur të keqen në zemrën time, Zoti nuk do të më kishte dëgjuar. Por Perëndia më dëgjoji dhe i kushtoi kujdes zërit të lutjes sime’ (Psalmi 66:18-19). Kjo konsideratë vepronte si një fre mbi Davidin, kështu ai ishte i kujdesshëm që të mos mëkatonte. Nëse jemi të pakujdesshëm për mënyrën se si e shohim mëkatën, kjo e provokon Perëndinë dhe mund të humbasim çfarëdo gjëje që kemi fituar prej të luturit.

Në një rast tjetër, në Psalmin 143, kur Davidi rrezikonte të humbiste jetën, ai veçanërisht u lut që Perëndia ta drejtonte dhe ta mbante. Davidi e dinte se po të mëkatonte, të gjitha lutjet e tij nuk do të kishin vlerë. Kështu, pasi u lut që Perëndia ta shpëtonte nga armiqtë e tij, ai u lut: ‘Më mëso ta plotësoj vullnetin tënd, sepse ti je Perëndia im; Fryma jote e mirë le të më udhëheqë në tokë të shenjtë’ (Psalmi 143:10). Kjo ishte më e rëndësishme për të sesa vetë çlirimi i tij. Kur Perëndia mendoi t’ia jepte mbretërinë Davidit, Ai e ruajti atë të pafajshëm dhe zemrën e tij të butë. (Shih 1 Samuelit 24:1-7).

Ti duhet të vazhdosh të shpresosh te Perëndia edhe për përmbushjen e kërkesave të tua, duke i treguar Perëndisë se ti shpreson dhe po pret për një përgjigje. Kjo është një shenjë se përgjigjja po vjen. Davidi

tha: ‘Oh, sikur të mos isha i sigurt të shoh mirësinë e ZOTIT në dheun e të gjallëve! Ki besim të madh te ZOTI; ji i fortë; ki zemër; ki besim të madh te ZOTI’ (Psalmi 27:13-14). Shpresa dhe pritshmëria e një njeriu të perëndishëm do ta turpëronin nëse nuk do të ishin përmbushur. Prandaj është e sigurt se përgjigjet do të vijë dhe nënkuptohen nëpërmjet këtyre fjalëve: ‘Ki shpresë të patundur te ZOTI dhe ndiq rrugën e tij, dhe ai do të të lartojë...’ (Psalmi 37:34).

Kapitulli 7

Si mund ta dimë se një çështje u përmbush falë lutjes apo Providencës së zakonshme

Ne jemi të prirur të shohim ato që janë përgjigje të vërteta të lutjes si rrjedhim i providencës së zakonshme. Si mund t'i dallojmë përgjigjet e vërteta të lutjes?

1. Kur Perëndia bën diçka në përgjigje të lutjes, ai shpesh e bën këtë në një mënyrë të tillë që është e pagabueshme. Kur Perëndia dëgjon lutjet që janë bërë para ca kohësh, ai zakonisht tregon gjysmë mrekullie në një mënyrë apo në një tjetër. Perëndia, në shumë mënyra, tregon dorën e tij në përgjigjet e lutjes:

(a) Shumë pengesa dhe vështirësi mund të gjenden në rrugën e përgjigjes. Po të lëvizen, Perëndia që bën me qëllim një çelës për të hapur derën, është një shenjë se kjo është rezultat i lutjes. Ka shumë shembuj të tillë në Bibël: ardhja e Davidit në mbretëri; Jozefi i liruar nga burgu; Mordekai i ngritur në lavdi; Pjetri i liruar nga burgu. Ky i fundit është rasti më njohur. Pjetri po flinte midis dy ushtarëve. Po të ishin zgjuar, ai do të zbulohej. Ai ishte i lidhur me zinxhirë, por ato u këputën. Kishte roje te dera, por ata nuk panë asgjë. Një portë hekuri u hap pa forcë.

2. Kur Perëndia përdor një kombinim faktorësh si këta për të bërë diçka, mungesa e njërës prej tyre do ta kishte bërë të pamundur, atëherë, këtë gjë e ka bërë lutja. Kur Perëndia e çliroi popullin e Izraelit nga

Egjipti, robëruesit e tyre erdhën vetë në mesnatë dhe iu lutën atyre të largoheshin, madje dhe duke i nxitur me dhurata dhe bizhuteri. Faraoni vetë i la të lirë ata me mirësjellje duke dëshiruar që nëpërmjet lutjeve të tyre, Perëndia do ta bekonte dhe atë. Asnjë qen nuk e hapi gojën, kështu që as edhe një krijesë e shëmtuar nuk e shqetësoi Izraelin gjatë natës, kur zakonisht ata do t'i kishin shqetësuar aq shumë.

3. Kur Perëndia bën të mundur arritjen e menjëhershme dhe të papritur të diçkaje për të cilën njerëzit janë lutur për një kohë të gjatë, ndoshta edhe më parë se të ndërgjegjësohemi për të, padyshim që është përgjigje e lutjes. Në shembujt e mësipërm, Pjetri ishte duke fjetur dhe as që po ëndërronte për çlirimin. E papritura në lirim të Jozefit nga burgu dhe përparimi i tij për të qenë më i madhi në mbretëri, tregoi se Perëndia nuk e kishte harruar dhe i ishte përgjigjur lutjeve të tij.

4. Kur Perëndia siguron më shumë se sa kemi kërkuar, kjo gjithashtu është një shenjë se ai i ka dëgjuar lutjet tona. Pali tha se Perëndia 'mund të bëjë jashtë mase më tepër nga sa kërkojmë ose mendojmë' (Efesianët 3:20). Solomoni kërkoj zgjuarsin, por Perëndia i dha atij më shumë se sa kërkoj: paqe, pasuri dhe nder, bashkë me urtësinë (1 Mbretërve 3:12-13). Ana kërkoj vetëm një djalë, por Perëndia i dha tre bij dhe dy bija (1 Samueli 1:10 dhe 2:21). Kur lutjet marrin përgjigje, bekimet janë të shumta; ato vijnë papushim njëra pas tjetrës. Ajo për të cilën je lutur sjell dhe gjëra të tjera.

Kur diçka sigurohet me anë të lutjes, shpesh ka rrethana të veçanta ose providencë bashkë me të, e cila është diçka për mirë dhe një vulë se ajo është prej Perëndisë. Kur u lutën për një grua për Isakun, Perëndia dha një shenjë të dallueshme se lutjet ishin dëgjuar. Shërbëtori i Abrahamit u lut në mënyrë të veçantë se vajza e re, që do të vinte të merrte ujë nga pusi dhe që në përgjigje të kërkesës së tij do t'i

ofronte për të pirë jo vetëm atij, por edhe deveve të tij gjithashtu, do të ishte ajo që Perëndia kishte caktuar për Isakun. Dhe Rebeka, duke qenë se ishte e para që mbërriti, foli po të njëjtat fjalë (Zanafilla 24:12-19). Ky ishte një tregues i qartë se Perëndia kishte dorë në këtë çështje dhe kështu shërbëtori u përul dhe adhuroi Zotin (vargu 26).

Përsëri, konsiderimi i kohëzgjatjes së sigurimit të kërkesave tona mund të ndihmojnë të dallosh nëse ato janë përgjigjet e lutjes. Perëndia e tregon urtësinë dhe dashurinë e tij sa në kohën, po aq edhe në dhënien e asaj gjëje. Perëndia, përmes Isaia's tha: 'Në kohën e hirit unë ta kam plotësuar dëshirën' (Isaia 49:8). Davidi tha se ai iu lut ZOTIT në kohë të pranueshme (Psalmi 69:13). Perëndia na përgjigjet në kohën më të mirë dhe më të pranueshme për ne. Ai dëshiron të jetë i hirshëm sepse është një Perëndi i drejtësisë (Isaia 30:18). Ai është një Perëndi i zgjuar dhe e di kohën dhe stinët më të përshtatshme për të treguar mirësinë dhe për të derdhur nderet e tij. Ndonjëherë ajo që kërkojmë arrihet pothuajse në të njëjtën kohë kur ne lutemi me urgjencë. Perëndia tha përmes Isaia's: 'para se të më kërkojnë, unë do të përgjigjem; do të jenë akoma duke folur, dhe unë do t'ua plotësoj' (Isaia 65:24).

Kur Pjetri ishte në burg, ai erdhi dhe trokiti në derë në po atë moment kur kisha ishte mbledhur dhe po lutej për të (Veprat e Apostujve 12:5-16). Kur Jezusi shëroi birin e një oficeri mbretëror, burri zbuloi se ishte pikërisht në momentin kur Jezusi i tha: 'Biri yt jeton', që ai u shërua (Gjoni 4:46-54).

Perëndia zakonisht synon dy gjëra kur i përgjigjet lutjes. Së pari, Perëndia dëshiron të tregojë mëshirën e tij në mënyrë që të jemi përulësisht mirënjohës për mirësinë e tij ndaj nesh, të cilën nuk e meritojmë. Së dyti, Perëndia dëshiron që zemrat tona të jenë të kënaqura dhe plot gëzim dhe kënaqësi me përgjigjen, dhe ne të ngazëllohemi në mirësinë e Perëndisë. Për këto dy qëllime, ai bashkon kohën kur kemi më shumë nevojë me atë kur jemi më shumë duke pritur ndaj tij, dhe kështu dëshirat tona mëkatore shtypen. Në këtë kohë jemi më të përshtatshëm të shijojmë vetëm mirësinë e Perëndisë dhe jo të prirur për t'u tërhequr nga thirrja sensuale e asaj për të cilën jemi lutur.

Mendo sikur je lutur gjatë për sigurimin e shpëtimit dhe gëzimit në Frymën e Shenjtë. Kur ti ke më shumë nevojë për të (ndoshta kur sheh se një rrezik i madh po afrohet), atëherë Perëndia është përgjigjur. Kjo ishte koha më e përshtatshme për Perëndinë të dëgjonte lutjen tënde.

Në shembullin e mëparshëm të Pjetrit, është e qartë se ai kishte kohë në burg. Perëndia mund ta kishte liruar atë në çdo kohë në përgjigje të lutjeve të kishës. Por Perëndia e mbajti Pjetrin në burg deri natën para mëngjesit, kur Herodi kishte ndërmend ta nxirrte Pjetrin në egzekutim. Ajo ishte koha më e përshtatshme për Perëndinë për t`u përgjigjur. Nëse ajo për të cilën je lutur, realizohet kur ti i ke braktisur të gjitha konsideratat e tjera dhe ia ke dorëzuar veten vetëm Perëndisë, atëherë ajo është koha më e përshtatshme e Perëndisë për të vepruar.

Ka një mënyrë tjetër për të ditur nëse një çështje është siguruar në përgjigje të lutjes. Perëndia mund të merret me ty në raport me varësinë tënde ndaj tij dhe sipas asaj se sa afër ke ecur me të. Davidi tha: ‘Ti tregohesh i dhimbshëm ndaj njeriut besimtar dhe i drejtë me njeriun e drejtë. Ti tregohesh i pastër me atë që është i pastër dhe dinak me të ligun’ (Psalmi 18:25-26). Kur duart e Moisiut uleshin, Amalekitët fitonin; por kur duart e tij ngriheshin lart, fitonin Izraelitët (Eksodi 17:11). Ka të ngjarë të fillosh të lutesh me zjarr për diçka, vetëm për të nxituar të gjitha shpresat e një përgjigje duke rënë kështu në mëkat. Perëndia do të donte që ne të vinim re se ka një lidhje midis qëndrimit tonë ndaj tij dhe përgjigjeve të lutjes.

Kapitulli 8

Vëzhgime mbi ndikimin që përgjigjet e lutjeve kanë në zemrat tona

Nëse ajo gjë që është plotësuar e shtyn zemrën tënde më afër Perëndisë, atëherë është e sigurt se është plotësuar si përgjigje e lutjes. Gjërat e përfituara prej lutjes shenjtërohen për ne, dhe në këtë mënyrë nuk do t'i ngatërrojnë dhe nuk do t'i fusin në grackë zemrat tona. Çdo gjë të përfituar prej lutjes duhet t'ia kthejmë Perëndisë dhe ta përdorim për lavdinë e tij. Ana ia dedikoi Samuelin Perëndisë, sapo ajo e përfitoi atë prej lutjes (1 Samueli 1:27-28). Lutjet që kanë marrë përgjigje do të prodhojnë falenderim. Nëse Fryma e Shenjtë të shtyn në falenderim, është një shenjë e sigurt se ai ishte autori i lutjes tënde. Lutja dhe falenderimi janë si lëvizja e dyfishtë e mushkërive; ajri i thithur prej lutjes nxirret jashtë prej falenderimit.

Përsëri, nëse bekimet e fituara të inkurajojnë të shkosh te Perëndia tjetër herë për t'u lutur më me besim dhe me zjarr, kjo është një shenjë se të parat i ke marrë nëpërmjet lutjes. Psalmisti tha: 'Unë e dua ZOTIN, sepse ai dëgjoi zërin tim dhe lutjet e mia. Duke qenë se e ka kthyer ndaj meje veshin e tij, unë do ta kërkoj në gjithë ditët e jetës sime' (Psalmi 116: 1-2).

Përsëri, nëse nxitesh të paguash premtime që u bënë ndërsa po i kërkoje Perëndisë një bekim të veçantë, ti ruan kujtesën e dëftesës së atij bekimi. Është dëshmi se bekimi u fitua prej lutjes, nëse Perëndia të nxit të zbatosh ato premtime.

Nëse mund të kuptosh përmes premtimit se dora e Perëndisë ishte në realizimin e çështjes më shumë sesa shkaqet e dyta, dhe mund t'ia njohësh këtë lavdisë së tij, kjo ndodh për shkak se ai i ka dëgjuar lutjet e tua. Qëllimi i Perëndisë për të dëgjuar lutjen është se ne duhet ta lavdërojmë atë. Së fundi, vërtetësia do të jetë në vetë ndodhinë. Gjërat e fituara prej lutjes kanë pak gjemba në to; mallkimi është hequr. Nga ana tjetër, çfarë vjen përmes parapërgatitjes së zakonshme, mund të vijë me shumë probleme. Arsyeja është se çfarë vjen përmes lutjes vjen si një bekim, dhe kështu nuk i shtohet asnjë lloj vuajtje (Fjalët e Urta 10:22). Lutja gjithashtu vret ato dëshira të forta të cilat shkaktojnë kaq shumë kotësi dhe mërzi në kënaqësitë tona. Gjërat e vonuara, por më në fund të përfituara në lutje, dalin të jenë më të kënaqshme dhe më qetëuese.

Kapitulli 9

Si të qëndrojmë të qetë dhe të dallojmë përgjigjen për lutjen, kur ajo për të cilën jemi lutur nuk është realizuar

Kjo është një çështje e vështirë. Si do ta dimë që Perëndia e ka dëgjuar lutjen, nëse kjo gjë nuk është realizuar? Kështu ndodh zakonisht. Krishti u lut që po të ishte e mundur, kupa të largohej prej tij, megjithatë e dimë se nuk ishte vullneti i Atit të ndodhte (Mateu 26:39, 42). Si mund ta pajtojmë këtë me mësimin te Romakët 8:26, që Fryma e Shenjtë ndërhyr për ne kur nuk dimë si të lutemi? Nëse Fryma e Shenjtë e di që Perëndia nuk do ta realizojë kërkesën tonë, përse do të na shtynte të luteshim? Mund të mendosh se Fryma, që e di mendjen e Perëndisë, do t'i udhëhiqte zemrat tona drejt dhe nuk do të na lejonte të gabonim ose të humbisnim gjërat për të cilat lutemi. Përgjigja është se, së pari, Fryma e Shenjtë nuk prodhon lutje në ne sipas asaj që është vullneti dhe njohja e mëparshme *sekrete* e Perëndisë, por sipas asaj që është vullneti *i zbuluar* i Perëndisë. Vullneti i zbuluar i Perëndisë na paraqitet në fjalën dhe në providencën e tij. Perëndia na drejton në lutje jo gjithmonë sipas vullnetit të tij të fshehtë, por sipas asaj që e kemi për detyrë. Është e njëjtë me metodën e Perëndisë në përdorimin e predikimit. Perëndia e di se kë ka ndërmend të kthejë në besim, megjithatë shpesh ai i ndihmon predikuesit t'u predikojnë më shumë atyre që nuk synon t'i kthejë, sesa atyre që ka ndërmend t'i kthejë. Perëndia merret me ne në këto gjëra sipas detyrës sonë dhe jo sipas dekretit të tij.

Së dyti, te Romakët 8:26, thuhet se Fryma na ndihmon në *dobësinë* tonë. Ai nuk na ndihmon sipas njohurisë së tij të pamasë, por ndihmon njohjen tonë të paqëndrueshme, të dobët dhe të ngushtë. Kështu, ai nxit në ne gjëra të tilla që, *sipas njohjes sonë*, i kemi për detyrë t'i kërkojmë prej Perëndisë. Këto do të jenë gjëra të cilat i konsiderojmë që janë më shumë për të mirën tonë dhe për lavdinë e Perëndisë. Perëndia i pranon të tilla dëshira për ne sipas madhësisë së dashurisë së tij. Si do të merremi, atëherë, me problemin e lutjeve që duken se nuk kanë përgjigje?

Gjëja e parë është qëndrimi ynë në lutje. A u lutëm për diçka në mënyrë këmbëngulëse, thjesht, sepse e mendojmë si më të mirën për veten tonë? Nëse po, nuk duhet të habitemi nëse lutja nuk është pranuar. Ne e abuzuam privilegjin tonë. Por, nëse u lutëm me kushte dhe me një 'në qoftë se', ashtu si Krishti, dhe me një 'jo vullneti im, por yti', mund t'i besojmë gjykimit të Perëndisë se çfarë është mirë për ne. Atëherë mund ta interpretojmë lutjen si të përgjigjur, pavarësisht nga refuzimi.

Ndonjëherë, na duhet të kuptojmë që mohimi i lutjes së një njeriu të perëndishëm është për më të mirën e tij dhe qëndron si themel për një bekim më të madh. Ndonjëherë, mohimi mund të ta thyejë zemrën dhe të të afrojë më shumë me Perëndinë. Atëherë do të fillosh të hetosh rrugët e tua për të parë nëse ka ndonjë gjë të gabuar me lutjet e tua, ose me qëndrimin tënd të përgjithshëm. Kjo në vetvete mund të jetë një bekim i madh. Nëse me humbjen e diçkaje ne mësojmë si të lutemi më mirë, mund të jemi në gjendje të përfitojmë njëqind gjëra më të mira pas kësaj. Krishti u lut që t'i largohej kupa (Mateu 26:39, 42). Ajo nuk u largua, por mohimi ishte themeli i shpëtimit tonë dhe rruga për në lavdinë e Krishtit. Gjithashtu, duhet të jemi të ndërgjegjshëm për mundësinë se mund të ketë një kthim të asaj gjëje të dëshiruar në një tjetër bekim më të madh të të njëjtit lloj. Të gjitha rrugët e Perëndisë janë mëshirë dhe e vërtetë për njerëzit e tij, dhe Perëndia përmirëson, mbledh dhe paraqet gjërat e çmuara të lutjeve të tyre në avantazhin më të mirë. Perëndia mban një sy atje ku kthimet dhe fitimet më të mëdha mund të shfaqen. Jakobi nuk i shtriu duart që jepnin bekim ashtu si Jozefi synonte, por kryqëzoi duart, dhe

kështu bekoi djalin më të vogël në vend të të madhit (Zanafilla 48:17-19). Po ashtu, bekimi që Isaku kishte për Esaun i kaloi Jakobit. Nuk humbi (Zanafilla 27). Mund të ketë kalime të këtij lloji, të cilat nuk kanë pse të shihen si refuzime, por si përgjigje të vërteta të lutjes.

Lutjet tona mund të marrin përgjigje sipas shtysës kryesore, edhe pse gjërat aktuale që janë kërkuar nuk janë marrë. Perëndia përgjigjet sipas menteshave në të cilat lutja kthehet. Mund të perceptojmë diçka për të cilën mendojmë se do të ishte shumë për lavdinë e Perëndisë, për të mirën e kishës dhe ngushëllimin e lumturinë tonë. Perëndia mund të mos e plotësojë këtë kërkesë specifike, por, për shkak se lavdia e tij ishte më e larta në dëshirat tona, kjo dëshirë patjetër që do të marrë një përgjigje, edhe pse në mënyrë tjetër. Davidi kishte një dëshirë të fortë të ndërtonte një shtëpi për ZOTIN dhe ZOTI e urdhëroi atë, sepse ishte në zemrën e tij që kjo gjë të bëhej. Pavarësisht nga kjo, Perëndia nuk e lejoi Davidin të ndërtonte tempullin; ky nder iu dha birit të Davidit, Solomonit (1 Mbretërve 8:17-18). Megjithatë, edhe pse ndonjëherë Perëndia e hedh poshtë një kërkesë, ai mund të hapë një rrugë të konsiderueshme drejt saj, në mënyrë që t'i japë kënaqësi fëmijës së tij. Abrahami u lut me zjarr për Ismaelin dhe Perëndia bëri të pamundurën për t'ia plotësuar kërkesën. Perëndia tha se e kishte dëgjuar dhe e kishte bekuar Ismaelin; ai do ta bënte të frytshëm dhe do të shumonte pasardhësit e tij. Ismaeli do të ishte babai i dymbëdhjetë sunduesve, dhe Perëndia do ta bënte atë një komb të madh. Megjithatë, ishte Isaku, biri me të cilën Perëndia do të vendoste besëlidhjen e tij (Zanafilla 17). Nëse Perëndia ndryshon kërkesat tona në këtë mënyrë, mund të jemi të sigurt se ka qëllim më të lartë në të, dhe se lutja jonë ka qenë burimi i mrekullisë që e bëri të mundur.

Së fundi, mund të vëresh efektet që refuzimet kanë në frymën tënde. Refuzimet mund të bëjnë që të njohësh që Perëndia është i shenjtë dhe i drejtë në marrëdhëniet e tij me ty, dhe se pavlefshmëria jote është shkak i refuzimit të tij. Perëndia mund ta mbushë zemrën tënde me një kënaqësi të shenjtë në refuzim. Kur Pali u lut që gjembi në mish të mund t'i hiqej, përgjigjja e Perëndisë ishte se hiri i tij do të

mjaftonte për të. Kjo e kënaqi Palin (2 Korintasve 12:9). Përsëri mund ta falenderosh Perëndinë duke besuar që çdo gjë që ka caktuar për ty është më e mira, edhe pse në mendjen tënde ajo që u hodh poshtë do të kishte qenë më e mirë. Ti je i kënaqur me gjykimin e Perëndisë në këtë çështje. Është mirë nëse vazhdon në lutje edhe kur mohohet ajo që ke kërkuar. Druaj më shumë kur jepen bekimet dhe gëzohu më shumë kur janë mohuar! Psalmisti i ankohej Perëndisë: ‘deri kur do të jesh i zemëruar kundër lutjes së popullit tënd?’ (Psalmi 80:4). Por ai nuk do të pushonte së luturi, edhe pse dukej se Perëndia nuk dëgjonte. Kështu, duhet të vazhdosh të lutesh edhe po të mos kesh një përgjigje në këtë jetë. Edhe njerëzit e drejtë preken nga ata që i pranojnë kundërshtimet dhe pohimet, sepse ata e dinë që njerëzit krenarë nuk do ta bëjnë këtë. Perëndia, gjithashtu, preket prej një qëndrimi të tillë, të përulur te fëmijët e tij.

Kapitulli 10

Një vërejtje për ata që nuk do të kërkojnë bekime prej lutjeve të tyre

Disa njerëz ofrojnë lutje dhe janë këmbëngulës në të kërkuarit e gjërave prej Perëndisë, por nuk i kushtojnë më vëmendje lutjeve të tyre. Ata mund të kenë një numër të madh lutjesh, por nuk bëjnë asnjë lloj përpjekje për të llogaritur se çfarë përfitimesh kanë marrë prej të luturit. Në vend të kësaj, ata dekurajohen dhe dyshojnë nëse do të dëgjojnë përsëri për lutjet e tyre. Fare mirë ata mund të kenë folur fjalë në erë. Njerëz të tillë e përbuzin sigurimin e hirshëm të Perëndisë për ta, pa njohur fuqinë e lutjes. Ata gjithashtu përbusin Zotin vetë. Të mos i përgjigjesh një pyetjeje që të është bërë, është përbuzje; dhe të mos i kushtosh vëmendje përgjigjesh që të është dhënë, nuk është më pak përbuzëse. Mendo sikur t'i kishit dërguar një letër një shokut tuaj të ngushtë rreth një biznesi të rëndësishëm dhe i keni kërkuar urgjentisht një përgjigje. Nëse do ta injoronit plotësisht përgjigjen e tij, a nuk do të ishit fajtor për përbuzje? Ose, nëse nuk do të mundoheshe të lexoje përgjigjen e tij kur ai shkroi, a nuk do ishte i mërzitur me ty? Kështu, kur i ke kërkuar Perëndisë me këmbëngulje diçka dhe nuk i kushton vëmendje përgjigjes së tij, ti do ta përbuzësh atë. Ky është një gabim i zakonshëm te besimtarët. Mund të mos pushosh së luturi, por nuk i pret përgjigjet si duhet. Le të shohim arsyet për këtë.

E para është mungesa e sigurisë. Për shkak se ke një siguri të dobët se Perëndia të pranon si je, besimi yt se ai do të dëgjojë lutjet e tua është gjithashtu i dobët. Para së gjithash, Perëndia na pranon si jemi dhe kjo na jep besim se gjithashtu ai do t'i pranojë lutjet tona. Ashtu siç e pamë në Kapitullin 1, kjo e vërtetë gjendet në 1 Gjonit 5:13-15: 'Jua shkrova këto gjëra juve që besoni në emrin e Birit të Perëndisë, që të dini se keni jetën e përjetshme. Kjo është siguria që kemi përpara tij: nëse kërkojmë diçka sipas vullnetit të tij, ai na e plotëson. Dhe, nëse dimë se ai na i plotëson të gjitha ato që i kërkojmë, ne dimë se i kemi ato që i kërkuam atij'.

Vini re se si Gjoni lidh tre gjëra së bashku si shkaqe dhe pasoja të njëra-tjetrës. Së pari, ai dëshiron që lexuesit e tij të dinë se ata mund të jenë të sigurt se jeta e përjetshme dhe parajsja janë të tyre. Sipas kësaj do të lindë besimi se Perëndia do t'i dëgjojë ata. Perëndia do t'i hapë veshët dhe zemra e tij do të jetë plot dashuri për ta. Pastaj, së treti, nëse janë të sigurt se Perëndia do t'i dëgjojë, nga kjo do të dalë se ata do të kenë një siguri që Perëndia do t'u japë atyre çdo gjë që kanë dëshirë dhe që është sipas vullnetit të tij. Kur sigurohemi se Perëndia na ka dhënë Birin e tij, atëherë me lehtësi do të besojmë dhe do të presim se Perëndia do të na japë çdo gjë tjetër që kemi nevojë (Romakët 8:32). Kur e kemi kuptuar faktin që Perëndia është Ati ynë, atëherë lehtësisht kuptojmë fjalët e Jezusit te Mateu 7:11: 'Në qoftë se ju, që jeni të këqij, dini t'u jepni dhurata të mira bijve tuaj, aq më tepër Ati juaj, që është në qiej, do t'u japë gjëra të mira atyre që ia kërkojnë'. Nëse Perëndia të dha Birin e tij kur nuk iu lute atij, si nuk do të të japë gjërat për të cilat ti iu lute!

Ti mund të ndihesh i dekurajuar sepse lutjet e tua janë të dobëta. Mund të besosh se Perëndia të pranon si je, dhe përsëri të ankoresh që për shkak se lutjet e tua janë të varfra dhe të dobëta, Perëndia nuk do t'u kushtojë atyre vëmendje. Kësaj mund t'i përgjigjemi në katër mënyra.

Së pari, a lutesh me gjithë fuqinë? Atëherë, edhe pse kjo ‘fuqi’ në vetvete mund të jetë e dobët, përsëri, për shkak se kjo është e gjithë fuqia që ke, do të pranohet. Perëndia pranon sipas asaj që kemi, dhe jo sipas asaj që nuk kemi (2 Korintasve 8:12).

Duhet të mbash mend që Perëndia nuk të dëgjon për hir të lutjeve të tua (megjithëse jo pa to), por për hir të emrit të tij, për hir të Birit të tij, dhe sepse ti je fëmija i tij. Kur një fëmijë qan, nëna kujdeset më shumë për më të dobëtin.

Lutja mund të jetë e dobët, por përsëri mund të jetë mjaft e fortë. Edhe një lutje e dobët mund ta vërë në punë Perëndinë tonë të fortë. Lutja ka sukses jo për shkak të vetë shfaqjes së saj, por për shkak të emrit në të cilin ofrohet – madje dhe të Krishtit. Besimi ia dedikon të gjitha Perëndisë, po kështu edhe lutja. Ashtu si besimi është thjesht një hir që merr, kështu lutja është një hir që lyp. Perëndia e pranon plotësisht dhe aktin më të dobët të besimit. Lutja është mjete që Perëndia ka siguruar për të bërë të ditura bekimet e tij, dhe nuk ka rëndësi nëse është e dobët apo e fortë në vlerësimin që ne i bëjmë asaj.

Nuk duhet t'i gjykosh lutjet e tua duke u nisur nga rrjedhshmëria apo nga trazimet që ke në zemër kur i ofron ato. Fuqia dhe energjia e lutjes vlerësohet nga besimi, sinqeriteti dhe bindja e shprehur në të. Nuk është volumi i zërit të predikuesit që e prek një dëgjues inteligjent, por pesha dhe shenjtëria e çështjes dhe frymës së predikuesit. Nuk janë dhuntitë, por huret që e prekin Zotin në lutje. Fuqia e lutjes nuk është te fjalët, por në faktin se ajo ka fuqinë të ndikojë te Perëndia. Lutjet e prekin Perëndinë, jo si një orator që i prek dëgjuesit e tij, por si një fëmijë që prek babanë e tij. Perëndia shqetësohet më shumë për frymën në të cilën lutemi, sesa në zgjedhjen e fjalëve.

Një dekurajim i tretë është dështimi që pësojmë për të marrë përgjigje. Ti mund të jesh lutur shpesh dhe gjatë, por përsëri lutjet e tua mund të kenë marrë rrallë përgjigje, ose asnjëherë. Prandaj ke pak

siguri se lutjet e tua janë dëgjuar ndonjëherë. Të tjerët kanë interesa nga lutjet e tyre, ndërsa ti duket se nuk merr asgjë. Për ta zgjidhur këtë problem vëre që:

Ti ke më shumë arsye për të pritur sepse mund të kesh më shumë përgjigje për të marrë. Ashtu si njerëzit e këqij mbledhin zemërim, ashtu edhe njerëzit e perëndishëm mbledhin mëshirë dhe veçanërisht nëpërmjet lutjeve. Përgjigjet dhe bekimet shpesh vijnë bashkë.

Edhe nëse duket se ke pak përgjigje, përsëri vlerësimi yt është me Zotin. Të luturit është si të predikuarit. Dikush mund të lutet me besnikëri për shumë vite dhe përsëri të mos shohë asnjë të kthyer. Ai nuk duhet të dorëzohet, por duhet t`i kujtojë vetes pas çdo shërbese, se çdo punëtor do të marrë shpërblimin e tij sipas punës së tij (1 Korintasve 3:8). Ky shpërblim nuk varet në suksesin ose jo të predikimit të tij. Kur lutesh, edhe pse duket sikur lë gjëra pa thënë gjithnjë e më tepër, nuk duhet të dekurajohesh sepse shpërblimi yt është me Zotin dhe do të merret një ditë.

Perëndia mund t`i vonojë përgjigjet jo sepse ai nuk të dëgjon, por për të të provuar. Ai mund të jetë duke provuar besnikërinë tënde në ndonjë detyrë.

Perëndia mund të vonojë kaq gjatë, saqë ti mund të ndalosh së prituri përgjigjen e tij. Të zgjedhurit këlthasin ditë e natë (Luka 18:7-8), por Perëndia vonohet aq, saqë kur vjen nuk gjen besim. Njerëzit e tij kanë ndaluar së prituri dhe i kanë harruar lutjet e tyre. Në këtë kohë Perëndia bën gjërat që ata nuk kërkojnë, për hir të lavdisë së tij.

Ka të tjera dekurajime për të cilat ne vetë jemi fajtorë. Ja tre prej tyre:

Plogështia në lutje. Nëse nuk lutemi me këmbëngulje dhe me zjarr, si mund të presim që Perëndia të na japë ndonjë gjë të mirë? Jakobi fitoi çfarë kishte nevojë nëpërmjet lutjes (Zanafilla 32:24). Krishti tha se shumë do të përpiqen të hyjnë në mbretërinë e Perëndisë, por duhet të përpiqesh shumë për këtë (Luka 13:24). Kur i dimë këto gjëra dhe përsëri jemi të plogët, si mund të presim ndonjë përgjigje? Perëndia do të sillet sikur të ishte në gjumë.

Ato lutje që zgjojnë Perëndinë duhet të na zgjojnë ne në fillim. Ato lutje që lëvizin Perëndinë duhet në fillim të na lëvizin që të kapemi pas tij. Ashtu si bindja forcon besimin dhe sigurinë, ashtu dhe zelli në lutje sjell besimin e të qenit i dëgjuar. Në të gjitha gjërat, plogështia dekurajon dhe dobëson pritshmërinë. A mund të presësh dikush se do të marrë pasuri kur e bën biznesin në mënyrë neglizhente? Nuk mund të presësh një përgjigje nëse je i plogësht në lutje.

Një tjetër shkak i dekurajimit mëkatar është, nëse e sheh lutjen vetëm si një detyrë për t'u bërë sesa si një mjet i fitimit të bekimeve. Mendo për një doktor, i cili ka një nëpunës të sëmurë dhe i cakton atij një ilaç duke e urdhëruar që ta marrë. Nëse nëpunësi e merr ilaçin vetëm si një detyrë për të kënaqur doktorin, por në asnjë mënyrë si mjet për të kuruar sëmundjen e tij, ç`lloj qëndrimi është ky?

Shumica e njerëzve duket se e përdorin lutjen në këtë mënyrë. Ata e marrin lutjen vetëm si një recetë, por jo si bekim. Këta njerëz vijnë përditë te Perëndia, por vetëm si një nëpunës që ka për detyrë. Ata nuk vijnë te Perëndia si te një Atë, dhe nuk është për t'u habitur nëse ata kanë pritshmëri të paktë prej lutjeve të tyre. Duhet të kërkosh dy gjëra në lutje. Së pari, lutja është një urdhërim nga Perëndia. Së dyti, lutja është mjet për të marrë bekimet e premtuara. Lutja së pari është një vepër bindjeje, dhe së dyti veprim besimi në premtimet e Perëndisë. Kur kërkon ti duhet 'të besosh dhe të mos dyshosh' (Jakobi 1:6). Pjesa më e madhe e njerëzve duket se e zbatojnë lutjen si akt bindjeje vetëm, por nëse lutesh në besim, duke parë në premtimet e Perëndisë, mund të presësh që Perëndia të të përgjigjet. Një dekurajim i tretë mëkatar është t'i kthehesh mëkatit pasi je lutur. Nëse je lutur për bekim dhe je plot besim se lutjet e tua janë dëgjuar, por përsëri bie në mëkat, ai mëkat do t'i copëtojë të gjitha shpresat e tua. Do të ndihesh sikur i ke shkatërruar lutjet e tua dhe se ato nuk do të arrijnë në qiell. Mëkati me të vërtetë mund të pengojë përfitimin nga kërkesat e tua, por mëkatet e kaluara nuk janë aq shumë një pengesë. Ka më shumë të ngjarë që të jetë qëndrimi yt i tanishëm ndaj Perëndisë që pengon kuptimin tënd të të bekuarit përmes lutjes.